

ÇËSHITJE TË SIGURISË *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 1, vjeshtë 2006

Bordi botues:***Kryetar***

Gj. Lt. (rez.) Pëllumb Qazimi

Anëtarë

Dr. Dhori Karaj – Dekan i Fakultetit të Shkencave Sociale

Franko Egro – Publicist, Kryeredaktor i TV Koha

Agri Verrija – Këshilltar i Kryeministrit

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Evropiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

Redaktor Përgjegjës

Enis Sulstarova – M. Sc. Shkenca Politike dhe Administrim Publik

Ky numër i revistët botohet me mbështetjen financiare të Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s në Bruksel dhe të Albanian Mobile Communications (AMC)

PËRMBAJTJA

Bordi botues

Një revistë shqiptare për sigurinë njerëzore	5
An Albanian journal for human security	5

Petrit Karabina, Zv/Ministër i Mbrojtjes dhe Kryetar i SEDM-CC/ PMSC

Përshëndetje dhe koment mbi procesin e SEDM	9
---	---

Përshëndetje nga Komandanti i Prezencës Ushtarake të NATO-s në Shqipëri Gjen. Brig. Georgios Mouroutsos	15
---	----

Jaap de Hoop Scheffer, Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s

NATO-ja globale: E vonuar apo e tejshtirë?	16
--	----

Gabriele Cascone, Joaquin Molina

Thellimi i Marrëdhënieve të NATO-s me Ballkanin Perëndimor	22
---	----

Prof. **Rexhep Meidani**

Paqeruajtja dhe ndërhyrja, siguria dhe NATO-ja	29
--	----

Bengt Sundelius, Profesor i Qeverisjes në Universitetin e Uppsalas

Mbi sigurinë e trupëzuar shoqërisht	39
---	----

Gj.Lt. (rez.) Pëllumb Qazimi	58
---	----

Të kuptuarit e transformimit ushtarak të NATO-s, nga këndvështrimi i një vendi partner	58
---	----

Ronald D. Asmus , Drejtor i Fondit të planit Marshall Gjerman Rishpikja (rishtas) politike e NATO-s	63
Franko Egro , Kryeredaktor TV Koha NATO-ja dhe sfidat e saj	70
Kol. Zeno Jahaj Prirje të luftës moderne: Forca ushtarake më të pakta në numër, më të afta profesionalisht dhe më të mirëstërvitura	75
Alban Bala , Drejtor ekzekutiv i Institutit Shqiptar të Marrëdhënieve Publike Menaxhimi i informacionit shtetëror si rrugë e përafrimit me NATO- n	84
English summary	92

Një revistë shqiptare për sigurinë njerëzore

An Albanian journal for human security

Kur përmendet fjala “siguri” çdokujt i vjen ndër mend mbrojtja e shtetit apo e rendit publik me anën e forcave të armatosura, diplomacisë, shërbimeve informative, etj. Ky është një gjykim i shëndoshë, për faktin sepse tradicionalisht me “siguri” kuptohet ruajtja e integritetit të shteteve sovraane, me anë të mjeteve ushtarake, diplomacisë dhe aleancave ushtarake ndërshtetërore, siç është NATO-ja. Në këtë perspektivë, mund të thuhet se një sukses i rëndësishëm është arritur në kontinentin evropian me shmangien e luftërave dhe sidomos me mbarimin e Luftës së Ftohtë. Ndërsa gjatë shek. XX luftërat kanë ardhur duke u rralluar dhe siguria e shteteve sovraane është konsoliduar, jo gjithmonë qytetarët janë ndier më të sigurtë. Siç jemi dëshmitarë, siguria e qytetarëve shqiptarë gjatë periudhës së diktaturës kërcënohej prej dhunës shtetërore, përpara së cilës ata ishin të pambrojtur. Me rënien e komunizmit dhe zhvillimit të demokracisë dhe ekonomisë së tregut, qytetarët

Whenever one mentions “security” the first thing that comes to mind is the defense of the state or the protection of the public order by the armed forces, diplomacy, intelligence services, etc. This is the common sense understanding of “security”, because traditionally it meant the keeping of integrity of the sovereign states through military means, diplomacy or inter-state alliances, such as NATO. Within this perspective, we can say that an important success has been achieved in Europe with the avoidance of open wars for several decades and with the end of the Cold War. Nevertheless, while the frequency of wars may have diminished during the twentieth century, and the boundaries of sovereign states are consolidated, not always citizens have felt themselves more secure. As we Albanians have witnessed, the security of citizens during dictatorship was threatened by the state violence. The citizens felt unsafe vis-a-vis the state. After the fall of communism and with the

shqiptarë ndihen më të sigurtë, por sfida të tjera i kanosen sigurisë së tyre. Këto sfida nuk janë vetëm tonat dhe nuk mund t'i përballojmë të vetëm dhe kjo është arsyeja pse në Shqipëri ekziston një konsensus i gjerë për anëtarësimin e vendit në NATO, që përveç mbrojtjes kolektive, përcjell tek anëtarët dhe kandidatët edhe vlerat e lirisë, demokracisë, mirëqenies ekonomike me anë të ekonomisë së tregut.

Në ditët tona, ndiejmë se siguria jonë si individë, si pjesëtarë të një shoqërie dhe shteti, është e kërcënuar jo thjesht nga sulme ushtarake, por nga rreziqe, si: shkeljet e të drejtave të njeriut dhe mos-funksionim i demokracisë, rënie të strukturave të shtetit, terrorizmi ndërkombëtar, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, rrënim i mjedisit, epidemi, katastrofa natyrore, varfëri e skajshme, etj. Këto rreziqe janë të ndërlidhura, “të padukshme” në kuptimin konvencional, dhe nuk ndalin në kufijtë e shteteve të caktuara. Prandaj, edhe koncepti i sigurisë gjithmonë e më shumë po gjen përdorim në një kuptim më të gjerë, atë të “sigurisë njerëzore” që kupton më gjerë lirinë e njerëzve prej frikës dhe nevojës. Siguria njerëzore është sa individuale po aq edhe universale, sa kombëtare po aq e ndërvarur, ajo është më shumë parandaluese sesa reaguese dhe gjithmonë në qendër ka njerëzit me nevojat e tyre. Siguria njerëzore nuk e përjashton sigurinë kombëtare,

developing of the Albanian democracy, citizens feel more secure, but other threat challenge their security. Contemporary challenges to security are not only ours to meet and this is the reason why in Albanian there is a wide consensus on the membership of the country in NATO, which besides its collective defense, transmits to member states and candidates the values of freedom, democracy, prosperity through the open market economy.

Nowadays our safety as individuals, as members of our society and our state, is threatened not simply from military attacks from outside of the borders, but by other dangers, such as the violation of human rights, dysfunctions of democracy, collapse of state structures, international terrorism, diffusion of WMD, destruction of environment, epidemics, natural disasters, poverty etc. These dangers are interrelated, “invisible” in conventional sense and do not stop in front of state borders. Therefore the notion of security is being used in a more general sense, meaning “human security” that implies freedom of human beings from fear and need. Human security is individual and universal, national and interdependent, more preventive than reactive, and always has in its core the people with their needs. Human security does not exclude national security, they support one another. Actors of human security are states, military alliances,

ato mbështesin njëra-tjetrën. Aktorë të saj janë shtetet, aleancat ushtarake, organizatat ndërkombëtare, në nivel global; qeveria, partitë politike, forcat e armatosura, policia, shërbimet informative, në nivel shtetëror; ekonomia, shoqëria civile, mediat dhe vetë qytetarët.

Duke besuar te vlerat universale njerëzore dhe te parimet e Kushtetutës së Shqipërisë, duke qenë mbështetës të palëkundur të proceseve integruese evropatlantike të Shqipërisë, duke besuar se pa demokraci, shtet ligjor dhe mirëqenie ekonomike nuk mund të ketë siguri, duke përkrahur rritjen e mirëbesimit rajonal në Evropën Juglindore, duke besuar te roli monitorues i shoqërisë civile, ne themelojmë këtë revistë me qëllimin e përhapjes dhe edukimit të publikut shqiptar me vlerat evropatlantike dhe përfshirjen e aktorëve civilë në diskutimin e çështjeve të sigurisë.

Objektivat e revistës “Çështje të Sigurisë” janë: (1) informimi i një publiku të specializuar mbi çështje të sigurisë kombëtare nëpërmjet analizave të specialistëve të fushave të ndryshme ushtarake dhe civile; (2) informimi i publikut mbi NATO-n, në këtë periudhë të rëndësishme transformimi dhe zgjerimi të organizatës; (3) krijimi i një forumi diskutimi mbi sfidat kombëtare dhe globale ndaj sigurisë njerëzore në Shqipëri dhe nxjerrja e strategjive efikase për përballimin e tyre.

Këto objektiva, revista “Çështje të Sigurisë Shqiptare”, do t'i realizojë nëpërmjet botimit

international organizations, in a global level; government, political parties, armed forces, police, intelligence services, in a state level; economy, civil society, media and citizens themselves.

Believing in universal human rights in principles of Constitution of Albania; being firms partisans of Euro-Atlantic integration processes of the country; believing that without democracy, rule of law, and economic welfare there can be no real security; supporting regional trust building initiatives in SEE; trusting to monitoring role of civil society, we found this journal with the aim to spread and educate the Albanian public with Euro-Atlantic values and to involve the civil actors in the discussion of security issues.

The objective of the *Security Issues* are: (1) informing a specialized public on issues of national security through analyses of experts from different military and civil; (2) informing the public at large on NATO, in this crucial period of transformation and enlargement of the organization; (3) creating a discussion forum on national and global challenges to human security in Albania and developing efficient strategy to meet them.

These objective will be fulfilled through the publication in *Security Issues* of information about developments in NATO and its missions throughout the world, analytic papers by native and international experts and analysts on security, processes of integration to NATO, regional

në faqet e saj të informacionit mbi zhvillimet në NATO dhe misionet e saj nëpër botë, artikujve analitikë nga specialistë dhe analistë vendas dhe të huaj mbi sigurinë, procesin e integritimit në NATO, bashkëpunimet rajonale për sigurinë dhe sfidat ndaj sigurisë në rrethanat e tanishme globale. Revista do të afrojë autorë të mirënjohur nga Shqipëria dhe të huaj, specialistë nga sektori i sigurisë dhe ai civil, analistë të zhvillimeve të sotme globale, rajonale dhe shqiptare. Synimi do të jetë kombinimi i analizave prej perspektivave të ndryshme që do të stimulojnë debatet dhe rrahjet e mendimeve për të ndikuar procesin e integritimit evro-atlantik të Shqipërisë dhe të politikave të jashtme të shtetit shqiptar.

Revista është veçanërisht e hapur për studiuesit shqiptarë, përfshirë studentët universitarë dhe pasuniversitarë brenda dhe jashtë vendit, të cilët janë të interesuar të botojnë dhe të njohin publikun shqiptar me punimet e tyre në çështjet e sigurisë, dinamikat evro-atlantike dhe sfidat rajonale dhe globale ndaj sigurisë.

Revista do të shpërndahet falas nëpër institucione publike qendrore dhe vendore, akademike dhe të shoqërisë civile në të gjithë vendin. Falënderojmë Divizionin e Diplomacisë Publike të NATO-s dhe AMC që mundësuan lindjen e saj dhe shpresojmë se ajo do të mirëpritet si një ndihmesë e vlefshme dhe do të sigurojë plot miq e bashkëpunëtorë gjatë rrugës së saj.

Bordi i botuesve

cooperations on security and on challenges to security in contemporary global setting. The journal will engage well-known Albanian and foreign authors, experts of security and civil sectors, analysts of contemporary global, regional and national developments. We will aim at combining of different perspectives that will stimulate debates and exchanges of thoughts to influence the Euro-Atlantic integration of Albania and the foreign policies of Albania.

The journal will be open especially to Albanian researchers, including undergraduate and graduated students in the country and abroad who are interested in publishing their works on security, Euro-Atlantic dynamics and regional and global challenges to security.

The journal will be freely distributed to central and local public institutions, academy, civil society organizations throughout the country. We thank you the Public Diplomacy Division of NATO and Albanian Mobile Communications (AMC) that made possible the birth of this journal and we hope that the public will welcome *Security Issues* as a valuable tool and that during its course the journal will make many friends and collaborators.

Board of editors

Petrit Karabina

Zv/Ministër i Mbrojtjes dhe Kryetar i SEDM-CC/PMSC

Përshëndetje dhe koment mbi procesin e SEDM

Në radhë të parë më lejoni të përshëndes lexuesit e “Çështje të Sigurisë”, së dyti të falënderoj ekipin botues që më dha mundësinë për të shprehur dhe shkëmbyer idetë dhe në të njëjtën kohë për të hapur një debat të rëndësishëm siç është ai i fushës së sigurisë.

Fusha e sigurisë në brendësinë e saj është një fushë sa e gjerë dhe aq komplekse me të gjitha mekanizmat që janë në shërbim të saj. Unë në veçanti dua të ndalem në një nga proceset më të reja, por të suksesshëm në rajonin e Evropës Juglindore, siç është ai i SEDM-it dhe iniciativës së MPFSEE, i cili ka shërbyer dhe shërben si një pjesë integrale e sigurisë në rajonin tonë e më gjerë. Në veçanti dua të ndalem në disa pika kryesore:

- Historia dhe pjesëmarrja, struktura dhe prioritetet kryesore të procesit;
- Projektet e SEDM-it dhe dinamika e tyre;
- Iniciativa e MPFSEE, apo e njohur ndryshe SEEBRIG;
- Kryesimi i SEDM-CC/PMSC nga Shqipëria.

Historia dhe pjesëmarrja, struktura dhe prioritetet kryesore të procesit

Viti 2006 shënoi dhjetëvjetorin e SEDM-it, i cili filloi me takimin e Ministrave të Mbrojtjes të rajonit në Tiranë, në mars 1996. Origjinën e tij, procesi e ka si një forum rajonal, i cili do të sillte rritjen e besimit dhe mirëkuptimit, sigurisë dhe bashkëpunimit politiko-ushtarak në rajonin e trazuar nga konfliktet, divergjenat me mentaliteti mosbesues, për të

shikuar drejt një të ardhmeje të përbashkët në siguri dhe integritim. Për më shumë se një dhjetëvjeçar, ky proces është rritur dhe zgjeruar me anëtarë të rinj, duke përfshirë: Shqipërinë, Bullgarinë, Kroacinë, Greqinë, Italinë, Maqedoninë, Rumaninë, Slloveninë, Turqinë, Ukrainën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në të njëjtën kohë, ky proces është zgjeruar dhe me vende vëzhguese si: Moldavia dhe së fundi në takimin e Ministrave të Mbrojtjes së vendeve të SEDM-it të mbajtur në Tiranë, më 27 shtator 2006 u pranuan Bosnja-Hercegovina, Gjeorgjia, Mali i Zi dhe Serbia.

Zhvillimet e fundit janë një dëshmi e qartë e politikës së dyerve të hapura të procesit, njëkohësisht konfirmim i suksesit të SEDM-it përballë vendeve që kanë shprehur dëshirën për t'u anëtarësuar në të. Në frymën e SEDM-it janë ngritur dy komitete koordinues:

- *Komiteti Drejtues Politik-Usharak (PMSC) i MPFSEE-së*, roli i të cilit është koordinimi, menaxhimi dhe dhënia e direktivave për të gjitha çështjet që lidhen me Forcën Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Evropës Juglindore, apo e njohur ndryshe Brigada e Evropës Juglindore (SEEBRIG).
- *Komiteti Koordinues i Ministerialit të Mbrojtjes së Evropës Juglindore (SEDM-CC)*, i cili mbulon të gjitha çështjet që lidhen me projektet e SEDM-it, për të cilat do të ndalem t'i trajtoj më poshtë.

Në lidhje me prioritetet e procesit do të shprehem se këta prioritete janë zgjeruar dhe pasuruar me kalimin e viteve, ashtu si dhe procesi në vetvete u zhvillua dhe u rrit në aktivitete, projekte, sipërmarrje dhe njëkohësisht duke kapërcyer kufijtë e Evropës Juglindore. Megjithatë, me gjithë këtë dinamikë veprimi, prioriteti kryesor në konturin e vet mbetet i njëjtë: promovimi i mirëkuptimit, besimit dhe bashkëpunimit mes vendeve anëtare.

Në rolin e kryetarit të SEDM-CC/PMSC, jam krenar të deklaroj, që SEDM-i tashmë i ka përmbushur të gjitha prioritetet e tij. Gjithë këto arritje të përbashkëta tashmë dua t'i ndaj me të gjitha vendet anëtare: Shqipërinë, Bullgarinë, Kroacinë, Greqinë, Italinë, Maqedoninë, Rumaninë, Slloveninë, Turqinë, Ukrainën dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Do të doja

njëkohësisht të përfitoja nga rasti të falënderoja të gjithë vendet anëtare për kontributin e shkëlqyer dhe mbështetjen e vazhdueshme gjatë gjithë këtyre viteve, për ta bërë SEDM-in një nga proceset historike më të suksesshme të bashkëpunimit rajonal.

Në një dhjetëvjeçar, SEDM-i ka bërë që këto vende të angazhohen në aktivitete të përbashkëta duke u materializuar në fusha të ndryshme si: kontrolli i armëve, sigurimi i kufijve, çmilitarizimi, shkëmbimi i teknologjisë ushtarake, tele-medicina, stërvitjet e ndryshme të përbashkëta, operacionet për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe operacionet në mbështetje të paqes. Duke realizuar në total rreth 50-70 aktivitete në vit, ky proces tashmë besoj se është ndër më aktivet dhe më efektivet në rajon.

Larmia e aktiviteteve, angazhimi i përbashkët dhe dëshira e manifestuar gjatë kësaj dekade nga të gjithë vendet anëtare, ka sjellë shpirtin e bashkëpunimit, besimit dhe mirëkuptimit, i cili ishte një risi për këtë rajon dhe në të njëjtën kohë një shembull i krijimit të mirëbesimit për çdo rajon në botë.

Projektet e SEDM-it dhe dinamika e tyre

Ndër vite, bashkëpunimi i suksesshëm mes vendeve të SEDM-it ka çuar në lindjen e një numri të madh projektesh, të cilët i japin një rëndësi të veçantë këtij procesi. Projektet kryesore të SEDM-it janë:

- *Projekti i SEDM/IMIHO*: “Bashkëkomunikimi i Spitaleve Ushtarake”, i cili është një program për lidhjen dhe bashkëkomunikimin e spitaleve ushtarake të vendeve pjesëmarrëse.
- *Projekti i SEEDIRET*: “Bashkëpunimi në fushën e Armatimeve, Industrisë Ushtarake, Kërkimit dhe Teknologjisë” është i fokusuar në fushën e çmilitarizimit të municioneve të vjetra dhe minave, si dhe në krijimin e kriterëve të përbashkëta për certifikimin e prodhimeve të materialeve të mbrojtjes.

Përmes një serie stërvitjesh simulimi, *Projekti i SEESIM-it* “Rrjeti i Simulimit të Evropës Juglindore” është krijuar për të

shërbyer si bazë për integrimin e disa iniciativave funksionale që veprojnë në kuadër të SEDM-it, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, koordinimit dhe ndërveprimit midis vendeve të SEDM-it dhe iniciativës së SEEBRIG-ut, Forcës Xheniere (ETF), Grupit të punës për moslejimin e përhapjes së Armëve të Dëmtimit në Masë, Luftës kundër terrorizmit, Sigurimin e Kufijve (CBSC)”, nëpërmjet përdorimit të simulimit dhe modelit kompjuterik.

I fundit, por jo më pak i rëndësishëm është *Projekti i CBSC-së* “Mbështetje Ushtarake për mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë, Sigurimin e Kufijve dhe Luftës Kundër Terrorizmit”. Ndryshimet e sigurisë në arenën ndërkombëtare, shfaqja e kërcënimeve jokonvencionale dhe asimetrike në rajonin e Evropës Juglindore, çuan në nevojën për zhvillim të planeve dhe strategjive të përbashkëta për të rritur koordinimin dhe bashkëpunimin me organizata të ndryshme të sigurisë në rajon dhe më gjerë, siç janë Kombet e Bashkuara, Bashkimi Evropian, NATO-ja dhe Organizata e Sigurimit të Këshillit të Evropës.

Këto projekte drejtohen apo bashkëdrejtohen nga vendet anëtare me rotacion për një periudhë 1 – 2-vjeçare. Ndërkohë, SEDM-i po merr në konsideratë dhe fusha të tjera të bashkëpunimit dhe mundësinë e lancimit të projekteve të reja.

Iniciativa e MPFSEE-së, apo e njohur ndryshe SEEBRIG-u

Iniciativa e Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe e Evropës Juglindore (MPFSEE) është sigurisht produkti kryesor i procesit të SEDM-it. Fillimet e saj kjo iniciativë i ka në vitin 1999, kur 7 vende anëtare të SEDM-it, nënshkruajnë Marrëveshjen e MPFSEE-së. Në fillim, kësaj initiative i bashkohen Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Italia, Maqedonia, Rumania dhe Turqia. Më vonë, në fillim Sllovenia dhe pastaj SHBA-ja e Kroacia i bashkohen kësaj initiative me statusin e vëzhguesit. Së fundi, Ukraina me statusin e vëzhguesit është në proces për anëtarësim të plotë në këtë iniciativë.

Qëllimi i kësaj initiative është kontributi në sigurinë dhe stabilitetin rajonal, besimin reciprok, forcimin e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mes vendeve të Evropës Juglindore në

kontekstin e Procesit të SEDM-it, Këshillit të Partneritetit Evro-Atlantik (EACP) dhe në frymën e Partneritetit për Paqe (PfP). Sipas marrëveshjes së MPFSEE-së, SEEBRIG-u do të angazhohet në operacione të parandalimit të konflikteve apo në Operacione të tjera në mbështetje të paqes me mandatuara nga OKB-ja apo OSBE-ja, të udhëhequra nga NATO-BE.

Në 10-vjetorin e SEDM-it, në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes së vendeve të SEDM-it, të mbajtur në Tiranë, vendet festuan dislokimin e parë historik të SEEBRIG-ut në mision paqeruajtës, duke u shprehur unanimisht në suksesin e plotë të këtij misioni. Vendimmarrja dhe finalizimi me sukses i këtij misioni ishte një dëshmi e qartë e evoluimit dhe pjekurisë së rajonit tonë dhe SEDM-it. Ajo çfarë u arrit duke siguruar bashkëpunim dhe siguri në rajon, dëshmoi qartë që mund të prodhonte siguri edhe përtej kufijve tanë.

Kryesimi i SEDM-CC/PMSC nga Shqipëria

Kryesimi i procesit të SEDM-it është në rotacion dyvjeçar. Aktualisht, ky proces kryesohet nga Shqipëria, e cila e ka marrë këtë drejtim më 1 korrik 2005. Shqipëria është vendi i katërt që kryeson procesin, pas kryesimit të shkëlqyer nga Greqia, Rumania dhe Turqia. Ndërkohë, Maqedonia do të marrë kryesimin në korrik 2007.

Gjatë kësaj periudhe të kryesimit nga Shqipëria janë shënuar momentet më të rëndësishme të së tashmes dhe të ardhmes së këtij procesi. Shqipëria ka luajtur një rol konstant inkurajues për ta bërë atë një proces sa më të suksesshëm. Megjithatë, arritjet në SEDM janë një produkt i përpjekjeve dhe kontributeve të të gjithë vendeve anëtare.

SEDM-i ka bashkëpunuar në mënyrë të suksesshme me aleancën ushtarake me të madhe në botë, NATO-n, duke dëshmuar aftësi dhe seriozitet, duke kontribuar në përpjekjet ndërkombëtare për të mirën e paqes dhe sigurisë në botë. Gjatë kryesimit nga Shqipëria, SEDM-i ka vazhduar të përdorë politikën e dyerve të hapura, duke rritur dhe zgjeruar në këtë mënyrë kufijtë e tij dhe duke i kaluar objektivat gjeografikë të origjinës. Ukraina u bë anëtare me të drejta të plota në dhjetor 2005, ndërsa Bosnjë- Hercegovina, Gjeorgjia, Mali i Zi dhe Serbia u mirëpritën si vëzhguese në shtator në takimin e Ministerialit të Tiranës.

SEDM-i vazhdimisht ka qenë një iniciativë e rëndësishme për mbështetjen e vendeve aspirante në strukturat evropatlantike, duke i dhënë mundësinë për të demonstruar kapacitetet dhe aftësitë e tyre. SEDM-i ka rritur vazhdimisht nivelin e bashkëpunimit politik dhe atë ndërqeveritar mes të gjithë vendeve anëtare, përmes projekteve dhe aktiviteteve të ndryshme.

Në Takimin Vjetor të Ministrave në Tiranë në shtator, ministrat e vendeve të SEDM-it përshëndetën progresin e arritur deri tani. Veçanërisht, ata deklaruan dëshirën dhe vendosmërinë për të vazhduar më tej bashkëpunimin në rritjen e sigurisë në rajon dhe atë të integritit, si dhe në të njëjtën kohë për të mbështetur përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për të kapërcyer sfidat e kohës moderne, për të mbrojtur vlerat universale të paqes dhe demokracisë.

Duke falënderuar dhe një herë të gjithë lexuesit, dua të përshëndes të gjithë ekipin botues të “Çështje të Sigurisë” dhe t’i uroj mbarësi në rrugën e nisur.



Përshëndetje nga Komandanti i Prezencës Ushtarake të NATO-s në Shqipëri



Pak vite më parë qeveria shqiptare shpalli se integrimi i Shqipërisë në strukturat evro-atlantike është qëllimi i saj kryesor kombëtar. Për të arritur këtë qëllim, shumë përpjekje i janë kushtuar zbatimit të reformave të nevojshme në sektorin e sigurisë. Procesi pritet të vazhdojë dhe të intensifikohet në vitet që do të vijnë.

Duke patur parasysh madhësinë dhe diapazonin e gjerë të ndryshimeve që nevojiten për të menaxhuar këtë shndërrim, është e rëndësishme që e tërë shoqëria shqiptare të mbahet e informuar dhe e angazhuar në mënyrë aktive.

Shoqëria shqiptare, megjithëse është parimisht në mënyrë mbizotëruese mbështetëse e integritit evro-atlantik, nuk është e informuar mbi detajet specifike që kërkohen.

Masmedia, veçanërisht revista të specializuara, mund të japin ndihmesë pozitive në përmirësimin e mëtejshëm të vetëdijes publike dhe të rrisë mirëkuptimin e publikut të proceseve integruese. Një mirëkuptim i tillë i sektorit të sigurisë është një parakusht për integrim të suksesshëm.

Brenda këtij konteksti, do t'i uroja një mirëseardhje të ngrohtë numrit të parë të revistës *Çështje të Sigurisë*, duke shpresuar se ajo do të arrijë objektivin për të informuar shoqërinë shqiptare mbi çështjet evro-atlantike, me anë të një qasjeje shkencore dhe të paanshme.

Si përfundim, do të përgëzoja Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim për nismën e tyre krijuese dhe do t'i uroja suksese në rrugën e tyre.

Gjen. Brig. Georgios Mouroutsos

Jaap de Hoop Scheffer

Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s

NATO-ja globale: E vonuar apo e tejshtirë?

Mbajtur në Konferencën e SDA-së, Bruksel, 6 nëntor 2006

Zonja dhe zotërinj!

Është një kënaqësi për mua të jem sërish në SDA. “NATO-ja globale: E vonuar apo e tejshtirë”,^{*} ky është një kombinim interesant fjalësh – një tjetër shembull klasik i Gilles Merritt! Me një qëllim të dukshëm për të provokuar – dhe më duhet ta pranoj që funksionon. Prandaj, më lejoni të fokusohem në temën e kësaj konference, duke ju paraqitur pikëpamjet e mia në këto dy terma “globale” dhe “tejshtirë”.

E kam thënë në shumë raste të tjera dhe do ta përsëris edhe këtu sot, që ne nuk kemi nevojë për një NATO globale. Shndërrimi ynë nuk bëhet për këtë. NATO-ja që na nevojitet – dhe që po e krijojmë me sukses – është një Aleancë që mbron vendet anëtare prej rreziqeve globale: terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë dhe shtetet e dështuar. Për të përballuar këto kërcënime, NATO-ja nuk ka nevojë për t’u shndërruar në një “gendarme du monde”. Ajo që na nevojitet është një qasje globale ndaj sigurisë, me organizatat ndërkombëtare, përfshirë dhe NATO-n, që luajnë secili rolet e veta.

Por kjo detyrë a nuk sjell rrezikun e “tejshtirjes”, siç lihet e nënkuptuar nga tema e kësaj konference? A është nevoja për NATO-n për t’u mbrojtur prej kërcënimeve globale, një ftesë për angazhime edhe më kërkuese, por me mjete akoma më të kufizuara?

Sigurisht, përballja me kërkesat që janë gjithnjë në rritje do të mbetet një sfidë e përhershme. Pikërisht tani, mëse 50.000 ushtarë po shërbejnë nën komandën e NATO-s në operacione

^{*} Në origjinal: “Global NATO: Overdue or Overstretch?”

dhe misione në tre kontinente. Ne kurrë nuk kishim parë burimet tona të shpërhapura si tani dhe përderisa kërkesa për NATO-n nuk do të shënojë ulje, por do të rritet më tej, duhet të sigurohemi që NATO-ja të jetë në gjendje të ofrojë shërbimet e saj. Dhe unë besoj se kjo do të thotë që ne duhet të përqendrohemi në gjashtë fusha kryesore.

Së pari, ne kemi nevojë për të vazhduar më tej me ndërtimin e kapaciteteve tona. Në Samitin tonë të Rigës pas tre javësh, ne do të sjellim bashkë pengimet kryesore të punës së NATO-s në atë zonë, përfshirë mbrojtjen e raketave, mbikëqyrjen ajër-tokë, punës antiterrorizëm, dhe mbrojtjen prej armëve të shkatërrimit në masë. 13 shtete anëtare të NATO-s dhe një vend partner do të firmosin një Memorandum Mirëkuptimi mbi përdorimin kolektiv të avionëve strategjikë transportues C-17. Edhe Forca Kundërpërgjigjëse e NATO-s duhet të arrijë Kapacitetin e vet të Plotë Operacional.

Kjo dëshmon përparimin e jashtëzakonshëm që kemi arritur. Por unë besoj se duhet të bëhet diçka më shumë përtej takimit të Rigës. Ne, gjithashtu, kemi nevojë për një kuadër më të saktë për trainimet dhe për përdorimin e Forcave Speciale të NATO-s. Ja pse Samiti i Rigës nuk do të jetë një fund, por thjesht një hap përpara në procesin e vazhdueshëm të shndërrimit ushtarak.

Sigurisht, pasja e kapaciteteve të duhura do të thotë më shumë sesa të kesh mjetet e përshtatshme. Kjo përfshin gjithashtu të pasurit e një planifikimi të drejtë të sistemit të mbrojtjes. Kjo është arsyeja pse ne jemi aktualisht në procesin e modifikimit të planit të sistemit të mbrojtjes, bazuar në Udhëzimin e Plotë Politik që do të botohet në Rigë. Ky është edhe kuadri që ekspozon llojin e Kapaciteteve të Mbrojtjes që na nevojitet për të zgjidhur sfidat me të cilat do të përballlemi me shumë mundësi nesër. Neve na nevojitet një proces planifikimi që të jetë akoma më shumë i bazuar mbi kapacitetet, më shumë i përllogaritur ndaj nevojave të veçanta të aleatëve individualë dhe më shumë i përshtatshëm që është edhe më shumë i bazuar në kapacitete, edhe më i përllogaritur dhe për të përmbushur nevojat specifike të aleatëve individualë, dhe gjithnjë e më shumë i përshtatshëm për të zgjidhur mangësitë potenciale.

Së dyti, ne kemi nevojë për të ndarë rreziqet dhe barrën në mënyrë më të paanshme. Një shembull i qartë është edhe çështja e parapritave dhe kufizimeve kombëtare në lidhje me

përdorimin e forcave tona. Kur vjen puna për të dërguar ushtarët e tyre në operacione, disa shtete të NATO-s ende këmbëngulin në shumë lloje kufizimesh. Kjo kufizon përdorueshmërinë e forcave të tyre – dhe pengon fleksibilitetin e komandantëve tanë. Gjatë muajve të fundit, ne kemi bërë përparim në zhdukjen e disa prej këtyre parapritave, megjithatë nevojitet një përpjekje akoma më e madhe. Tashmë, NATO-ja ka nevojë për të mbuluar spektrin e plotë të operacioneve, nga lufta deri te paqeruajtja. Për këtë arsye t'u vendosësh paraprita operacioneve do të thotë të vendosësh paraprita ndaj të ardhmes së NATO-s. Në Samitin e Rigës, unë do t'ia përcjell këtë mesazh Kreve të Shteteve dhe Qeverive tona, fort dhe qartë.

Një tjetër element i rëndësishëm i ndarjes së barrës është reforma e rregullimeve të fondeve. Shikoni Forcën e Kundërpërgjigjes së NATO-s (NATO Response Force-NRF). Sipas rregullave tona aktuale “kostot mbulohe nga ata që përfshihen”, që nënkupton se kombet janë ato që paguajnë sipas mënyrës së tyre në operacionet e Aleancës. Nëse NRF angazhohet, vetëm ato vende që kanë trupat në Forcë në kohën e angazhimit duhet të paguajnë. Me fjalë të tjera, nëse nuk jeni në NRF në atë kohë, nuk paguani. Jeni me fat. Për mua kjo është gati një llotari, jo një rregullim fondesh për një Aleancë të ndërtuar mbi solidaritet.

Për këtë arsye, unë kam propozuar të shtrihen fondet e zakonshme për një periudhë prove për angazhimet afatshkurtra të NRF, veçanërisht për elementin strategjik të transportit ajror. Natyrisht, kjo është një çështje për t'u diskutuar, por nëse funksionon, ajo do të forconte dukshëm kredibilitetin e NRF dhe do t'i jepte rolin e katalizatorit që ne duam të luajë për transformimin e forcës sonë. Më e pakta, kjo do të hiqte alibinë kombëtare për të mos u përfshirë.

Së treti, ne kemi nevojë të koordinohemi më mirë me aktorët e tjerë. Një leksion kyç nga Ballkani dhe tashmë edhe nga Afganistani është nevoja për të punuar më ngushtë me organizata të tjera ndërkombëtare - qeveritare dhe joqeveritare. Siguria dhe zhvillimi shkojnë krah për krah, ne të gjithë e dimë këtë, por jo gjithmonë veprojmë sikur ta dinim. Ka ende shumë ndarje midis atyre që ofrojnë siguri dhe atyre që sjellin zhvillim.

Ne duhet ta kapërcejmë këtë hendek, ne duhet të koordinojmë veprimet tona më ngushtë me OKB, BE dhe OJQ

dhe jo vetëm në terren, por edhe në nivel strategjik. Askund nuk është kjo më e dukshme sesa në Kosovë dhe Afganistan. Në Afganistan, nën drejtimin e NATO-s, ISAF ka krijuar tashmë një dritare të shanseve për zhvillim. Ajo duhet shfrytëzuar – plotësisht dhe shpejt. NATO-ja është duke bërë shumë, por ne nuk jemi as organizatë humanitare, as agjenci rindërtimi. Tashmë është koha për bashkësinë ndërkombëtare të ndërhyjë dhe ta shtyjë Afganistanin më tutje në drejtimin e duhur.

Së katërti, kemi nevojë të zhvillojmë më tej partneritetet tona. Vlera strategjike e politikës së partnershit të NATO-s është tashmë përtej çdo dyshimi. Një NATO pa partnerë është bërë me të vërtetë e paimagjinueshme. Por edhe gjërat e mira, mund të përmirësohen akoma. Veçanërisht, kemi nevojë t'i bëjmë më koherente rrjetet e partneriteteve tona. Për këtë qëllim, ne shpresojmë t'i bëjmë mjetet dhe praktikat e përdorura në programin tonë, Partneriteti për Paqe, të disponueshme dhe efektive për rrjete të tjera partneritetesh, si Dialogu Mesdhetar dhe Nisma Bashkëpunuese e Stambollit. Ne do të kërkojmë gjithashtu mundësi për shfrytëzimin e ekspertizës së NATO-s për trainimin e forcave të sigurisë së vendeve të tjera, posaçërisht në Lindjen e Mesme.

Dhe e fundit, por jo për nga rëndësia, ne do të thellojmë lidhjet tona me vendet e rajonit të Azisë-Paqësorit. Ky është një zhvillim në kohën e duhur. Australia dhe Zelanda e Re janë të përfshira përkrah nesh në Afganistan. Japonia dhe Korea e Jugut kanë treguar gjithashtu një dëshirë të marrin përsipër një pjesë më të madhe të barrës së sigurisë ndërkombëtare. Të gjithë ne përballemi me të njëjtat kërcënime dhe është në interesin e tyre, sikundër edhe tonin, që ne të vijmë më pranë njëri-tjetrit.

Përsëri, sikundër thashë edhe në fillim të komenteve të mia, ne nuk kemi nevojë për një NATO globale dhe unë nuk besoj që ndokush të ketë sugjeruar një shtrirje të NATO-s edhe në Azi. Nociione të tilla janë një diversion. Çështja reale është kjo: në përballjen me “pasigurinë e globalizuar”, ka gjithmonë e më pak rëndësi se ku ndodhet një vend në hartë. Ajo që ka më shumë rëndësi është harta mendore e tij – vullneti për t'u angazhuar, bashkë me të tjerët, për të bërë ndryshimin. Kjo është logjika e partnershit global të NATO-s. Ky është thjesht një reflektim i shndërrimit tonë nga një qasje gjeografike drejt një qasjeje funksionale të sigurisë.

Së pesti, kemi nevojë për shtimin e dialogut politik. Duke patur parasysh natyrën e ndërlikuar të mjedisit tonë të sigurisë, ne nuk mund ta shohim më NATO-n vetëm e vetëm nga prizmi i kapaciteteve të saj. Përsëri Afganistani është një rast për t'u përmendur. Për të bërë ndryshimin aty duhet të kesh një fuqi ushtarake të mjaftueshme, por gjithashtu duhet të kesh rindërtim dhe zhvillim, politika kundërnarkotike dhe ndërtim të demokracisë. Me fjalë të tjera, Afganistani dëshmon shumë qartë që kemi nevojë ta shohim sigurinë në një mënyrë më gjithëpërfshirëse.

Ky vëzhgim tërësor kërkon, së pari dhe më shumë nga të gjitha, dialogun. Kërkon që ta shohim NATO-n jo vetëm si pajisje që gjeneron forcë, por edhe si një forum për diskutime që gjithnjë e më shumë shohin përpara, drejt sfidave dhe kërcënimeve të së ardhmes. Në veçanti, ne kemi nevojë për një diskutim iluminues mbi çështje që kërkojnë një përkufizim të qartë të asaj se cili duhet të jetë - ose nuk duhet të jetë - roli i NATO-s.

Siguria energjitike është një shembull për këtë. Janë disa persona që mendojnë se kjo nuk është një çështje e përshtatshme për NATO-n, por ka edhe të tjerë që janë të bindur për të kundërtën. Këndvështrimi im është se çështjet e sigurisë energjitike, për të përdorur një metaforë të përzier, po zbresin në tubacion dhe ne duhet të shohim se cila mund të jetë vlera shtesë e NATO-s. Si sekretar i përgjithshëm, do të vazhdoj të nxis mendimet serioze në lidhje me këto dhe të tjera çështje jetësore – në kryeqytetet e NATO-s, gjithashtu edhe përmes debatit mes vendet anëtare të saj.

Së fundi, ne duhet ta thyejmë bllokimin në marrëdhënien NATO-BE. Kjo marrëdhënie aktualisht po vuan një kurrje, më shumë sesa një tejshtrirje. Në të vërtetë, duke patur parasysh përmasat e sfidave të sotme të sigurisë, është për t'u vënë re se sa e ngushtë ka mbetur axhenda e përbashkët e këtyre dy institucioneve. Kjo ka ndodhur pavarësisht shumë përpjekjeve, përfshirë edhe SDA-në, për ta sjellë NATO-n dhe BE-në sa më afër njëra-tjetrës.

Nuk ushqej asnjë iluzion në lidhje me kohën që do të duhet për të kapërcyer pengesat e njohura formale të bashkëpunimit tonë. Por kjo nuk do të thotë që ne jemi të dënuar me mosveprim. NATO-ja dhe BE-ja kanë nevojë për një dialog të qëndrueshëm për të harmonizuar shndërrimin e tyre ushtarak,

veçanërisht NRF dhe Grupet Luftarake të BE-së. Ata gjithashtu kanë nevojë për një dialog të qëndrueshëm në Kosovë, ku bashkëpunimi i patrazuar midis NATO-s dhe BE-së do të bëhet edhe më i rëndësishëm në muajt e ardhshëm.

Organizatat tona, gjithashtu kanë nevojë të largohen prej përsëritjes së nismave të njëra-tjetrës. Nëse NATO-ja ose BE-ja nisin një projekt të vlefshëm, institucioni tjetër nuk duhet të përpiqet të krijojë një nismë të ngjashme, por të mbështesë atë që tashmë ekziston. NATO-ja dhe BE-ja janë të përfshira në çështje të sigurisë dhe jo në një konkurrim bukurie. Pra, megjithëse marrëdhënia NATO-BE nuk figuron në axhendën e Rigës, është një domosdoshmëri që ajo të figurojë në planin tonë të punës për muajt e ardhshëm. Pikërisht sepse kjo marrëdhënie mund të shërbejë si çelës për zhvillimin e një qasjeje vërtet tërësore për sigurinë ndërkombëtare.

Zonja dhe zotërinj!

Kam theksuar këtu gjashtë hapat, të cilat NATO-ja duhet të ndërmarrë për ta servitur sigurinë në mënyra dhe në vende të reja. Disa prej këtyre hapave do të hidhen në Rigë, të tjera do të kërkojnë një kohë më të gjatë. Në fund të fundit ka shumë mundësi që të ketë një samit të ri në vitin 2008. Dhe në përvjetorin e 60-të të NATO-s në vitin 2009, mund të kemi një rast për një tjetër samit. Kjo vijueshmëri e ngushtë samitesh do të ruajë një trysni të shëndetshme për ta çuar përpara shndërrimin e NATO-s – dhe kjo është gjithashtu shumë pozitive. Në një botë të sfidave globale, institucionet nuk gjykohen më në varësi të asaj që përfaqësojnë. Ato tashmë gjykohen në varësi të asaj që arrijnë.

Ju faleminderit.

Gabriele Cascone
Joaquin Molina

Thellimi i Marrëdhënieve të NATO-s me Ballkanin Perëndimor

Megjithëse gjendja e sigurisë në Ballkanin Perëndimor është përmirësuar shumë që nga përfundimi i luftës, me rënien e Jugosllavisë dhe vëmendja e mediave është zhvendosur në zona të tjera konfliktuale, gjithsesi Aleanca mbetet gjerësisht e angazhuar në këtë zonë. Në të vërtetë, angazhimi i NATO-s në Ballkanin Perëndimor është rritur pasi Aleanca kërkon të integrojë të gjitha shtetet në rajon në strukturat evro-atlantike duke rritur në këtë mënyrë sigurinë dhe stabilitetin në Evropë.

Sot, NATO-ja vazhdon të ketë ndikim në Kosovë - përmes forcave të armatosura - në atë që sot për sot është operacioni më i madh paqeruajtës në botë. Aleanca po punon në mënyrë konstante gjithashtu edhe me Bosnjën dhe Hercegovinën e Serbinë dhe Malin e Zi për t'i përgatitur këto shtete për t'u bërë anëtarë të programit të NATO-s Partneriteti për Paqe (PfP). Gjithashtu NATO-ja po ndërton marrëdhënie gjithnjë e më të ngushta edhe me Shqipërinë, Kroacinë dhe ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë,* tre anëtarët e MAP (Membership Action Plan) që është një program i inicuar nga Aleanca për të përgatitur vendet aspirante për një anëtarësim të mundshëm në NATO.

Kontrasti mes situatës aktuale në Ballkanin Perëndimor dhe asaj të një dekade më parë, kur në vitin 1995 NATO-ja u detyrua të ndërhynte me trupat e saj në Bosnjë dhe Hercegovinë, nuk mund të ishte më i madh. Ndërsa në atë kohë lufta ose kërcënimi për luftë i kanosej të gjithë rajonit, sot një rikthim në periudhën e luftërave të mëdha është thuar se i pamundur, ndërsa të gjitha vendet dhe shtetet në rajon janë duke hedhur hapa të rëndësishëm drejt mundësisë, ndoshta jo imediate, por gjithsesi të afërt të integritit evro-atlantik. Për më tepër, pjesa më e madhe e progresit që është bërë gjatë periudhës së ndërhyrjes mund t'i atribuohet në mënyrë të drejtpërdrejtë

mjedisit të sigurt që forcat e NATO-s arritën të garantonin.

Gjithsesi mbeten ende shumë sfida dhe 2006-a do të jetë një periudhë kritike për rajonin. Në këtë vit do të vendoset statusi final i Kosovës. Tensionet e lidhura me të, bashkë me trazirat potenciale, që mund të përfshijnë gjatë kësaj periudhe si Kosovën ashtu edhe vendet fqinje nga një vendim i tillë, duhen menaxhuar. Gjithashtu, ky është viti në të cilin duhet të zgjidhet natyra e marrëdhënies midis Malit të Zi dhe Serbisë mbas referendumit për pavarësinë e Malit të Zi. Këtë vit boshnjakët do të zgjedhin liderët që do të skicojnë politikën që do të ndiqet nga vendi i tyre si drejtues të komunitetit shumetnik në Bosnjë-Hercegovinë, probleme këto që janë zvogëluar, pas ndërhyrjes së Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë.

Kosova

Negocimet për të vendosur për statusin final të Kosovës filluan në nëntorin e vitit të kaluar nën mbikëqyrjen e të dërguarit special të Kombeve të Bashkuara dhe ish-presidentit të Finlandës Martti Ahtisaari. NATO-ja i ka mbështetur përpjekjet e ish-presidentit Ahtisaari – si edhe ato të Grupit të Kontaktit – për të çuar negociatat përpara, për të bërë të mundur arritjen në një marrëveshje që të forcojë sigurinë dhe stabilitetin në Ballkan.

Në muajt e fundit, NATO-ja ka bërë thirrje në mënyrë të përsëritur nga të gjitha anët, për të avancuar në mënyrë konstruktive bisedimet për statusin final. Për më tepër, Aleanca mbetet e angazhuar në diskutimet e së ashtuquajturit Grupi i Zgjeruar i Kontaktit që përmban përfaqësues nga Franca, Gjermania, Italia, Rusia, Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, gjithashtu dhe Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, Presidenca e Këshillit Evropian dhe NATO-ja. Kjo përpjekje pasqyrohet më së miri me takimin në nivel ministrash që u zhvillua në Londër më 31 janar, në të cilën mori pjesë edhe vetë sekretari i përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hoop Scheffer.

Rezultatet që priten përpara përfundimit të këtij viti, duhet t'u përmbahen 10 principeve të vendosura nga Grupi i Kontaktit, menjëherë pas vendimit të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së zotit Kofi Annan 's – aprovuar nga Këshilli i Sigurisë së OKB-së – për të hapur rrugën e negociatave të mëtejshme. Këto

principe përfshijnë: përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; të vlerave demokratike dhe standardeve evropiane dhe përfshirja e dimensionit evropatlantik, bashkëjetesa e shumetniciteti, mekanizma që garantojnë përfshirjen e të gjithë popullit në qeverisje; sigurimi i ruajtjes së traditës kulturore dhe fetare të Kosovës; masa për të forcuar sigurinë dhe stabilitetin rajonal; masa që sigurojnë stabilitetin e Kosovës gjithashtu; mekanizma për të përmirësuar aftësinë e Kosovës për të forcuar shtetin ligjor dhe për të luftuar krimin e organizuar; masa që të garantojnë zhvillimin ekonomik të Kosovës; dhe një prezencë e vazhdueshme si civile ashtu edhe ushtarake të ndërkombëtarëve.

Për më tepër, rezoluta duhet të sigurojë që Kosova të mos rikthehet më në situatën para vitit 1999, kohën në të cilën NATO-s iu desh të ndërhynte me forca të armatosura, të mos ketë më ndryshime të kufijve të saj të tanishëm, pra që provincat të mos ndahen ose të bashkohen me ndonjë shtet tjetër; gjithashtu që integriteti dhe stabiliteti territorial i vendeve fqinje të respektohet. Është i nevojshëm edhe një progres në implementimin e standardeve të Kosovës, për të cilat UNMIK-u dhe qeveria e Kosovës kanë rënë dakord në 2003. Në të njëjtën kohë çdo zgjidhje që është e njëanshme ose vjen si rezultat i përdorimit të forcës është e papranueshme.

Prezenca e forcave të NATO-s në Kosovë ende shihet nga të gjithë aktorët si faktori i vetëm më kritik për garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të qetë, për të shtuar më tej stabilitetin në të gjithë rajonin. Në fund të kësaj, NATO-ja do të mbajë një prezencë ushtarake të mjaftueshme në Kosovë gjatë periudhës së bisedimeve dhe mbas vendosjes përfundimtare të statusit të Kosovës. Gjatë zgjimit të trazirave që përfshinë Kosovën gjatë marsit të 2004-ës, Aleanca ka rikonfiguruar forcat e saj në terren, që aktualisht numërohen rreth 17 000 të tilla, në mënyrë që t'i bëjë më efektive. Si rezultat, KFOR-i është transformuar gjatë gjashtëmujorit të shkuar. Në vend të katër brigadave të mëparshme ndëretnike, tashmë janë pesë të tilla (Multinational Task Forces).

Serbia dhe Mali i Zi

Zhvillimet në Serbi dhe Mal të Zi vazhdojnë të kenë një implikim të konsiderueshëm si për Kosovën ashtu edhe për

pjesën tjetër të rajonit. Marrëdhënia mes Beogradit dhe NATO-s është përmirësuar ndjeshëm që nga fushata ajrore e vitit 1999 e Aleancës për Kosovën dhe në mënyrë të veçantë që mbas ekstradimit të ish-presidentit jugosllav Slobodan Miloseviç një vit më pas. Për më tepër, Serbia dhe Mali i Zi kanë aplikuar në mënyrë formale për anëtarësim në programin PfP të NATO-s në korrik 2002 duke shpresuar të ftohen për të marrë pjesë në takimin e Rigës që Aleanca do të zhvillojë në nëntor.

Arrestimi dhe ekstradimi i presidentit Milloseviç në gjykatën ndërkombëtare të krimeve të rënda për Jugosllavinë në Hagë dhe më pas vdekja e tij në mars të 2006-ës mundet që një ditë të shihen si simboli i përfundimit të periudhës së përgjakur në historinë e Serbisë e Malit të Zi dhe më gjerë të të gjithë rajonit. Gjithsesi tani nuk është shumë e qartë nëse kjo fazë është kaluar përfundimisht. Në të vërtetë ekstremistët janë përpjekur të nxjerrin përfitime politike si nga vdekja e presidentit ashtu edhe nga frika e Serbisë për humbjen e Kosovës. Kjo situatë mund të ringjallë gjatë procesit disa nga retorikat intolerante të vitit 1990.

Bashkimi Evropian vendosi në tetor të 2005 të nisë bisedimet për marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me Serbinë dhe Malin e Zi, por i ndërpreu ato menjëherë pasi Beogradi nuk respektoi afatin e 30 prillit për të dorëzuar Ratko Mladiçin, komandantin serb në luftën e Bosnjës, të akuzuar për gjenocid nga Gjykata e Hagës. Gjithashtu, çështja e bashkëpunimit me këtë gjykatë është faktori kryesor që po e pengon Serbinë dhe Malin e Zi për anëtarësimin në PfP.

Që nga viti 2003, NATO-ja po mbështet Serbinë dhe Malin e Zi me Programin e Bashkëpunimit (Tailored Cooperation Programme), program ky që përmban një numër aktivitetesh dhe reformash parapërgatitore të PfP të fokusuara në çështjet e mbrojtjes. Ky program gjithashtu lejon pjesëmarrjen në disa evenimente të caktuara të PfP. Përveç kësaj, NATO-ja ka rënë dakord të hapë një Zyrë Ushtarake Koordinimi (Military Liaison Office) në Beograd dhe, bashkë me Ministrinë e Mbrojtjes së Serbisë dhe Malit të Zi kanë formuar Grupin për Reformimin e Mbrojtjes (Defence Reform Group). Ky grup zhvilloi takimin e tij të parë në shkurt për të mbështetur përpjekjet e mëtejshme të reformës së mbrojtjes në vend.

Programet ekzistuese të NATO-s kanë kontribuar në përmirësimin e marrëdhënieve mes Aleancës dhe Serbisë e

Malit të Zi. Gjithsesi kjo marrëdhënie nuk mund të vazhdojë të rritet, derisa Belgrade të pranojë të bashkëpunojë në mënyrë të plotë me Gjykatën e Hagës, duke dorëzuar të gjithë të akuzuarit prej saj, përfshirë edhe komandantin Mladiç. Për më tepër mbas votimit të Malit të Zi në favor të pavarësisë, një shtet i ri po lind në rajon, gjë që mund të bëhet gjithashtu pjesë e përpjekjeve të Aleancës për integrim.

Bosnja dhe Hercegovina

Një mungesë e ngjashme bashkëpunimi me Gjykatën e Hagës që është vënë re edhe në Bosnjë dhe në veçanti nga ana e Republikës Sërpska, po udhëheq anëtarësimin në PfP për Bosnjën dhe Hercegovinën. Përveç kësaj, NATO-ja tashmë po punon në këtë vend duke e ndihmuar që të përmbushë disa kritere të diktuar nga Programi PfP dhe një anëtarësim i mundshëm edhe në NATO.

Megjithëse NATO-ja ka marrë përsipër përgjegjësinë për sigurinë, sot për sot në Bosnjë dhe Hercegovinë, gjë që e garanton me anën e 7000 trupave të armatosur EUFOR; me anë të forcave të Bashkimit Evropian që ka vendosur atje, në dhjetor 2004, Aleanca vendosi të mbante prezencë fizike të trupave të saj brenda territorit të këtij shteti. Komanda e NATO-s në Sarajevë, që përbëhet nga rreth 150 punonjës, merret kryesisht me Reformimin e Mbrojtjes në kuadër të Programit të Bashkëpunimit (Tailored Cooperation Programme). Gjithashtu, kjo komandë merret me çështjet e kundër-terrorizmit, ndjekjen dhe arrestimin e të dyshuarve për krime lufte dhe shërbime inteligjente. Në këtë mënyrë NATO-ja po ndihmon për të ndërtuar një armatë të vetme me forca të armatosura duke shkrirë tre njësitë rivale ushtarake që ekzistonin në fund të trazirave në vitin 1995.

Në prill të këtij viti, Sekretari i Përgjithshëm De Hoop Scheffer apeloj pranë Aleancës për të financuar PfP Trust Fund, për të ndihmuar Bosnjën dhe Hercegovinën për të demobilizuar ushtarët dhe për të mbështetur riintegrimin e tyre në jetën civile. Megjithëse skema e fondit është akoma në përpunim e sipër mendohet që të jetë Trust Fondi më i madh që NATO-ja do të akordojë.

Progresi në Reformën e Mbrojtjes mendohet që do ta ndihmojë Bosnjën dhe Hercegovinën për t'u shndërruar nga

një vend me nevoja të mëdha për siguri në një vend që mund ta “prodhojë” vetë sigurinë. Në të vërtetë, ky shtet ka filluar të japë kontributin e tij për operacionet ndërkombëtare të stabilizimit që nga nëntori i vitit të kaluar kur dërgoi në Irak 36 skuadra ekspertësh të armatosur.

Rezultati i zgjedhjeve të planifikuara për 1 tetorin e këtij viti do të jetë tepër i rëndësishëm, sepse natyra e forcave ndërkombëtare prezente në Bosnjë dhe Hercegovinë do të ndryshojë. Vendi i Përfaqësuesit të Lartë, i cili ka mbikëqyrur implementimin e procesit të paqes, duke përfutur nga një fuqi e pazakontë do t'i duhet të largohet diku nga mesi i parë i vitit 2007. Në vend të tij, një përfaqësues tjetër special nga Bashkimi Evropian do të përpiqet të asistojë në vazhdimësinë e transformimit të Bosnjës dhe Hercegovinës. Ky mision ka një ndikim të rëndësishëm në integrimin e këtij vendi në Evropë. Bisedimet për Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me Bashkimin Evropian u nënshkrua në janar të këtij viti.

Treshja e MAP

Që të tria vendet e MAP – Shqipëria, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë* – kanë bërë progrese të qëndrueshme në fushën e Reformës së Mbrojtjes, duke zhvilluar dhe implementuar gjithnjë e më shumë programe realiste nën mbështetjen e NATO-s. Në rastin e Shqipërisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë,* Aleanca ka vendosur komanda ushtarake brenda territorit të vendit për t'i asistuar gjatë Reformës së tyre të Mbrojtjes.

Megjithëse partneriteti në NATO i Shqipërisë, Kroacisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* nuk është në agjendën e Samitit të Rigës, këto vende po e integrojnë veten e tyre në strukturat e NATO-s brenda axhendës së MAP. Gjithnjë e më shumë ato po kontribuojnë me trupa ushtarake në Afganistan nën udhëheqjen e NATO-s International Security Assistance Force (ISAF). Të tre vendet gjithnjë e më shumë po punojnë bashkë për Kartën e Adriatikut të sponsorizuar nga Shtetet e Bashkuara dhe gjithashtu po kontribuojnë me një skuadër mjekësore e përbërë nga 12 persona në ISAF.

Duke aspiruar për anëtarësim në NATO, Shqipëria, Kroacia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë* po përpiqen gjithashtu të aderojnë në Bashkimin Evropian në mundësinë

e parë që iu jepet. Shqipëria sapo e ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me Bashkimin Evropian, Kroacia filloi bisedimet për hyrjen në tetor të vitit të kaluar, mbas arrestimit të Ante Gotovina, oficeri më i lartë kroat që u akuzua nga Gjykata e Hagës në dhjetor, tani mund ta çojë këtë marrëdhënie përpara. Ndërsa ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* i është dhënë statusi i kandidatit të BE në dhjetor të vitit të kaluar.

E ardhmja e Shqipërisë, Kroacisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* është e qartë dhe shtrihet gjithnjë e më shumë drejt integritetit të plotë evropian dhe evro-atlantik. Afatet kohore për këto procese nuk janë shumë të fiksuara për vetë faktin se varen nga cilësia me të cilën çdo vend do të vazhdojë të implementojë këtë seri të gjerë reformash. Gjithsesi, për aq kohë sa të tria vendet do të vazhdojnë të bëjnë progres, si këto që kanë bërë këto vitet e fundit, ato do të konsiderohen kandidatë të fortë për të aderuar në Samitin e NATO-s në vitin 2008. Në këtë mënyrë ato do të krijojnë gjithashtu një shembull për t'u ndjekur nga pjesa e mbetur e vendeve të rajonit: Serbia, Mali i Zi dhe Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, stabiliteti, siguria dhe zhvillimi i të cilëve në pjesën më të madhe varet nga marrëdhënia që ata do të ndërtojnë me NATO-n dhe Bashkimin Evropian.

Gabriele Cascone dhe Joaquin Molina janë përgjegjës të NATO-s për Ballkanin Perëndimor, respektivisht në çështjet politike dhe të sigurisë dhe Divizioni i Operacioneve.

Prof. Rexhep Meidani

Paqeruajtja dhe ndërhyrja, siguria dhe NATO-ja

Hyrje

Debatet realiste mbi globalizimin, por dhe mbi raportet e reja midis individit, bashkësisë, shtetit e organizmave ndërkombëtare, janë disi të zhvendosur nga fokusimi fillestar, pas ngjarjeve tragjike të II shtatorit dhe spirales së sotme të terrorizmit. Sidoqoftë, krahas problemeve të sigurisë njerëzore, sidomos në kuadër të një veprimtarie terroriste intensive, ato kanë mbetur e mbeten me epërsi në axhendën e veprimit rajonal e ndërkombëtar.

Globalizimi, si një proces integrues ekonomiko-shoqëror dhe politik, nëpërmjet të cilit synohet të zhvillohet një *lëvizje e lirë* në rritje të ideve, njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitaleve, pasqyron një *prirje njerëzore e natyrore* për zhvillim e komunikim, për një *hapje* gjithnjë e më të madhe politike, ekonomike e shoqërore dhe një *ndërveprim* më të fuqishëm, duke e vendosur kështu gradualisht *ndërvarësinë* në pedestalin e një botëkuptimi bashkëkohor dhe duke e shndërruar atë në themelin e një rendi të ri botëror. Në këtë kuadër, në qendër të vëmendjes del rritja e *sigurisë njerëzore*, jo vetëm në kuptimin individual, rajonal e global apo në kuptimin territorial e politiko-kombëtar, por dhe si veprim *parandalues e goditës* ndërkombëtar.

Operacionet ndërkombëtare si operacione të paqes e sigurisë globale.

Në kapitullin VII të Kartës së OKB-së thuhet se: “*Këshilli i Sigurimit duhet të përcaktojë ekzistencën e çdo kërcënimi për paqen, për cenimin e saj apo të ndonjë akti agresioni dhe do të duhet të japë rekomandime ose të vendosë çfarë masash duhet të merren në përputhje me nenet 41 e 42, për të ruajtur paqen apo rivendosur paqen e sigurinë ndërkombëtare*” (neni 39). “*Këshilli i Sigurimit mund të vendosë çfarë masash, që*

nuk e përfshijnë përdorimin e forcës së armatosur, duhen zbatuar për të pasur rezultate të efektshme, në përputhje me vendimet e tij. Ai mund t'u bëjë thirrje shteteve-anëtare të OKB-së në zbatimin e masave të tilla. Ato mund të jenë ndërprerje të plota apo të pjesshme të shkëmbimeve ekonomike, të lidhjeve hekurudhore, detare, ajrore, postare, telegrafike, radiofonike dhe të mjeteve të tjera të komunikimit apo dhe ashpërsime të lidhjeve diplomatike.” (neni 41). Kurse në nenin 42 të po këtij kapitulli flitet qartësisht për ndërhyrjen: “*Nëse Këshilli i Sigurimit arrin në përfundimin se masat e parashikuara në nenin 41 rezultojnë të papërshtatshme apo provohen si të tilla, ai mund të vendosë që të ndërmarrë veprime me anë të forcave ajrore, detare e tokësore, si të gjykohet e nevojshme, për të ruajtur apo rivendosur paqen e sigurinë ndërkombëtare. Aksione të tilla mund të jenë demonstrime force, bllokada apo operacione me anë të forcave ajrore, detare e tokësore të shteteve-anëtare të OKB-së”...*

Gjatë dekadave të shkuara, u duk qartë se përpjekjet për të garantuar sigurinë territoriale të kombeve ose të blloqeve ushtarake nuk ishin gjithmonë të suksesshme në përmirësimin e kushteve të *sigurisë njerëzore*. Për më tepër, edhe kur kufijtë e disa shteteve mbeten të sigurt nga kërcënimet e huaja, popujt brenda kufijve të këtyre shteteve mund të mos ndihen domosdo të çliruar nga krimi, të mos kenë ushqim të mjaftueshëm, të mos gëzojnë kujdesin e nevojshëm shëndetësor, arsimin e duhur apo liritë politike. Kjo nënkupton se *koncepti i sigurisë* për një kohë mjaft të gjatë është interpretuar në mënyrë të ngushtë: si siguri e territorit nga agresioni i jashtëm, si mbrojtje e interesave kombëtare në politikën e jashtme, etj., d.m.th. siguria ka qenë e lidhur më shumë me vendet konkrete sesa me popujt e tyre, më shumë me *sigurinë e shtetit* sesa me *sigurinë e njeriut*. Një gjë e tillë është konstatuar dhe në historinë e një dhjetëvjeçari gjakderdhjesh në Ballkan, menjëherë pas rënies së Murit të Berlinit.

Periodha e pas Luftës së Ftohtë është ende në procesin e evolimitit e formësimit. Ndryshimi i marrëdhënieve midis shteteve të veçanta dhe organizatave ndërkombëtare mbetet një temë e madhe e kësaj epoke, në mënyrë të veçantë për sa i përket të Drejtës Ndërkombëtare, përfshirë dhe *operacionet paqeruajtëse e ndërhyrëse*. Kjo doli veçanërisht qartë në ngjarjet e vitit 1999 në Kosovë dhe Timorin Lindor, dhe është shfaqur me të njëjtin shqetësim e rëndësi edhe në zhvillimet e tjera në Bosnjë, Sierra Leone, Kongo, Afganistan, Irak, etj., apo së fundi në Liban.

Paqeruajtja dhe ndërhyrja, me specifikat e tyre, ishin e mbeten kështu subjekte trajtimi e interesi jo vetëm për politikën e jashtme, në trajtimin e krizave dhe konflikteve, por dhe për juristët e legjislacionit ndërkombëtar, për të pasqyruar ndryshimet intensive që po shoqërojnë *procesin e globalizimit* dhe përpjekjet për garantimin e sigurisë njerëzore. Të tilla janë, për shembull, përgjegjësitë dhe autoriteti i bashkësisë ndërkombëtare, veçanërisht në botën e sotme, në të cilën të drejtat individuale të njeriut kërkohen të balancohen më mirë, madje edhe në kurriz të “interesave” kombëtare apo të vetë shteteve-kombe.

Pyetja që mund të shtrohet sot është: a është ndryshuar në thelb statusi legal dhe praktik i qeverive kombëtare në zhvillimet e dhjetëvjeçarit të fundit? Dhe në fund të fundit, ç’probleme teorike e praktike, kanë lindur, në kryerjen e operacioneve paqeruajtëse e ndërhyrëse? Të dy tipat e operacioneve, paqeruajtja dhe ndërhyrja, janë të ndërlidhura, por jo patjetër identike. Operacioni paqeruajtës mund të realizohet në dy rrugë, me anë të *pajtimit*, sipas kapitujve V e VI të Kartës së OKB-së, ose nëpërmjet *detyrimit*, sipas kapitullit VII. Rruga e parë, si një model klasik paqeruajtës, e praktikuar më parë nga OKB-ja, zakonisht shoqërohet me një marrëveshje pushim zjarri, si në rastin e Maqedonisë më 2001, apo, të paktën, me negociata politike si në rastin e Shqipërisë më 1997. Deri në fundin e Luftës së Ftohtë, veprimtaritë paqeruajtëse tradicionale apo klasike të bazuara në kapitullin IV të Kartës së OKB-së, përfshinin situata brenda shtetërore apo dhe operacione më të ndërlikuara, që klasifikoheshin si paqe-ndërtuese apo ndërhyrje post-konflikt. Në praktikën e sotme ndërhyrja është shumë më e ndryshme nga paqeruajtja tradicionale, madje ajo aplikohet kur mungon konsensusi, të paktën nga njëra palë në konflikt. *Përdorimi i forcës* ose, të paktën, i kërcënimit prej instrumentit të jashtëm autorizohet në bazë të kapitullit VII të Kartës së OKB-së.

Me përjashtim të operacioneve në Kongo në vitet ’60, OKB-ja, deri në vitin 1990, u angazhua në operacione vetëm mbi bazën e Kapitullit VI, gjë që pranohej si një angazhim operacional tradicional paqeruajtës, në të cilin forca shumëkombëshe mund të shfrytëzohej vetëm në *vetëmbrojtje*. Sidoqoftë, përvoja e grumbulluar që nga viti 1945 është pasqyruar në periudhën e fundit me futjen e praktikave të reja në përdorimin e operacioneve shumëkombëshe paqeruajtëse e ndërhyrëse. Kështu, duke filluar me Rezolutën 794 të Këshillit të Sigurimit në 1992, *përdorimi i forcës* ushtarake për qëllime

humanitare u autorizua në bazë të Kapitullit VII të Kartës. Që nga ajo kohë, janë realizuar ndërhyrje të tjera me forcë, duke gjykuar e kombinuar midis tyre shkaqet humanitare e të drejtat e njeriut, vendosjen e paqes apo probleme të sigurisë. Në këtë mënyrë u bënë ndryshime të shënueshme në praktikën e operacioneve, si pasojë edhe në konceptimin praktik e interpretues të ligjit ndërkombëtar. Rrjedhojë e këtij ndryshimi, në konceptimin e ndërhyrjes, është dhe detyrimi ligjor pothuajse për të gjitha shtetet për investigim, ndjekje e arrestim të *kriminelëve të luftës*, si në rastin e Ruandës apo ish-Jugosllavisë, me Gjykata Speciale, apo aktualisht me *Gjykatën Penale Ndërkombëtare*. Përfundimi tjetër i këtyre dhjetë viteve të kësaj praktike është dhe pranimi i qartë nga bashkësia ndërkombëtare i të drejtës së ndërhyrjes, veçanërisht kur kjo ndërhyrje është autorizuar si e tillë nga *Këshilli i Sigurimit, si autoritet leje-dhënës*.

Sidoqoftë, në zbatimin e operacioneve ndërkombëtare konstatohen ndërthurje, madje shpesh edhe ngatërresa. Bile, ngatërrimi apo konfuzioni me pasoja tragjike midis dy tipave të operacioneve mund të vihet re në mënyrën më të qartë në fillim të luftës në Bosnjë, në periudhën '90 - '92. Ishte ajo përvojë e hidhur që çoi në përfundimin se Kombet e Bashkuara, si organizata më e madhe ndërkombëtare, nuk kishte kompetencën e mjaftueshme të zhvillonte luftë, d.m.th. të udhëhiqte një ndërhyrje me forcë. Tashmë, përgjithësisht, pranohet se ndërhyrje të tilla preferohen t'u lihen *koalicioneve të vullnetit*. Ky koalicion vullneti, p.sh. në rastin e Bosnjës, Kosovës apo Afganistanit ishte NATO-ja, operacioni ndërhyrës i së cilës është autorizuar fillimisht (apo pak më vonë) nga Këshilli i Sigurimit. Pa përjashtuar këtu mundësinë (ndryshe nga rasti i lidhur fillimisht me Irakun), që në operacionet e ndërhyrjes, të përfshihen edhe Kombet e Bashkuara si një autoritet qeverisës, si shoqërues apo pas përdorimit të forcës ndërhyrëse. Kjo praktikë është vënë re për herë të parë në Kamboxhia, në fillim të viteve '90. Më tej u vendosën administratat kalimtare të OKB-së në disa territore të ish-Jugosllavisë, ku rasti më i përpunuar ishte ai i Kosovës dhe pak më vonë ai i Timorit Lindor.

Përmbajtja e kushteve, që justifikojnë ndërhyrjen ndërkombëtare, është tashmë teorikisht e pranuar, por probleme praktike e hezitime në vendimmarrje janë shfaqur e do të shfaqen edhe në të ardhmen, në situata të veçanta. Me thellimin e proceseve integruese e globalizuese mund të

kërkohen edhe përpunime të tjera ligjore, të teorisë e praktikës ndërkombëtare, sidomos në kuadër të luftës aktuale kundër terrorizmit. Në fund të fundit, ky trajtim i ri ndërkombëtar, në respektim të sigurisë e të drejtave njerëzore, do të zhvendosë më tej drejt një shkalle më të lartë ndërvlerësive vetë mendësinë, ende të patejkaluar, të shtetit komb apo atë të pavarësisë klasike kombëtare. Këto janë arsye të mjaftueshme për të besuar që në botën globale që po ndërtohet, në vend të konceptit të vjetër të *pavarësisë* ose *sovrانيتit klasik*, duhet të përpunohet më tej koncepti i *ndërvlerësive*, qoftë dhe si *përgjegjësi ndërkombëtare* ndaj çështjeve të paqes, stabilitetit, të drejtave të njeriut, sigurisë njerëzore e zhvillimit të gjithanshëm shoqëror. Në këtë mënyrë bëhet më i pajtueshëm *parimi i vetëvendosjes* me *parimin e ndërvlerësive*, duke zhvendosur kështu shkallë-shkallë, në përputhje me zhvillimet shoqërore, elementë të sovranitetit klasik, në fusha të përcaktuara të qeverisjes, drejt autoriteteve mbikombëtare...

Aq më e dobishme, madje tepër e domosdoshme, bëhet kjo ndërvlerësi e ndërveprim në fushën e sigurisë njerëzore, në luftën globale kundër terrorizmit dhe dukurive mbështetëse e shoqëruese të tij; në angazhimin e ristrukturimit e Forcave të Armatosura mbi bazën e këtyre koncepteve të reja në politikën tonë të Mbrojtjes e të Sigurimit Kombëtar, *duke modeluar* njëkohësisht, në përputhje me kushtet konkrete dhe bashkëveprimin e ngushtë euroatlantik, detyrat mbrojtëse vendore me ato ndërkombëtare (siç është pjesëmarrja e trupave tanë ushtarakë në Bosnjë, Afganistan dhe Irak). Nga ana tjetër, një gjë e tillë përcakton dhe një konceptim sa më bashkëkohor të detyrave lidhur me ruajtjen e kufijve të hapësirave tokësore, detare e ajrore të Republikës së Shqipërisë. Bashkëveprimi tepër i ngushtë me NATO-n gjatë krizës kosovare, vënia në dispozicion të hapësirave tona ndaj trupave të saj, në misionin e tyre ndërhyrës, humanitar e paqeruajtës, është një dëshmi mëse e qartë, një mishërim kuptimplotë i këtyre koncepteve të reja në fushën e mbrojtjes, paqes, demokracisë, stabilitetit e sigurisë.

NATO-ja më shumë se strukturë sigurie

Ndër strukturat politike ose jopolitike të sigurisë, me veprim të drejtë apo të tërthortë, si: Këshilli i Sigurimit, KE-ja, OSBE-ja, Interpoli, Evropoli, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë,

Gjykata Penale Ndërkombëtare, etj., NATO-ja, pavarësisht përcaktimit të fundit të Sekretarit të Përgjithshëm të saj Scheffer si një *“strukturë jo globale”*, është një nga organizatat më të fuqishme ndërkombëtare të *sigurisë kolektive*, por dhe një shtytëse e mbështetëse e fuqishme e reformave demokratizuese sa në fushën ushtarake, po aq dhe në atë institucionale e civile.

NATO-ja (North Atlantic Treaty Organisation) është një aleancë 26 vendesh nga Evropa dhe Amerika e Veriut, të angazhuar në plotësimin e objektivave të Traktatit të Atlantikut Verior, të firmosur më 4 prill 1949. Bërthama e këtij traktati është artikulli V, sipas të cilit: *“Palët kanë rënë dakord që një sulm i armatosur kundër një shteti anëtar ose disa prej tyre, në Evropë apo Amerikën e Veriut, të konsiderohet si një sulm kundër të gjithëve shteteve anëtare. Si pasojë, ato janë dakord që, nëse ndodh një sulm i tillë i armatosur, secili prej shteteve anëtare, në ushtrim të drejtës së vetë-mbrojtjes individuale apo kolektive, të njohur nga artikulli 51 i Kartës së OKB-së, do të asistojë shtetin apo shtetet anëtare të sulmuara duke ndërmarrë menjëherë, në mënyrë individuale apo në bashkëpunim me shtetet e tjera anëtare, një veprim që e gjykon të nevojshëm, përfshirë përdorimin e forcës së armatosur, për të rikthyer apo ruajtur sigurinë në hapësirën e Atlantikut Verior”*. Aktivizimi i këtij artikulli për herë të parë ndodhi më 12 shtator 2001 një ditë pas sulmeve terroriste në SHBA.

Ky akt ishte dhe një shprehje konkrete e *Solidaritetit* si një nga tiparet themelore të kësaj organizate, krahas karakteristikave të tjera bazë si: *Liria, Siguria* dhe *Lidhja Transatlantike*. Në lidhje me Lirinë, në përputhje me këtë Traktat, roli bazë i NATO-s është për të garantuar dhe ruajtur lirinë dhe sigurinë e vendeve anëtare të organizatës me mjete politike e ushtarake. Ndërsa, lidhur me Sigurinë, NATO-ja vigjilon dhe siguron vlerat e përbashkëta të demokracisë, të lirive individuale, të zbatimit të ligjit e normave bashkëkohore të shtetit të së drejtës apo zgjidhjen paqësore të konflikteve. Ajo i promovon këto vlera në të gjithë zonën Evro-Atlantike, por dhe në vende të tjera me të cilët ajo ndërvepron. Po ashtu, në kuadër të Lidhjes Transatlantike, NATO-ja mishëron ndërlidhjen apo bashkëveprimin ndëratlantik, me anë të cilëve siguria e Amerikës së Veriut dhe ajo e Evropës janë të lidhura në mënyrë të ngushtë dhe të vazhdueshme me njëra-tjetrën. Për këtë arsye ajo sintetizon dhe një koagulim praktik të

përpjekjeve kolektive efektive midis vendeve anëtare në mbështetje të interesave të tyre të përbashkëta. Si shprehje e këtyre interesave janë dhe pjesëmarrja në *koalicionet e vullnetit*, apo në *operacione humanitare* si në rastin e asistimit të Shqipërisë gjatë krizës kosovare.

NATO-ja, si strukturë kolektive, në aksionin e saj karakterizohet nga: *Konsultimi*, *Mbrojtja*, *Menaxhimi i krizave* dhe *Partneriteti*. Kështu, NATO-ja si urë midis Amerikës së Veriut dhe Evropës ka krijuar kështu një *Forum* mjaft të rëndësishëm, në të cilin SHBA-ja, Kanadaja dhe vende evropiane konsultohen midis tyre për çështje të sigurisë e me interes të përbashkët, duke ndërmarrë dhe veprime konkrete lidhur me to. Po ashtu, NATO-ja është e angazhuar tërësisht në mbrojtje të shteteve anëtare. Si dispozitiv ushtarak, në përputhje me artikullin V, ajo vihet menjëherë në mbrojtje të secilit vend anëtar në rast sulmi ndaj tij apo kur ky vend kërcënohet nga ndonjë agresion i jashtëm, sipas parimit që “*një sulm mbi një shtet apo disa shtete anëtare është një sulm ndaj të gjithë Aleancës*”. Por, krahas veprimtarisë në fushën e Konsultimit dhe të Mbrojtjes, forca të udhëhequra nga NATO-ja ndihmojnë në Menaxhimin e krizave, në zgjidhjen apo përfundimin e konflikteve nëpërmjet ndërhyrjes së armatosur si në Bosnjë, Kosovë, etj., për të rikthyer paqen e stabilitetin, apo për të parandaluar shtrirjen e konfliktit, si në Maqedoni. Po aq i rëndësishëm është dhe Partneriteti, elementë bazë të të cilit, në kuadër edhe të *Partneritetit për Paqe*, janë dialogu e bashkëpunimi me vendet jo anëtare për të kapërcyer ndarjet e prapambetjet e trashëguara nga periudha e Luftës së Ftohtë, por edhe për të zgjeruar hapësirat e sigurisë dhe të stabilitetit përtej kufijve të hapësirës “NATO”.

Në mënyrën e funksionimit të NATO-s mund të veçohen këto elementë: *Vendimmarrja*, *Udhëheqja politike*, *Struktura ushtarake* dhe *Partneriteti e Kolegjialiteti*. Në lidhje me Vendimmarrjen mund të nënvizohet se NATO-ja është një organizatë ndërqeveritare. Të 26 anëtarët e ruajnë sovranitetin e tyre të plotë. Të gjithë vendimet merren së bashku mbi *bazën e konsensusit*. Ndërsa për sa i përket Udhëheqjes politike, trupa më e rëndësishme vendimmarrëse e NATO-s është Këshilli i Atlantikut Verior (North Atlantic Council) në të cilën mblidhen së bashku përfaqësuesit e 26 aleatëve në nivelin e ambasadorëve, ministrave apo *kryetarëve të shteteve e qeverive*. Ndërsa Struktura ushtarake e NATO-s është sistemi

i planizimit, organizimit dhe komandimit të një force ushtarake shumëkombëshe. Ajo realizon, krahas planizimit të përbashkët, trajnimet e stërvitjet, dislokimet ushtarake nën komandën e komandantëve strategjikë të saj. Në kuadër të Partneritetit dhe Kolegjialitetit, mund të thuhet se struktura e NATO-s dhe mekanizmat e saj përcaktojnë dhe kuadrin e plotë të bashkëpunimit me vendet partnere. Kjo përbën dhe një pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së përditshme të Aleancës, që përfshin dhe organizime të tilla si: *Këshilli i Partneritetit Evro-Atlantik* (Evro-Atlantic Partnership Council), *Partneriteti për Paqe* (Partnership for Peace Programme), *Karta e Adriatikut* (Kroaci-Shqipëri-Maqedoni), *Këshilli NATO-Rusi* (NATO-Russia Council), *Komisioni NATO-Ukrainë* (NATO-Ukraine Commission), *Dialogu mesdhetar* (Mediterranean Dialog), etj.

Në axhendën e NATO-s si përbërëse bazë është dhe *Transformim-Reformimi*, ku përfshihen: *Anëtarësime të ardhshme*, *Kapacitete të reja*, *Marrëdhënie e lidhje të reja*, *Masa konkrete për reformim e transformim*. Në Samitin e Pragës, më 20-21 nëntor 2002 u projektua një proces modernizimi i Aleancës, me qëllim që ajo të arrijë të përballojë me sukses sfidat e sigurisë së shekullit XXI, sidomos të atyre të lidhura me *terrorizmin*. Ndërsa, në lidhje me procesin e anëtarësimit një hap i madh u bë më 29 mars 2004, me pranimin e 7 anëtarëve të rinj (Bullgari, Estoni, Letoni, Lituani, Rumani, Sllovakia e Slloveni). Po kështu, në kuadër të rritjes së kapaciteteve të përgjigjes dhe reagimit, në Samitin e Pragës u morën vendime të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve operacionale dhe të aftësisë goditëse ndaj kërcënimeve të shumëfishta të sigurisë. Një ndër këto vendime ishte dhe krijimi i *forcës së reagimit të shpejtë* (NATO Response Force). Ndërsa, në fushën e zgjerimit të marrëdhënieve, NATO-ja po rrit dhe thellon bashkëpunimin me vende partnere apo vendet me status të veçantë si Rusia, por dhe me organizma të tjerë ndërkombëtarë. Ajo po zhvillon gjithashtu një partneritet strategjik me BE-në (p.sh. "Berlin Plus" si projektim i Samitit të Uashingtonit të 24 prillit 1999), sidomos shmangie të paralelizmave me strukturën evropiane të quajtur *Identiteti i Sigurisë dhe Mbrojtjes Evropiane* (ESDI-Evropian Security and Defence Identity). Më 28-29 nëntor 2006 në Letoni do të mbahet Samiti i 19-të i NATO-s, që mendohet të përqendrohet më shumë në problemet e transformimeve më të thella të organizatës, sidomos në pistimin e një rruge të re të saj, në kushtet e globalizimit dhe të luftës kundër terrorizmit. Po ashtu, pritet që aty Ukraina dhe Gjeorgjia të bëhen vende pjesëmarrëse

në kuadër të Planit të Veprimit për Anëtarësim (MAP-Membership Action Plan), ndërkohë që vendet ekzistuese pjesëmarrëse në MAP si Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia, siç duket nga deklaratat e fundit, nuk do të arrijnë, as në këtë samit, objektivin e tyre të përfundimit të procesit të anëtarësimit të plotë.

Ballkani Perëndimor dhe kombi shqiptar

Ndryshimet thelbësore integruese evropatlantike, që po ndodhin në hapësirat NATO dhe BE, është e domosdoshme që të kuptohen e të pasqyrohen drejt në Ballkan, dhe më veçanërisht në Ballkanin Perëndimor. Ato duhet të gjejnë aty kuptim dhe mishërim sa më të drejtë, në mënyrë që të zhvillohen sa më shëndetshëm demokracitë shumetnike dhe të ndërtohen *shtetet e qytetarëve* në Bosnjë, Kosovë, Maqedoni, etj., në vend të shteteve nacionale. Sidomos nacionalizmi e shovinizmi serb ishin shkak i krizave dhe luftërave në territorin e ish-Federatës Jugosllave me ardhjen në fuqi të regjimit të Millosheviçit, në vitin 1989. Një politikë e tillë shtetërore, ende e paçmontuar deri në qelizat e saj, solli rrjedhoja tepër të dhimbshme për sigurinë njerëzore dhe zhvillimet demokratike e integruese në Ballkanin Perëndimor, e sidomos për popullsinë shqiptare, për të cilën një rol tepër të rëndësishëm ka dhe vetë shteti amë, pavarësisht deformimeve, problemeve e vështirësive jo të vogla, që po kalon ai. Megjithatë, tashmë, Shqipëria i ka kapërcyer fazat e krizave të mëdha dhe nga një *konsumator i sigurisë* është shndërruar në një *prodhues të sigurisë* në rajon. Aktualisht, mbështetja e plotë dhe pjesëmarrja në koalicionin botëror kundër terrorizmit dhe materializimi hap pas hapi i objektivave të sigurisë njerëzore mbeten sot një nga elementët themelorë, mjaft kuptimplotë e të rëndësishëm, të shtetit dhe shoqërisë shqiptare. Gjithashtu, shteti shqiptar e ka bërë vazhdimisht të qartë se integrimi i plotë në NATO dhe në BE, si aspirata mbarëpopullore, janë *epërsitë absolute* të politikës së saj.

Po kështu, Shqipëria synon që këto objektiva madhore të shndërrohen dhe në kolona bazë të të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, në përmirësimin dhe ngritjen e standardeve të tyre në nivelin e kërkesave të NATO-s dhe BE-së dhe mbi të gjitha, në plotësimin hap pas hapi të të gjitha kushteve për futjen dhe integrimin e plotë në të *dy këto struktura*. Kjo është e vetmja mënyrë për të garantuar paqen dhe stabilitetin në rajon, rrugën tonë të përbashkët dhe të sigurt

përpara. Në përputhje me këto dy orientime të mëdha të rajonit tonë dhe të shërbimit ndaj tyre, shqiptarët janë e do të jenë të gatshëm të bashkëpunojnë me çdo shtet dhe strukturë demokratike. Në të kundërt, çdo përpjekje për të ecur në drejtim të kundërt ose për t'u larguar nga këto objektiva të mëdha dhe orientime të qarta është e destinuar të dështojë. Ndërsa, nga ana tjetër, ashtu si dhe deri tani, NATO-ja dhe BE-ja duhet të ndihmojnë vendet tona duke i mbajtur dyert e hapura për to. Dhe kjo nuk nënkupton vetëm zgjerimin e NATO-s, por dhe mobilizimin e vendeve tona që në bashkëpunim me NATO-n të rrisin ndërveprimin me strukturat inteligjente apo pjesëmarrjen në koalicionet e vullnetit për të përballuar sfidat e terrorizmit dhe të paqëndrueshmërive të tjera në rajone të ndryshme, për të rritur sigurinë në kufi, cilësinë e dokumentimit dhe të verifikimit, bashkëveprimin ndërkuftar, etj. Gjithashtu, sot, ekziston një mendim i formësuar se *integrimi ynë rajonal*, veçanërisht në fushën e infrastrukturës dhe kryesisht atë të energjisë, është një hap i domosdoshëm përpara drejt *integritimit evro-atlantik*. Madje, siç gjykohej me të drejtë fillimisht, *integrimi tërësor* i Ballkanit në BE do të duhej të vlerësohej si një prioritet ndaj *integritimit diferencial* apo *shtet pas shteti*. Në të njëjtën kohë, nuk mund të përfytyrohet se rregullat e kërkesat për ekonomitë tona ende të dobëta të tregut dhe sistemet e reja politike e shoqëritë e hapura në rajon do t'u ngjasojnë menjëherë dhe *automatiki* atyre të vendeve të BE-së dhe NATO-s. Siç shihet, ky është një *parakusht i fortë*, i cili mund të sjellë një *vonesë* tjetër të madhe në përparimin me hapin e kohës të shoqërive tona, ndaj integritimit në NATO, dhe sidomos sot, pas bërjes së qartë të kalendarit të ri të zgjerimit, për bashkimin e Ballkanit Perëndimor me familjen e madhe evropiane. Në fund të fundit, procesi i integritimit dhe anëtarësimit është më tepër se thjesht një *statistikë*, më shumë se një *ushtrim* financiar dhe ekonomik, më tepër se thjesht një numër *rregullash* dhe *termash*. Kjo është e *ardhmja* e integruar e Ballkanit Perëndimor, e paqes dhe stabilitetit të tij dhe e të gjithë Evropës. Dhe për këtë kërkohet një vullnet i qartë politik, një preokupim më serioz dhe nivel më të lartë, një ndërthurje më harmonike nëpërmjet iniciativave të ndryshme midis BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor në fushën e demokracisë, të lirisë e të drejtave të njeriut, të zbatimit të ligjit dhe të luftës kundër trafikëve, krimit e korrupsionit, por njëkohësisht dhe një angazhim serioz, i hapur e konkret i këtyre vendeve dhe qytetarëve të tyre.

Bengt Sundelius

Profesor i Qeverisjes në Universitetin e Uppsalas

Mbi sigurinë e trupëzuar shoqërisht

Të 25 shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, përfshirë Suedinë, janë duke ndërmarrë një rikonsiderim serioz të çështjeve dhe strategjive të sigurisë. Në rrjetet e fokusuara në Bruksel, tashmë po prezantohen dhe diskutohen ide të reja, në një përpjekje të përbashkët për të gjetur mënyra më të mira për përbalimin e sfidave të ardhshme ndaj sigurisë. Shqetësimet tradicionale po kombinohen me nocionet e modifikuara si pasojë e jetesës në një Shoqëri të Risqeve. Neni i Solidaritetit është përfshirë në Kushtetutën e Bashkimit Evropian, sipas miratimit të Këshillit të Evropës në qershor 2004. Sipas këtij akti politik, shtetet anëtare zotohen t'u japin të gjithë ndihmesën e nevojshme vendeve të tjera në raste të sulmeve terroriste, katastrofave natyrore, ose të shkatkuara nga dora e njeriut. Në këtë qasje gjithëpërfshirëse shkrihen procedurat e skenarëve të emergjencës së luftës dhe të paqes, ndërthuret e jashtëmja me të brendshmen dhe zbehet dallimi midis dy objektivave, atij të thellimit të sigurisë së shteteve dhe objektivit të ruajtjes së integritetit të individëve.

Në Evropë po ndodh një zhvendosje paradigmатike, nga sistemi kombëtar i mbrojtjes së Luftës së Ftohtë drejt nocionit evolues të *sigurisë së mishëruar në shoqëri*. Shtetet anëtare të Bashkimit Evropian janë duke zhvilluar praktika të reja për t'u bërë ballë sfidave të sigurisë që vijnë nga jashtë, nga brenda dhe jo më pak *nga brenda sferës së ndërbrendshme*. Kjo e fundit bëhet një fushë parësore për sigurinë e mishëruar në shoqëri në dhe prej Bashkimit Evropian. Disa tipa kërcënimesh, të gjeneruara prej aktorëve apo strukturave, mund të shfaqen në Evropë në të ardhmen e afërt. Këto zhvillime do të prekin jo vetëm sfidat ndaj sigurisë, por edhe aftësitë tona për t'i përballuar me mënyra efektive dhe legjitime.

Ky artikull paraqet një pamje të sfidave dhe kërcënimeve që mund të shfaqen në Evropë gjatë dhjetë viteve të ardhshme. Kështu, sigurohet një pikënisje e rëndësishme për diskutimet

për instrumentet e ndryshëm që mund dhe duhen të përdoren në përgjigje të këtyre situatave kërcënuese. Do të trajtohet konceptualizimi i sigurisë në shoqëri, përkundër asaj territoriale. Do të skicohen disa tendenca të shoqërisë pasmoderne dhe të ndërlidhjes transkombëtare. Bashkimi Evropian është në mes të zhvillimit të praktikave të reja për të përballuar sfidat e sigurisë transkufitare. Në këtë artikull prezantohet një pikënisje konceptuale për këto praktika të tilla evoluese, përtej shqetësimeve tradicionale me sigurinë shtetërore, që kanë evoluar përmes shqetësimeve tradicionale të sigurisë së shteteve dhe mbrojtjes njerëzore.

Sfidat e sigurisë në të ardhmen

Së pari, duhen marrë në konsideratë kërcënimet e gjeneruara prej aktorëve. Në mendimin klasik në lidhje me çështjet e sigurisë, kërcënimet gjenerohen prej aktorëve dhe kërcënimi klasik është një sulm i armatosur nga një shtet tjetër. Ky skenar përbën thelbin e përballjes ushtarake Lindje-Perëndim. Është ende pjesë e misionit të NATO-s dhe të shteteve kombëtare planifikimi dhe përgatitja për një sulm ushtarak në trajtën e tij klasike. Ky kërcënim në ditët tona është më urgjent në pjesë të tjera të botës sesa në Evropë. Megjithatë, vitet 1990 përbënin një dhjetëvjeçar tragjik të konflikteve të armatosura mes vendeve evropiane.

Nëse lihet mënjanë nocioni i shtetit, mund të fokusohemi në një tjetër kërcënim të gjeneruar prej aktorëve: një sulmi të armatosur prej “tjetrit”. 11 shtatori ishte një shembull i një sulmi të armatosur nga një “tjetër”. 11 marsi ishte një tjetër shembull i paharrueshëm i po kësaj kategorie. Diçka tjetër veç shtetit është një aktor i sulmeve të armatosura dhe një rrjet terrorist mund konsiderohet si “tjetri” potencial. Cili do të ishte instrumenti më i përshtatshëm për të përballuar këto lloj sfidash? A janë instrumentet e zhvilluara për t’u mbrojtur nga pushtimi ushtarak, d.m.th. një sulm nga një shtet tjetër, më të përshtatshmet për të përballuar një sulm të armatosur prej “tjetrit?” Kërcënime të tilla të dhunshme duhet të kuadrohen si çështje të mbrojtjes kombëtare legjitime, si sferë e hetimeve kriminale dhe e autoritetit të policisë, apo si hibrid evolues njëherazi i brendshëm dhe i jashtëm i sigurisë në shoqëri? Zgjedhja e kuadrit ka pasoja për legalitetet e duhura dhe

instrumentet e zgjedhur për t'iu përgjigjur këtij lloji të sulmit të armatosur.

Evropa ka një trashëgimi të sulmeve të dhunshme terroriste që shkon mbrapa në kohë deri te perandoritë shumetnike të Rosisë, Austro-Hungarisë dhe Gjermanisë. Në vitet 1960 dhe sidomos në vitet 1970, kontinenti, përfshirë Suedinë, përjetoj një numër sulmesh terroriste.¹ Në Angli, Spanjë dhe Francë bombardimet terroriste ndodhin me intervale të rregullta.² Në shumë drejtime, sulmet e armatosura të të “tjerëve”, shfaqin sfida tradicionale ndaj sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo formë e dhunshme e protestës kundër rendit ekzistues politik do të jetë me ne për një kohë të gjatë.

Një kërcënim i tretë i gjeneruar prej aktorëve është një sulm nga një shtet tjetër. Jo të gjitha sulmet e shteteve të tjera domosdoshmërisht përfshijnë përdorimin e mjeteve vdekjeprurëse. Instrumente klasike të dhunës për të kërcënuar të tjerët janë luftërat ekonomike, psikologjike, etj. Gjithashtu, mund të përdoren rrjetet e tregtisë, financës, energjisë, etj., për të manipuluar vendet e tjera. Ka shumë shembuj në 100 vitet e fundit të sulmeve nga një shtet në tjetër me mjete jovdekjeprurëse. Si duhen përballuar ato?

Gjatë viteve 1980, SHBA ndërmori një fushatë sulmesh ekonomike ndaj Traktatit të Varshavës përmes sistemit COCOM.³ Kjo strategji shumëpalëshe përfshinte kontrollin e eksportit të teknologjisë së lartë për të dëmtuar zhvillimin industrial dhe teknologjik të Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij. Kjo ishte një formë e sulmit nga një shtet tjetër kundër shteteve të caktuara. Ky tip shtrëngimi përdoret shpesh dhe mund të shihet si një tregues i fuqisë sipërore, sepse dhuna e zhveshur nuk është e domosdoshme për të arritur objektivat e politikave të caktuara. Ky tip kërcënimi jo ushtarak ndaj pavarësisë kombëtare, madje mbijetesës kombëtare, ka shumë gjasa të na shoqërojë në të ardhmen.

Tipi i katërt dhe i fundit i kërcënimeve me fokus aktorët, është sulmi jo i dhunshëm nga “tjetri.” Mund të jetë një aksident ose ngjarje e veçuar, si p.sh. një operacion për marrje

¹ Dan Hansén and Ahn-Za Hagström, *I krisen prövas ordningsmakten* (Stockholm: Jure, 2004).

² Alex P. Schmid and Ronald D. Crelinsten, eds., *Western Responses to Terrorism* (London: Frank Cass, 1993).

³ Cass, [1993]. Ulrika Mörth and Bengt Sundelius, *Interdependens, konflikt och säkerhetspolitik: Sverige och den amerikanska teknikexportkontrollen* (Stockholm: Nerenius & Santérus, 1998).

informacioni. Si mund ta kuptojmë se cili apo çfarë e kontrollon një operacion antagonist informacioni? A drejtohet ai prej një shteti tjetër, nga një rrjet terrorist, nga një organizatë kriminale, apo një pirat individual kompjuterash?⁴ A është ai një adoleshent në Gjermani që dëshiron vetëm të shkaktojë rrëmujë në sistemin ndërkombëtar të informacionit, si në rastin Sasser? Nga e dimë me siguri se kur duhet të veprojmë ndaj një sulmi të tillë, ndërsa gjendemi nën trysinë kohore?

Deri tani diskutimi është kufizuar te kërcënimet e gjeneruar prej aktorëve, që janë konsideruar edhe si forma tradicionale që një komb konsideron kërcënime ose shqetësime ndaj sigurisë së tij. Gjatë planifikimeve të sigurisë, tradicionalisht mendohet mbi “tjetrin” antagonist: një person, një qeveri, armiku, qoftë ky një rrjet terrorist, një qeveri, apo një udhëheqës djallëzor. Horizontet mund të zgjerohen më tej duke përfshirë edhe të ashtuquajturat *kërcënime strukturore*. Kërcënimet e gjeneruara nga strukturat nuk kanë në qendër aktorin në një kuptim antagonist, por rrethana që rrjedhin prej njëra-tjetrës, pa ndonjë paramendim për të dëmtuar.

Kjo sfidë mund të ilustruhet me anë të dy tipave të kërcënimit. I pari është rënia e sistemeve fqinjë, ku nuk ka një faj në mënyrë të drejtpërdrejtë. Pra, nuk ka keqberës, apo një “tjetër” djallëzor.⁵ Një uzinë bërthamore shkatërrohet nga keqfunksionimi. Diçka serioze prishet në Çernobil ose në Ignalina. Qoftë mungesa energjitike apo errësim i plotë, gjëra të tilla thjesht ndodhin vetvetiu, por kanë pasoja serioze për sigurinë. Epidemi vdekjeprurëse të llojeve të ndryshme shpërthejnë dhe përhapen me shpejtësi. Pasojat janë të shtrira dhe po aq vrastare sa edhe sulmet e dhunshme nga ndonjë “tjetër”.

Brenda BE-së ka interesim për mbijetesën e vendeve fqinje. Duhet të sigurohemi me mënyra të ndryshme që ato të mos rrënohen me pasoja të rënda për veten dhe të tjerët. Rënia e shteteve në fqinjësinë e afërt të BE-së ka gjasa që të rëndojë sistemet tona të sigurisë kombëtare.⁶ Ky ka qenë një shqetësim

⁴ Michael Erbschloe and John R. Vacca, *Information Warfare: Combat Hackers and Cyber Attackers* (Berkeley, California: Osborne McGraw-Hill, 2001); Chris C. Demchak, “New Security in Cyberspace: Emerging Intersection between Military and Civilian Contingencies,” *Journal of Contingencies and Crisis Management* 7, no. 4 (December 1999): 181-198.

⁵ Barry Turner and Nick Pidgeon, *Man-made Disasters*, 2nd Edition (Oxford: Butterworth-Heinemann, 1997).

⁶ Bengt Sundelius and Jesper Grönvall, “Strategic Dilemmas of Bio-security in the European Union,” *Biosecurity and Bioterrorism: Biodefense Strategy, Practice and*

klasik i sigurisë dhe ai është rritur ndjeshëm gjatë dhjetëvjeçarit që ndoqi shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik dhe Federatës Jugosllave. Kjo lloj sfide e sigurisë do të mbetet në axhendën për zbatimin e strategjisë së sigurisë së BE-së.

Në tipin e *dytë* të kërcënimeve strukturore futen ngjarje pasuese që evoluojnë brenda shoqërive tona dhe që përbëjnë një shqetësim serioz. Aksidente, katastrofa, rrënime të infrastrukturës, trazira, apo epidemi dalin jashtë kontrollit dhe kanë pasoja për sigurinë kombëtare. Ato mund të shpien edhe në çrregullime politike. Autoritetet publike mund të shtojnë përpjekjet për menaxhimin e krizave, aksidenteve, trazirat apo situatën urgjente. Mirëpo këto masa drakoniane mund të minojnë legjitimitetin, vlerat demokratike ose sistemin ligjor të shoqërisë. Shumë shtete kërkojnë një balancë mes efektivitetit të zgjidhjes së problemeve të veçanta, nga njëra anë, dhe mosminimit në kohë të vlerave, interesave dhe aspiratave drejt demokracisë, ekonomisë së tregut dhe të drejtave të njeriut, në anën tjetër.⁷ Shtimi i sigurisë në një kuptim më të gjerë mund të kompromentohet në interes të zgjidhjes së situatës urgjente. Shqetësime të rënda në shoqëritë evropiane mund të jenë një formë kërcënimi strukturor që duhet të përballohet nga autoritetet publike.

Me kohë po vihet re një largim i fokusit politik prej *sigurisë së territorit*. Ky është shqetësimi klasik - sulmi prej një shteti tjetër. Në të ardhmen, shqetësimet politike do të jenë mbi *sigurinë e funksioneve kritike të shoqërisë*. Nuk është më territori që problematizohet, por aftësia funksionale e qeverisë dhe e shoqërisë civile, funksionimi i infrastrukturave kritike, aftësia demokratike për të qeverisur dhe për të manifestuar disa vlera bazë e kështu me radhë.⁸ Kjo zhvendosje paradigmатike prej sigurisë territoriale drejt sigurisë në shoqëri ndikon mendimin brenda BE-së.

Science 2, no. 1 (2004); Jesper Grönvall, *Managing Crisis in the European Union: The Commission and Mad Cow Disease*, Volume 10, Crismart, The Swedish Agency for Civil Emergency Planning (Karlstad: Tryckeri AB Knappen, 2000).

⁷ Paul 't Hart "Symbols, Rituals and Power: The Lost Dimensions of Crisis Management," *Journal of Contingencies and Crisis Management* 1, no. 1 (1993): 36-50.

⁸ Barry Buzan, *People, States and Fear: The National Security Problem in International Relations* (Brighton: Wheatsheaf, 1983).

Tendencat që ndikojnë sigurinë e mishëruar në shoqëri

Çfarë tendencash vëzhgohen në literaturën akademike mbi zhvillimet shoqërore që janë domethënëse për aftësinë e ardhshme për të thelluar sigurinë në shoqëri, në kuadër të shteteve kombëtare dhe BE-së? Një numër zhvillimesh të qëndrueshme janë domethënëse brenda shoqërive, në marrëdhëniet midis shoqërisë dhe shtetit dhe, jo më pak, midis shoqërive dhe qeverive. Aspektet që do të theksojmë më poshtë kanë ndikim në mënyrat sesi qeveritë mund reagojnë dhe të marrin veten prej atyre kërcënimeve serioze të analizuara më sipër.

Hapësira gjeopolitike është zëvendësuar nga një logjikë e sfidave dhe kundërpërgjigjeve të sigurisë në shoqëri. Kjo logjikë vepron me ritëm të lartë të kushtëzuar nga koha. Ngjarjet e errëta në dukje, në sektorin shëndetësor në rajonet rurale të Kinës në dimrin e vitit 2002, u shndërruan me shpejtësi në një shqetësim global mbi përhapjen e epidemisë SARS. Në disa vende të Azisë Lindore u morën masa drakoniane që preknin të drejtat e njeriut dhe praktikat sipërmarrëse. Edhe Torontoja e largët u përball me krizën e vet të shëndetit publik, pikërisht në lidhje me mënyrën sesi duhet ta përballonte rrethanën urgjente që krijoi kjo sëmundje e re. Largësitë nuk përcaktohen vetëm nga gjeografia. Afërsia mund të matet me faktorin kohë, sepse kontinentet dhe qytetet kryesore botërore janë të ndërlidhur me anë të transportit ajror apo raketat ndërkontinentale.⁹

Në Evropë një nga paralajmërimet e para të kësaj tendence ishte katastrofa e Çernobilit në vitin 1986. Një re rrezatimi u përçoll nga erërat e forta mes për mes Evropës Qendrore dhe Veriore prej vendit ku ndodhi aksidenti në Ukrainë. Ky aksident shkaktoi dëm të konsiderueshëm të shëndeti njerëzor dhe ai i kafshëve, në bujqësi dhe sipërmarrje. Efektet në tokë kanë zgjatur më shumë se një dhjetëvjeçar. Ky shembull i hershëm i kërcënimeve transkufitare, të cilat lëvizin me shpejtësi të madhe, ndaj sigurisë në shoqëri e kishte zanafillën në një aksident teknik. Mundësia e kërcënimeve antagoniste ndaj

⁹ The SARS Commission Interim Report – *SARS and Public Health in Ontario* (Ministry of Health and Long-Term Care, 15 April 2004), <<http://www.fas.org/irp/threat/cbw/sarsontario.pdf>> (14 July 2005).

infrastrukturave të cenueshme, e dallon edhe më shumë efektin e menjëhershëm në kohë reale të këtyre kërcënimeve.¹⁰

Qeveritë e vendeve të ndryshme kanë nevojë të orientohen për nga çështjet e sigurisë që janë të lidhura me funksionet kritike të shoqërisë dhe kërkesave të qeverisjes. Është e rëndësishme që kur planifikohen mbrojtja kombëtare dhe siguria ndërkombëtare, të mos lejohen pika të cenueshme brenda infrastrukturës ose strukturës së shoqërisë. Pikat e cenueshme mund të hapin porta hyrëse funksionale, kanale depërtimi për sulme nga “tjetri”, kushdo qoftë ai. Gjeopolitika dhe hapësira dikur ishin shumë të rëndësishme në planifikimin strategjik. Në kushtet e sotme të informacionit teknologjik më të përparuar nuk është hapësira, por shpejtësia elementi përkufizues strategjik. Përmasa e kohës është gjithashtu në thelb të planifikimit të sigurisë kombëtare.

Kompleksitetet teknologjike të shoqërisë së sotme moderne janë të hapura ndaj risqeve shumë të mëdha, ndërlidhjeve të ngushta nëpërmjet sektorëve dhe ndërmjet kufijve kombëtarë. Ndërlidhja e infrastrukturës është bërë pjesë e jetës sonë të përditshme, në kohën kur shoqëria varet nga sisteme të besueshme për ushqimin me energji, për komunikime të qëndrueshme dhe për funksionimin e rrjeteve të teknologjisë së informacionit (IT). Këto sfera aktivitetesh janë të varura në mënyrë të ndërsjelltë nga njëra-tjetra. Një rënie në njërin prej sistemeve mund të japë efekte të menjëhershme te tjetri. Për shembull, pa energji elektrike nuk do të funksiononin rrjetet IT edhe në të njëjtën kohë lidhjet telefonike do të kishin probleme. Në mënyrë të ngjashme, nga një defekt në rrjetin IT, energjia elektrike mund të ndërpritet. Në një ndërlidhje të tilla mundësi kombinimi të krisjeve të sistemit janë të panumërta.¹¹

Natyrisht, kundërshtarët që duan t'i shkaktojnë dëm një shoqërie të caktuar, janë të interesuar për të gjetur pikat kritike,

¹⁰ Eric K. Stern, *Crisis Decision Making: A Cognitive Institutional Approach* (Stockholm: Försvarshögskolan, 2001); A. Libertore “Chernobyl Comes to Italy: The Reciprocal Relationships of Radiation Experts, Government Policies, and the Media,” in *The Politics of Expert Advice: Creating, Using and Manipulating Scientific Knowledge for Public Policy*, ed. Anthony Barker and B. Guy Peters (Edinburgh: The University of Edinburgh Press, 1993), 33-48.

¹¹ Charles Perrow, *Normal Accidents: Living with High-Risks* (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1999); Edward Deverell, *The 2001 Kista Blackout: Corporate Crisis and Urban Contingency* (Stockholm: Swedish National Defence College, 2003); Lindy Newlove, Eric K. Stern, and Lina Svedin, *Auckland Unplugged: Coping with Critical Infrastructure Failure* (Baltimore: Lexington Books, 2003).

aty ku ndërlidhen infrastrukturat e ndryshme. Një detyrë madhore gjatë planifikimit të sigurisë shoqërore është shndërrimi i pikave potencialisht të cenueshme, të lidhura me këtë kompleksitet teknologjik, në një sistem të besueshmërisë së lartë.¹² Ky është një proces pa mbarim dhe përfshin shumë sektorë shoqërorë dhe agjenci qeverisëse të shumta. Ky proces nuk mund të përmbushet pa pjesëmarrjen aktive të të gjithë atyre që aktualisht zotërojnë dhe kontrollojnë pjesën më të madhe të këtyre rrjeteve infrastrukturore, d.m.th. sektori i sipërmarrjes private.

Publiku pret qeverisje të mirë, por me qeveri të vogël. Në dhjetëvjeçarin e fundit kjo tendencë ka qenë e qartë në shumicën e shoqërive. Funksionet e shërbimit publik janë vendosur me anë të kontraktimit në duart e privatëve. Burokracitë kombëtare janë lënë mënjanë, si mjete të vjetëruara. Përparësi i jepet më shumë mandateve për monitorimin e sektorëve, sesa përgjegjësive për dorëzimin e shërbimeve. Një rezultat i këtyre reformave është se autoritetet publike në kohën e urgjencave kanë më pak burime dhe fuqi njerëzore për të bërë të mundur sigurinë në shoqëri.¹³

Në të njëjtën mënyrë si motivohej fuqishëm industria gjatë Luftës së Ftohtë për të mbështetur sektorin e mbrojtjes, tani duhen stimuluar sipërmarrjet private që të japin ndihmesë në forcimin e komplekseve të infrastrukturave me risk të lartë, që janë kritike për funksionimin e shoqërisë. Duhet të bëhen përpjekje si drejt masave parandaluese, ashtu edhe parapërgatitjes për përballje dhe për ta rimarrë veten në rast se ndodhin rreziqe të ndryshme, qofshin të qëllimta apo aksidentale.¹⁴

Që kur shumë prej shërbimeve publike që siguronin mbështetje për sigurinë e përbashkët u bënë pjesë e sektorit

¹² Scott D. Sagan, *The Limits of Safety: Organizations, Accidents and Nuclear Weapons* (Princeton: Princeton University Press, 1993); Philippe Boullé, Luc Vrolijk, and Elina Palm, "Vulnerability Reduction for Sustainable Urban Development," *Journal of Contingencies & Crisis Management* 5, no. 3 (1997): 179-188.

¹³ Peter Aucoin, *The New Public Management: Canada in Comparative Perspective*. (Montreal, Quebec, Canada: Institute for Research on Public Policy, 1995); Lynn Ashburner, Ewan Ferlie, Louise Fitzgerald, and Andrew Pettigrew, *The New Public Management in Action* (Oxford: Oxford University Press, 1996); Jan-Erik Lane, *The New Public Management* (London: Routledge, 2000); Donald F. Kettl, "The Transformation of Governance: Globalization, Devolution, and the Role of Government," *Public Administration Review* 60, no. 6 (2000):488-97.

¹⁴ Robert Agranoff and Michael McGuire, "Managing in Network Settings," *Policy Studies Review* 16, no. 1 (1999): 18-41; Myrna P. Mandell, "Collaboration through Network Structures for Community Building Efforts," *National Civic Review* 90, no. 3 (2001): 279-87.

privat, për shkak të qeverisjes më të mirë, ngrihen pyetje në lidhje me varësitë publike-private. A mundet që ky lloj ndërveprimi të shihet si një marrëdhënie me përfitim të ndërsjelltë? Apo ekzistojnë pika të cenueshme asimetrike që mund të formojnë bazën për ndikim dhe manipulim prej njërës anë? Partneritetet private-publike kanë nevojë të zhvillohen në shumë sektorë.¹⁵ Siguria shoqërore përfshin aftësinë për t'u rimëkëmbur nga një kërcënim dramatik, apo defekt në sistem. Çështjet e llogaridhënies duhen qartësuar përpara ndonjë krize që do të vërë në lëvizje lojën e dhimbshme të gjetjes së fajtorit.¹⁶ Në fazën pastraumatike, sektori privat mund të jetë një aleat shumë i rëndësishëm, apo një armik, për ata që kanë autoritetin dhe përgjegjësinë për të ruajtur sigurinë e kombit dhe të qytetarëve të tij.

Rëniet e infrastrukturës, siç mund të jetë ndërprerja e energjisë elektrike, mund të shkaktojë dëmtime të konsiderueshme. Përveç kësaj, ato gjenerojnë pasoja të tërthorta shpesh më të mëdha, më të dëmshme dhe më afatgjata se ato të kërcënimeve të llojit të parë, për shoqërinë. Në një errësim total, si ai i Nju-Jorkut në gusht 2003, shumë shërbime u ndërprejnë.¹⁷ Për këtë arsye spitalet dhe strukturat e tjera të ndihmës së shpejtë aktivizuan sistemet e tyre të urgjencës. Prapëseprapë shumë nga funksionet bazë të shoqërisë nuk janë të pajisura, nuk janë të siguruara në këtë mënyrë, për shkak të mungesës së fondeve. Nëse sëmundjet ngjithëse mund të shpërhapen në popullatë ndodh që kërkesa për vaksinim, për izolim të infektimit ose edhe për shërbim nëpër spitale në situata të tilla rritet shumë shpejt.¹⁸ Efektet kaskadë evoluojnë në mënyra të pakontrollueshme kur risqet të fjetuara papritur bëhen realitet.

¹⁵ Akintola Akintoye, Matthias Beck, and Cliff Hardcastle, eds., *Public-private Partnerships: Managing Risks and Opportunities* (Oxford: Blackwell Science, 2003).

¹⁶ Thomas Preston and Paul 't Hart, "Understanding and Evaluating Bureaucratic Politics: The Nexus Between Political Leaders and Advisory Systems," *Political Psychology* 20, no. 1 (1999): 49-98; Uriel Rosenthal, Paul 't Hart, and Alexander Kouzmin, "The Bureau-politics of Crisis Management," *Public Administration* 69, no. 2 (1991): 211-233.

¹⁷ Interim Report: *Causes of the August 14th Blackout in the United States and Canada* (US Canada Power Systems Outage Task Force, November 2003) <<https://reports.energy.gov/814BlackoutReport.pdf>> (15 July 2005).

¹⁸ Thomas A. Glass and Monica Schoch-Spana, "Bioterrorism and the People: How to Vaccinate a City Against Panic," in *Clinical Infectious Diseases* 34, no. 2 (2002): 217-23.

Gjatë një vale të nxehtë ajri me temperatura shumë të larta në Paris gjatë verës së vitit 2003, me qindra njerëz të rinj dhe të moshuar vdiqën, për shkak të një planifikimi të papërshtatshëm për një ngjarje të tillë.¹⁹ Kjo u pasua nga një kritikë e gjerë nga publiku për sistemin shëndetësor dhe në mënyrë të tërthortë për zyrtarët publikë përgjegjës për të siguruar shërbimet e duhura. Llogaridhënia politike po shfaqej në lidhje me pasojat njerëzore që erdhën nga mungesa e parapërgatitjeve për një rrethanë të skajshme meteorologjike. Qeveria spanjolle në votimet kombëtare u quajt përgjegjëse për etiketimin e gabuar të terroristëve, fajtorë për vënien e bombave në një tren në mars 2004. Pasojat e fitores zgjedhore nga opozita social-demokrate kanë qenë të konsiderueshme për Spanjën, për luftën në Irak, dhe për evoluimin e Bashkimit Evropian. Pasojat e krizave rrjedhin përtej ngjarjeve në rrugë të paparashikueshme.

Në mendjen e publikut nuk lë gjurmë vetëm mënyra sesi vepron, por edhe shfaqja e asaj që bën ose nuk bën.²⁰ Rëndësia e mediave masive së fundi është forcuar së tepërmi në proceset e trajtimit të çështjeve publike, formimit të pritshmërive, caktimit të përgjegjësive dhe në ndikimin e imazheve të suksesit apo dështimit të udhëheqësit përballë kërcënimeve ndaj sigurisë. Xhorxh W. Bushi u zgjodh president me një diferencë shumë të vogël votash në Gjykatën e Lartë të Shteteve të Bashkuara. Ai u bë realisht presidenti i popullit amerikan nën peshën e udhëheqjes së tij publike gjatë ngjarjeve dramatike të 11 shtatorit. Kryeministri spanjoll humbi në zgjedhjet parlamentare menjëherë pas bombardimit terrorist të Madridit. Kjo disfatë politike pjesërisht u shkaktua nga imazhet që media përcolli në publikun spanjoll mbi manipulimin dhe adresimin e fajit për aktin terrorist te personat e gabuar.

Prania e medias rrit trysnitë në vendimmarrjet me përgjegjësi të lartë, atëherë kur përballen kërcënimet ndaj sigurisë në shoqëri. Afatet për veprim jo vetëm që vendosen nga rrethana në fjalë, por edhe nga nevoja e medias për lajme të bujshme në intervale të caktuara. Një mungesë për një periudhë të

¹⁹ Abstract of the progress report – August 28th on the heatwave 2003 in France from the National Institute of Public Health Surveillance (InVS), Saint Maurice, France www.invs.sante.fr/publications/2003/chaieur_aout_2003/abstract_heatwave_280803.pdf>(15 July 2005).

²⁰ Murray J. Edelman, *Constructing the Political Spectacle* (Chicago: Chicago University Press, 1988).

caktuar kohe e informacionit që përbën lajm, mund të çojë në vështirësi për të manovruar investigimet e mediave brenda një organizate. Marrja në konsideratë se si të komunikohen veprimet ose mosveprimet përmes medias bëhet po aq e rëndësishme sa edhe suksesi i përlogaritjeve për atë se çfarë duhet bërë dhe çfarë nuk duhet bërë në rrethana të caktuara.²¹

Mbulimi i medias transkombëtare rritet përmes përparimeve në teknologjinë e komunikimit. Ngjarjet lokale mund të shndërrohen shumë lehtë në shqetësime globale, për shembull sa herë që CNN merr një vendim redaksional për t'u përqendruar në një rrethanë të dhënë. Rritje të tilla të shkallës së vëmendjes mund të ndodhin brenda një kohe shumë të shkurtër, duke shtuar trysinë mbi autoritetet lokale në rrethana tashmë të vështira. Shumë pak zyrtarë, qoftë të nivelit kombëtar apo atij lokal janë të përgatitur për t'u përballur me kërkesat e korporatave ndërkombëtare mediatike.²²

Pritshmëritë e publikut për performancën e qeverisë normalisht që mbeten të larta përballë gjithë spektrit të kërcënimeve të mundshme, që mund të vënë në rrezik sigurinë e një shteti në përgjithësi ose edhe atë të individit në veçanti. Në të njëjtën kohë, burimet e mundshme për t'u përdorur në përballjen me kërcënime të tilla dhe që janë nën komandën e drejtpërdrejtë të autoriteteve kombëtare publike janë ripërcaktuar shpesh, në të shumtat e rasteve duke u zvogëluar shumë si në qëllime dhe në përmasa. Kjo deficiencë akoma nuk është kompesuar prej kapaciteteve të shtuara shumëkombëshe. Me gjithë vetëdijen e përgjithshme mbi rëndësinë e grumbullimit në një vend të burimeve ndërkombëtare në rastet e përballjeve me kërcënime transkombëtare, pak vlera të shtuara në terma të burimeve të prekshme janë gjeneruar deri tani. Deklarata të solidaritetit janë kombinuar me rregullime *ad hoc* për ndihmë të ndërsjelltë kur kanë ndodhur çarje të mëdha të shoqërive. Strukturat qeverisëse për të menaxhuar kërcënimet ndaj sigurisë së

²¹ Patrick Lagadec, *Preventing Chaos in a Crisis. Strategies for Prevention, Control and Damage Limitation* (London: McGraw-Hill Book Company, 1991); Ardyth B. Sohn, Jan LeBlanc Wicks, Stephen Lacy, and George Sylvie, *Media Management: A Casebook Approach*, Second Edition (Mahwah, N.J.: Lawrence Erlbaum Associates, Inc., 1999).

²² Rhona H. Flin and Kevin Arbuthnot, eds., *Incident Command: Tales from the Hot Seat* (Aldershot: Ashgate Publishing Company, 2002); Robert Heath, *Crisis Management for Managers and Executives* (London/San Francisco: Financial Times Pitman Publishing, 1998).

mishëruar në shoqëri, janë akoma me fokus kombëtar. Mobilizimi potencial i burimeve të mëdha që është i mundur p.sh. me zbatimin e Nenit të Solidaritetit, deri tani ka mbetur i pashfrytëzuar.

Hartat mendore të elitave evropiane të sigurisë, u formuan nga Lufta e Ftohtë dhe iu desh të pësonin një ridrejtim të vështirë dhe të dhimbshëm në dhjetë vitet e fundit. Skrapi mendor (jo skrapi metalor – që është një problem më vete) i Luftës së Ftohtë ende po ndikon mendimin mbi sigurinë në ministritë evropiane dhe të Amerikës së Veriut. Përveç mësimave të reja mbi tipat e sfidave ndaj sigurisë që analizuar më sipër, nevojitet edhe çrrënjësja e mendësive të vjetra.²³

Është e rëndësishme që vendet e BE-së të mos jetë ndëroperative vetëm në teknologji dhe komunikim, atëherë kur ndihmojnë njëri-tjetrin gjatë urgjencave. Ne duhet të jemi ndëroperative edhe kur është fjala për shkëmbime njohurish apo mirëkuptimi mes njëri-tjetrit. Ne kemi nevojë për etapa të përbashkëta të performancës së mirë, performancës jo dhe aq të mirë dhe të praktikave më të mira. Një burim jetësor në këtë përpjekje grumbulluese është ekspertiza dhe kapaciteti organizativ. Ne duhet të mendojmë për ndëroperacionalitetin në terma të njohurisë së përbashkët si edhe të një baze të përbashkët trainimi për përpjekje të koncertuara.

Kërkime të konsiderueshme po ndërmerren mbi çështjet e reja të sigurisë në shumë vende²⁴ dhe kemi një pasuri vëzhgimesh, përgjithësimesh dhe mësimesh. Është e rëndësishme që kuptimet e formuara përmes kësaj përpjekjeje po transferohen prej kullave të fildishta dhe organizatave të mendimit (*think-tanks*), për të lehtësuar nxënien organizative. Një dallim mund të bëhet midis nxënies organizative dhe nxënies individuale. Ne mund të mësojmë në mënyrë

²³ Yaacov Y.I. Vertzberger, *The World in Their Minds: Information Processing, Cognition, and Perception in Foreign Policy Decision Making* (Stanford, California: Stanford University Press, 1990); James G. March, *A Primer on Decision Making. How Decisions Happen* (New York: The Free Press, 1994); Richard E. Neustadt and Ernest R. May, *Thinking in Time. The Uses of History for Decision-Makers* (New York: The Free Press, 1986).

²⁴ Barry Buzan, Ole Waever, and Jaap de Wilde, *Security: A New Framework for Analysis* (Boulder, Colorado : Lynne Rienner Publishers, 1998); Uriel Rosenthal, Arjen Boin, and Louise K. Comfort, eds., *Managing Crises: Threats, Dilemmas, Opportunities* (Springfield, Illinois, USA: Charles C. Thomas Publishers, 2001); Robert Mandel, *Deadly Transfers and the Global Playground: Transnational Security Threats in a Disorderly World* (London: Praeger Publishers, 1999); Simon Duke, *The EU and Crisis Management : Development and Prospects* (Maastricht : European Institute of Public Administration, 2002).

individuale, por a mund të mësojnë organizatat publike? Ose, a ndryshojnë agjencitë qeveritare dhe a përshtaten me rrethanat? A mund të nxëjnë ato me një mënyrë grumbullimi, d.m.th. të shtojnë bazën e njohurive të tyre dhe të zgjerojnë repertorin? Nxënia është një çështje e ndërlikuar kur shkon përtej nxënies individuale te nxënia kolektive dhe organizative. Ky është një subjekt i gjerë për diskutime akademike dhe propozime për konstruksionet institucionale.²⁵

Është e rëndësishme që në të gjitha vendet e BE-së të formohet njohuria mbi sigurinë në shoqëri, si një piketë për zbatimin e Nenit të Solidaritetit. Kërkesa të reja u janë paraqitur organizatave të mendjes (*think-tank*) për t'i zhvilluar këto njohuri në partneritet me agjencitë e politikave dhe operativat. Kemi nevojë për njohuri mbi kërcënimet dhe strategjitë e sigurisë, që janë të bazuara mbi kërkimet shkencore dhe përvojën praktike. Qendra të tilla të prodhimit dhe përcjelljes së njohurive duhet të lidhen së bashku në rrjete bashkëpunimi transkombëtare. Ky aktivitet njohuri-grumbullues duhet të shtrihet edhe përtej Atlantikut si edhe në qendra të tjera globale.

Sferat e sigurisë në shoqëri

Si i organizojnë qeveritë trupat e tyre profesioniste për të përballuar sfidat e sigurisë së shek. XXI? Ndryshime themelore janë duke ndodhur në tërë Evropën si edhe në Amerikën e Veriut. Perspektivat për përhapjen e politikave, nxënien e përbashkët dhe përshtatjen institucionale janë konkrete dhe aktuale. Në BE flitet për evropianizimin e strukturave dhe procedurave kombëtare edhe në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.²⁶ Në mënyrë të ngjashme, është shumë e mundshme që të ndodhë nxënia e përbashkët apo përshtatja përtej Atlantikut.

²⁵ Sander Dekker and Dan Hansén, "Learning under Pressure: The Effects of Politicization on Organizational Learning in Public Bureaucracies", *Journal of Public Administration Research and Theory* 14, no. 2 (2004): 211-230; Eric K. Stern, "Crisis and Learning: A Conceptual Balance Sheet", *Journal of Contingencies and Crisis Management* 5, no. 2(1997):69-86.

²⁶ Magnus Ekengren, *The Time of European Governance* (Manchester: Manchester University Press, 2002); Alyson J.K. Bailes, ed., *The Nordic Countries and the European Security and Defence Policy* (Oxford: Oxford University Press, 2005).

Figura 1 paraqet qasjen tradicionale profesionale 2-binarëshe ndaj sigurisë shtetërore dhe njerëzore. Ky format është përdorur në Suedi dhe në shumë vende të tjera. Pjesë të ndryshme të mekanizmit qeverisës kanë përgjegjësinë dhe autoritetin për të rritur sigurinë e shtetit në mbrojtjen e qytetarëve. Një vijë e qartë ka ndarë këto dy sfera të autoritetit në shumë vende. Profesionet e veçanta janë zhvilluar me programe trainimi të veçanta, rregullat e angazhimit dhe praktikat operationale.

<i>Objektivi:</i>	Sfera	
	Sfera e Brendshme	Sfera e Jashtme
Siguria e shtetit	Ligji & Rendi	Mbrojtja Kombëtare
Siguria njerëzore	Shërbimet e shpëtimit	Ndihma ndërkombëtare në raste katastrofash

Figura 1: Konceptet dhe sferat e sigurisë evropiane.

Në mënyrë të ngjashme, është hequr një vijë ndarëse mes problematikës së sferës së brendshme dhe përgjegjësi të përqendruara te kuadri ndërkombëtar. Siguria shtetërore brenda vendit ka qenë përgjegjësi e sistemit të drejtësisë penale dhe shërbimit të kundërspiunazhit. Sektori i mbrojtjes ka qenë i përqendruar në mobilizimin e burimeve për t'i angazhuar ndaj rreziqeve të jashtme. Kushtetutat e shumë qeverive e përforcojnë këtë ndarje midis sferës së rritjes së sigurisë së shtetit ndaj kërcënimeve të jashtme dhe mbrojtjes së brendshme prej depërtimeve. Binarit të sigurisë brenda vendit i përkasin edhe shërbimet e shpëtimit gjatë katastrofave dhe urgjencave. Këto burime kombëtare janë përdorur gjithashtu edhe për të ndihmuar gjatë katastrofave ndërkombëtare. Operacione humanitare të tilla janë të veçanta prej fokusit ndërkombëtar në sektorin e mbrojtjes. Në të dyja binarët bashkëpunimi me partnerët ose aleatët të jashtëm është i zhvilluar mjaft mirë.

Figura 2 paraqet qasjen më të fundit nordike me tre binarë, e cila është në evoluim e sipër. Në këtë qasje siguria shoqërore bëhet thelbi i mobilizimit kombëtar të burimeve. Disa elementë që tradicionalisht janë mbajtur veçmas, tani po ndërthuren; procedurat për luftëra e ato për paqe shkrihen te njëra-tjetra, siguria e brendshme puthitet me të jashtmen dhe dallimi midis objektivit për të forcuar sigurinë kombëtare dhe objektivit për të garantuar mbrojtjen e individit, megjullohet. Kjo qasje holistike, që vë në qendër sigurinë në shoqëri, gjithashtu shfaqet në Nenin e Solidaritetit të Kushtetutës së Bashkimit Evropian të miratuar nga Këshilli i Evropian në qershor 2004.

<i>Objektivi:</i>	Sferat	
	Sfera e Brendshme	Sfera e Jashtme
Siguria e shtetit	Ligji & Rendi	Mbrojtja Kombëtare
<i>Siguria shoqërore</i>	<i>Kapaciteti kundërpërgjigjës</i>	<i>Kapaciteti ndërkombëtar kundërpërgjigjës</i>
Siguria e individit	Shërbimet e shpëtimit	Ndihma ndërkombëtare në rastet e katastrofave

Figura 2: Konceptet dhe sferat e sigurisë shoqërore evropiane në formim e sipër

Pjesë të ndryshme të mekanizmit të BE-së kanë përgjegjësi parësore në gjashtë sferat e paraqitura në figurën 2. Binari i sigurisë në shoqëri kapërcen çarjen konceptuale dhe profesionale midis shqetësimit të politikës së rangjeve të larta për sigurinë, në terma të Bashkimit si një shtet i vetëm dhe, në anën tjetër, përqendrimi te siguria njerëzore brenda dhe jashtë Bashkimit, përqendrim ky që më tepër bazohet te rrjetet. Në këtë perspektivë të lidhjes të dy krahëve detyra parësore për një bashkësi të sigurisë së 25 shteteve do të ishte ruajtja e mirëfunksionimit të shoqërive civile dhe e aftësisë për qeverisje demokratike.

Pa një perspektivë holistike të totalitetit të angazhimeve të BE-së në emër të sigurisë brenda dhe jashtë kufijve të

Bashkimit, gjashtë sferat e veçanta të politikave në figurën 2 do të fragmentizoheshin në sfera të izoluar të interesave profesionalë apo të interesave të sektorit. Gjithashtu, vendosja e përparësive të burimeve përmes këtyre sferave operative është e menaxhueshme politikisht vetëm me anë të një konceptualizimi holistik, i cili hedh një urë ndërmjet këtyre gjashtë fushave drejt një paradigme të sigurisë në shoqëri të përbashkët për BE-në dhe vendeve pjesëmarrëse në të.

Në figurën 3 një sferë shtesë e BE-së është vendosur ndërmjet sferës së brendshme dhe kuadrit ndërkombëtar. Në *sferën e ndërbrendshme*, dalin në pah lidhjet transkufitare përmes nivelit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Duke u bazuar mbi diskutimet e tendencave që ndikojnë sigurinë e mishëruar në shoqëri në pjesën e mëparshme, bëhet e qartë se sfera e ndërbrendshme është një sferë e rëndësishme e sigurisë për Bashkimin. Rëndësia e saj është e simbolizuar në Nenin e Solidaritetit të Kushtetutës së propozuar. Në këtë deklaratë të përkushtimit politik të përbashkët për sigurinë e mishëruar në shoqëri, pohim që përmban një vetëdetyrim ndaj formës së vjetëruar të sigurisë së përbashkët, janë përfshirë si shqetësimi për sigurinë kombëtare, po ashtu edhe kërkesat për ruajtjen e sigurisë njerëzore. Garancia e solidaritetit ndërfutet te binarët e veçantë profesionalë dhe i shkrin në një përmasat e brendshme me ato ndërkombëtare. Sfera e ndërbrendshme shndërrohet në terren parësor të lojës për qëndrueshmërinë e sigurisë në shoqëri të BE-së dhe brenda BE-së.

<i>Objektivi:</i>	Sferat		
	Sfera e Brendshme	Sfera e Jashtme	Sfera e Ndërbrendshme
Siguria e shtetit	Ligji & Rendi	Mbrojtja Kombëtare	Kundër terrorizmi
Siguria në shoqëri	Kapaciteti kundërveprues	Kapaciteti ndërkombëtar kundërveprues	Nenit i Solidaritetit
Siguria e individit	Shërbimet e shpëtimit	Ndihmë ndërkombëtare në katastrofa natyrore	Mbrojtja Civile

Figura 3: Konceptet dhe sferat e sigurisë së mishëruar në shoqëri të Evropës.

Siguria e mishëruar në shoqëri duhet të jetë shumësektorëshe. Duhet të ketë bashkëpunim dhe përgatitje të mirë për sigurinë në këto sfera dhe midis tyre: shëndeti, financat, ushqimi apo sektori i transporteve. Pra, duhet të jetë shumënivelëshe. Duhet përgatitur për pasojat e kërcënimeve të ndryshme për të gjitha nivelet. Përgjegjësitë variojnë nga lokale në rajonale, kombëtare, dhe përtej kufijve, në nivelin evropian. Perspektiva e përbashkët duhet të jetë shumëinstitucionale dhe tredegëshe. Komisioni i BE-së (gjithashtu edhe mes drejtorive), Këshilli, Parlamenti dhe shumë agjenci autonome të BE-së duhet të përfshihen dhe të jenë të gatshme të bashkëpunojnë. Siguria në shoqëri të konsiderohet si një shqetësim shumëkombësh. 25 shtetet anëtare plus kompleksi institucional në Bruksel duhet të zhvillojnë një vizion të përbashkët. Marrëdhënia organizative duhet të kompozohet dhe të provohet në mbështetje të një BE-je të sigurtë.

Drejt sigurisë së mishëruar në shoqëri përtej Atlantikut.

Përgatitjet për sigurinë shoqërore evropiane nuk bëhen në një izolim të plotë. Kjo përpjekje bashkëpunuese, që të jetë efektive, duhet të ketë një qasje shumëkontinentale. Paradigma e sigurisë shoqërore duhet të ndërtohet përmes Atlantikut drejt ShBA-së si edhe të partnerëve të tjerë globalë. Mund të hidhen hapa për ta shndërruar komunitetin ekzistues atlantik të sigurisë në një bashkësi transatlantike të sigurisë së mishëruar në shoqëri. Çështja mbetet si të lidhim nocionin e ri evropian të sigurisë së mishëruar në shoqëri me Programin Amerikan të Sigurisë së Atdheut (US Homeland Security Program). Siguria në shoqëri, sikurse Siguria e Atdheut në Amerikën e Veriut ka të bëjë me mbijetesën në disa përmasa. Në këtë sfidë me shumë risqe ekzistojnë të gjitha arsyet për të filluar procesin e vështirë të lëvizjes së rikonceptualizimeve të ndryshme të sigurisë drejt një partneriteti më praktik. Kur dimë më shumë për rregullimet e parapëlqyera të të tjerëve, dimë më mirë se ku mund të gjejmë pika të përbashkëta dhe ku duhen bërë zgjedhje të vështira, në mënyrë që të arrihet një e mirë e përbashkët. Shpresojmë se ky koment mbi nocionin e sigurisë

së mishëruar shoqërore mund të japë ndihmesën për një këndvështrim të përbashkët. Puna analitike tani duhet të nisë për hartimin e një plani konkret për zbatimin e ideve të reja që u shprehën me anë të zotimit të Nenit të Solidaritetit të BE-së, në lidhje me sigurinë brenda, jashtë dhe ndërmjet.

Programi amerikan i Sigurisë së Atdheut ka nevojë të krahasohet me programet e shteteve evropiane dhe gjithashtu me rregullimet e Brukselit. Të gjitha këto pjesë janë në një fazë formuese dhe pika e tyre e nisjes ka qenë spektri i kërcënimeve të sigurisë të analizuara më sipër gjatë këtij komenti. Një vizion transatlantik mund të jetë një trajtë e zgjatur e Sigurisë së Atdheut, nëpërmjet marrëveshjeve të shumta dypalëshe, sikurse janë marrëveshjet e negociuara bazat ushtarake amerikane nëpër botë. Regjimi informativ perëndimor është ndërtuar me anë të lidhjeve të tilla, me Uashingtonin në qendër të rrotës së informacionit. Ky rregullim i udhëhequr prej Shteteve të Bashkuara ka punuar mirë dhe qetë për dhjetëvjeçarë të tërë, në lidhje me qëllimet mbrojtëse.

Një vizion tjetër do të ishte edhe partneriteti shumëpalësh mes një qeverie amerikane që e vlerëson cënueshmërinë e saj “së jashtmi” lidhur me çështje të sigurisë së vendit dhe një politike koherente të BE-së mbi sigurinë e mishëruar në shoqëri. Axhenda e përbashkët politike do të ishte për të krijuar disa procese pune shumëplanëshe, për ta shndërruar aleancën ekzistuese të Atlantikut në një komunitet të sigurt evro-atlantik. Masat praktike drejt këtij qëllimi duhet të ndërmerren në nivele të ndryshme në shumë sektorë. Grupe pune duhet të ngrihen për të përgatitur perspektiva të përbashkëta midis zyrtarëve përkatës. Zotimet për politika që thellojnë partneritetet duhet të depërtojnë së poshtmi në kuadre operationale të shumë aksionerëve të sigurisë së mishëruar në shoqëri. Pengesat organizative dhe mendore duhen kapërcyer përtej kushtëzimeve të juridiksionit, sektorit apo profesionit.

Një veprim me kosto efektive që do të mundësonte hapjen e strukturave të ngurta, do të ishte planifikimi dhe ekzekutimi i disa seminareve trainuese dhe ndërvepruese. Politikëbërësit përgjegjës dhe zyrtarët e zgjedhur nga vende të ndryshme do të merreshin intensivisht me disa skenarë kërcënimesh evro-atlantike. Një vetëdije e përbashkët dhe një proces reciprok i nxënies do të zhvillohej përmes këtyre përvojave me dilema konkrete vendimmarrëse në lidhje me sigurinë. Një shembull i shkëlqyeshëm i një vegle të tillë mësimore ishte simulimi *Stuhia*

e Atlantikut që u zhvillua në Uashington në 14 janar 2005. Kjo lojë politike e bazuar në skenar, angazhoi disa ish-udhëheqës shteti dhe politikëbërës aktivë nga një kampion prej qeverive të Evropës dhe të Amerikës së Veriut. Mësimet e nxjerra nga ky ushtrim u pasqyruan gjerësisht në media.²⁷ Formatu u testua në mars nga anëtarët e Komitetit të ri të Sigurisë së Atdheut të Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit të Shteteve të Bashkuara. Seminare të tilla shumëpalëshe duhet të mbledhen edhe në Evropë.

Përmirësimi i sigurisë në shoqëri në dy anët e Atlantikut mund të bëhet një mision qendror për punën e ardhshme të NATO-s dhe të komunitetit të zgjeruar të Partneritetit për Paqe. Vendet Nordike bashkë me SHBA-në mund të ofrojnë udhëheqje në zhvillimin e një Partneriteti për Trainime brenda Partneritetit për Paqe. Një axhendë pune e tillë do të shërbejë për të lidhur bashkë programet në evoluim të shpejtë në lidhje me sigurinë shoqërore brenda BE-së dhe të BE-së, dhe dinamikat, që kryesisht janë orientuar së brendshmi, e investimit masiv të Shteteve të Bashkuara në institucione dhe politika për Sigurinë e Atdheut.

Bengt Sundelius është Profesor i Qeverisjes në Universitetin e Uppsalas dhe Drejtor themelues i Qendrës Kombëtare për Kërkime dhe Trainime për Menaxhimin e Krizave (CRISMART) të Kolegjit Suedez të Mbrojtjes Kombëtare. Ai është Shkencëtar i Parë i Agjencisë Suedeze për Menaxhimin e Urgjencave, që promovon kërkimet në fushën e sigurisë së atdheut. Libri i tij më i fundit është Politika e Menaxhimit të Krizave [The Politics of Crisis Management] (Cambridge University Press, 2005).

²⁷ Daniel Hamilton and Tara O'Toole, "Facing up to the Bioterror Threat," *International Herald Tribune*, 31 January 2005.

Gj.Lt. (rez.) Pëllumb Qazimi

Të kuptuarit e transformimit ushtarak të NATO-s, nga këndvështrimi i një vendi partner

Çështjet e transformimit në tërësi dhe ato të fushës ushtarake në veçanti janë të shumanshme, komplekse, shumëpërfshirëse. Për sa i përket pozicionimit të një vendi që aspiron për anëtarësim në Aleancën Evropatlantike, natyrshëm shtrohen shumë çështje të vizionit, koncepteve, misioneve, detyrave të strukturave ushtarake, rrugëve të ndryshimit e të zhvillimit, etj. Megjithatë, si anëtarët e vjetër të NATO-s, ashtu edhe anëtarët më të rinj në njëfarë mënyre mund të quhen “aspirantë” në sensin se të gjithë duhet të ndryshojnë, me synimin që t’iu përgjigjen sfidave të sigurisë së shekullit që ka filluar. Vetë Aleanca e NATO-s është një organizëm që vetëzhvillohet. Jo thjesht se ajo është zgjeruar me anëtarë të rinj, apo se anëtarë të tjerë do të anëtarësohen një ditë, por sepse ajo vetë e ka të nevojshme përshtatjen e mëtejshme ndaj sfidave të reja.

NATO-ja gjatë viteve të fundit ka qenë e angazhuar në më shumë se tetë operacione ushtarake nëpër botë. Ndërkohë, ia vlen të nënvizohet se NATO-ja e Luftës së Ftohtë nuk ka drejtuar qoftë edhe një angazhim të vetëm ushtarak. Referuar realitetit të sotëm, në një kuptim të caktuar, vendet aspirante ndihen si anëtare të Aleancës, përderisa janë pjesë e kontributeve të përbashkëta ushtarake, duke vënë në përdorim trupa e mjete, gjë që ka qenë fare e paimagjinueshme, le të themi edhe pesë e më shumë vite më parë. Mund të konsiderohet si shumë e rëndësishme që vendet aktuale aspirante si Shqipëria, Kroacia, Maqedonia, apo edhe vende të tjera, kanë ofruar kontribute njëherë, përpara se të presin anëtarësimin e tyre.

Jo më shumë se pesë vite më parë, disa nga vendet e Ballkanit kanë qenë pjesë e problemeve dhe konflikteve.

Ndërsa sot, përse të mos jemi edhe krenarë, se jemi bërë, ose të paktën kemi filluar të jemi një pjesë e kontributeve për zgjidhje diku jashtë rajonit tonë. Demokracitë e brishta të rajonit, dukshëm kanë normalizuar marrëdhëniet ndërmjet tyre. Kontigjentet paqeruajtës në rajonin e Ballkanit kanë ardhur përherë në ulje dhe një rikthim në konflikt duket se nuk i ka mundësitë. Rajoni është jo vetëm duke forcuar qëndrueshmërinë, por dhe duke kontribuar në koalicionet ndërkombëtare, të cilët janë të angazhuar për t'u dhënë fund konflikteve diku gjetkë. Rajoni ynë është në rrugën e shndërrimit nga konsumator në prodhues sigurie. Pranimi dhe bashkëpunimi janë bërë tashmë realitet në vend të përjashtimit dhe konfrontimit.

Për herë të parë që nga rënia e Murit të Berlinit dhe ndoshta për herë të parë në histori, madje në nivel të lartë, përmes premtimit e aspiratës së integritimit Evropian, demokracia, paqja, prosperiteti dhe sovraniteti, janë objektiva tërësisht të realizueshme si për Shqipërinë, ashtu dhe për fqinjët e vet në rajon. Për herë të parë të gjithë vendet e rajonit janë përfshirë në procesin e integritimit në NATO dhe Bashkimin Evropian. Dhe të gjithë kanë deklaruar angazhimin e tyre për qeverisje demokratike dhe në ekonominë e tregut.

Duhet të jetë e qartë se NATO-ja nuk është thjesht një Aleancë ushtarake. Ajo që i lidh anëtarët e Aleancës së bashku, është bindja në vlerat e Aleancës, lirisë, respektimit të të drejtave të njeriut, qeverisje demokratike, vendosjen e shtetit ligjor, parimet e ekonomisë së tregut të lirë. Në 15 vjetët e fundit Shqipëria ka bërë një ndryshim të dukshëm nga koncepti i luftës totale, pjesë e një shoqërie të orientuar totalisht nga brenda – drejt një sigurie kolektive dhe bashkëpunimi të orientuar nga jashtë. Nga strukturat masive ushtarake është kaluar në struktura më të vogla, por më profesionale, më të afta, të dislokueshme dhe të përballueshme. Nga konceptet dhe praktikat totalitare ushtarake është kaluar në kontrollin civil demokratik të forcave të armatosura, duke i bërë këto të fundit pjesë të shoqërisë, të përgjegjshme dhe duke i vënë në shërbim të tyre.

Kohët e fundit Shqipëria ka qenë e angazhuar ushtarakisht në mënyrë të vazhdueshme me trupa ushtarake në Afganistan (me togë këmbësorie), në Irak (me kompani Komando) dhe në Bosnjë e Hercegovinë (me kompani këmbësorie).

Gjithashtu, në frymën e Kartës SHBA-Adriatik 3, personeli ushtarak mjekësor së bashku me personelin kroat dhe maqedonas vazhdojnë të jenë të pranishëm në Kabul, Afganistan, përmes Ekipit të Përbashkët Mjekësor në kuadrin e ISAF. Viti 2006 shënoi gjithashtu dislokimin për herë të parë të shtabit të Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG), në rolin e Shtabit të Brigadës Shumëkombëshe në Kabul, Afganistan (për gjashtë muaj). Në këtë shtab Shqipëria u përfaqësua me oficerë dhe nënoficerë, të cilët vepruan në krah me personelin tjetër të vendeve anëtare të nismës së Evropës Juglindore. Në të gjithë këto angazhime, personeli ushtarak shqiptar vepron me dhe në përbërje të njësive ushtarake amerikane, gjermane, turke, por edhe me njësi ushtarake të vendeve të tjera anëtare të NATO-s, si Greqia, Rumania, Bullgaria, etj.

Angazhimet e mësipërme shtohen më tej po të merren parasysh edhe kontribute të tjera si në Gjeorgji (me vëzhgues ushtarakë të OKB-së), në Bagdad e Kabul me oficerë e nënoficerë shtabi në shtabet ndërkombëtare, etj. Sot paraqitet një shpërndarje e gjerë gjeografike e angazhimeve ushtarake ndërkombëtare. Shqipëria është duke vepruar në operacione nën flamurin e NATO-s në Afganistan, nën flamurin e BE-së në Bosnjë-Hercegovinë, me palën amerikane në Irak, nën flamurin e OKB-së në Gjeorgji. Kohët e fundit, Kryeministri i Shqipërisë është shprehur se Shqipëria po konsideron pjesëmarrjen ushtarake edhe në Liban, si dhe po rishikon një zgjerim të mundshëm të pranisë ushtarake shqiptare në Afganistan.

Shembujt e mësipërm flasin për atë se Shqipëria, ashtu sikundër edhe dy vendet e tjera të Kartës së Adriatikut dhe vende të tjera, më parë po japin, po kontribuojnë për sigurinë, madje shumë larg rajonit të tyre dhe mandej presin ftesën për anëtarësim. Ky tregues përbën ndryshim si dhe paraqet një cilësi të re, krahasuar me vendet që janë anëtarësuar më parë në Aleancë.

Çfarë anësh pozitive, apo le të themi të reja, kanë sjellë angazhimet ushtarake ndërkombëtare të Shqipërisë? Po kalohet përfundimisht në plotësimin e kontigjentëve që dërgohen për të marrë pjesë në operacionet e mbështetjes së paqes, me personel profesionist. Pra, në operacionet jashtë vendit nuk do të ketë më ushtarë rekrutë, pra shërbim të detyrueshëm aktivë. Kjo përbën prirje thelbësore në forcat ushtarake të vendeve anëtare të Aleancës.

Trupat shqiptare që angazhohen në operacione jashtë vendit, kalojnë në të gjitha fazat respektive të stërvitjes. Por, përpara nisjes në mision ato i nënshtrohen edhe stërvitjes speciale, duke përdorur poligone të qëllimshme, të ngjashme me realitetin e teatrit ku do të vepron. Jo vetëm kontigjentet paqeruajtës, por edhe strukturat ushtarake të përparësisë, si dhe njësitë e tjera prej vitesh i janë nënshtruar raportimit të përhershëm të gatishmërisë së tyre operacionale. Kjo ka qenë, si të thuash, rregullator i standardizuar për drejtuesit dhe njësitë ushtarake. Nga ana tjetër kërkesat e këtij sistemi, tashmë të aplikuar, kanë qenë në njëfarë mënyre pararendëse dhe mbështetëse të zbatimit të Konceptit të NATO-s për Aftësitë Operacionale. Ky koncept është pranuar, njohur, instruktuar, si dhe aplikuar edhe nga njësi ushtarake shqiptare. Këto njësi i janë deklaruar Aleancës dhe i janë nënshtruar niveleve përkatës të vlerësimit, deri në certifikimin e plotë të tyre. Në mënyrë normale, vit pas viti, është arritur jo fiktivisht, por efektivisht të pranohen e realizohen aftësitë operacionale, që në aspektin ushtarak kërkohen nga Aleanca.

Operacionet në Mbështetje të Paqes përfaqësojnë një përvojë shumë të vlefshme për Forcat e Armatosura shqiptare. Ajo që po bën Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura, është për t'u përshëndetur. Evidentimi i problematikave që këto angazhime shprehin, nxjerrja e mësimëve dhe konsiderimi i tyre për të ardhmen përfaqëson një fushë të re veprimi. Rëndësia dhe vlera qëndron në aspektin konceptual, të reflektimit dhe të zbatimeve me synim përmirësimet e përsosjet në të ardhmen.

Përvoja tregon se çështja e mësimëve të nxjerra nga Operacionet e Mbështetjes së Paqes ka rëndësi të veçantë. Secili nga problemet përfaqëson një sfidë në vetvete. Është pikërisht kjo përvojë dhe këto mësim të nxjerra, që Shqipëria deklaroi se duke zbatuar konceptin e NATO-s për Aftësitë Operacionale do të ketë në fund të vitit 2006 një batalion operacional, të gatshëm për t'u angazhuar gjatë vitit 2007 në operacione të mundshme të Aleancës. Ky model, ose projekt do të vijohet gjatë viteve të ardhshme nga batalione të tjera të njësisë së Reagimit të Shpejtë dhe të njësisë Komando.

Më duket i goditur vlerësimi se angazhimet jashtë vendit, në operacione në mbështetje të paqes, përfaqësojnë aftësi, kapacitete, përfaqësojnë mënyrën e transformimit të komponentit ushtarak në vendet e vogla. Në vlerësimin zyrtar

shqiptar, por edhe në vlerësimin e vendeve të tjera të vogla që kërkojnë anëtarësim në NATO, ajo që kërkohet në aspektin ushtarak është forcë e armatosur profesioniste, operacionale, efektive dhe e përbalueshme.

Gjithsesi, jemi të ndërgjegjshëm se ende duhet shumë për të bërë. Përshtatur me kushtet tona, përparësi ka qenë dhe është, e ashtuquajtura “teknologji intelektuale”, e cila ka në përbërje ushtarakë të aftë, profesionistë, të arsimuar, të mirëstërvitur, shoqëruar me lidërsip të aftë. Ne kemi nevojë për mënyra e mjete të reja për t’u përballur me sfidat e reja të sigurisë. Kjo nënkupton një grupim të ndryshëm aftësish, ndoshta me më shumë theks në aftësitë për t’u dislokuar shpejt dhe kryesisht në operacionet në mbështetje të paqes, sesa në operacionet e mbrojtjes territoriale. Ky përbën një ndryshim shumë të madh në koncept, i cili kërkon transformim të përgjithshëm në sensin politik, institucional, dhe ekonomik, ashtu dhe në fushën ushtarake. Për më tepër, nuk ka si të realizohet pa një punë të mundimshme.

Buxheti i mbrojtjes duhet të jetë më i madh dhe të marrë përsipër barrë më të madhe. Jo se kërkohet më shumë, por nevojitet më shumë. Buxheti i Mbrojtjes duhet të mbajë barrën e transformimit të nevojitur, barrën e angazhimeve të sotme ushtarake dhe barrën e integritit. Sot kërkohet të harxhohen më shumë para në kapacitete, në aftësi. Në kuptimin e aftësive, do të ishte plotësisht e arsyeshme dhe e justifikueshme për të vënë theksin në efektivitetin e ushtarit dhe luftëtarit si individ dhe në njësitë e vogla ushtarake.

Për këdo është e njohur se reforma dhe ndryshimi ushtarak është i dhimbshëm dhe për ta realizuar atë duhen burimet e nevojshme mbështetëse. Ndërkohë, është e domosdoshme që burimet të përdoren me zgjuarsi. Shqipëria është një vend i vogël. Ajo, duke aspiruar për t’u bërë anëtare e Aleancës më të madhe e më të fortë demokratike në historinë botërore, nuk ka opsion tjetër përveç vazhdimësisë për të qenë e angazhuar përmes ofrimit të vazhdueshëm të cilësive më të larta, më të përshtatura me kërkesat e përgjigjes ndaj sfidave të ardhshme, që njëherazi Aleanca përballet dhe do të përballet.

Gjeneral Leitnant (në rezervë) ish-shëfi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Ronald D. Asmus

Drejtor i Fondit të planit Marshall Gjerman

Rishpikja (rishtas) politike e NATO-s

Një mënyrë përshkrimi më e saktë e pamjes së sotme disi paradoksale e Aleancës së Atlantikut të Veriut, mund të konsiderohet ai i përmbledhur në tre vëzhgimet në vijim:

Së pari, një vizitë e shpejtë në selinë qendrore të NATO-s tregon një Aleancë që sot për sot, është më shumë e angazhuar në misione dhe aktivitete, se në çdo kohë tjetër. Nuk është një ekzagjerim të thuash që NATO-ja sot po jeton periudhën më impenjative se kurrë më parë, që nga koha e krijimit të saj - mëse gjysmë shekulli më parë - dhe në shumë zona kyçe, të konsideruara në kufi të të qenit të mbitensionuara.

Së dyti, problemet e reja në të cilat njerëzit duan ta shohin NATO-n të angazhuar ose në të cilat ajo duhet të zgjerojë misionet e veta ekzistuese, nuk janë të pakta: rritja e rolit të saj në Afganistan; më shumë përgjegjësi në Irak; hedhja e hapave për zgjerimin e zonës së ndikimit të NATO-s në rajonet rreth Detit të Zi ose luajtja e një roli mbështetës në vendosjen e paqes në Lindjen e Mesme. Një numër shtetesh po kërkojnë lidhje strategjike më të ngushta dhe një anëtarësim të mundshëm në Aleancë, duke përfshirë këtu edhe disa shtete ballkanike, Azerbajxhani, Gjeorgjia dhe Ukraina. Mund të vërejmë gjithashtu edhe rizgjimin e debateteve të trazuara në Izrael, mbi një eksplorim më të hollësishëm të lidhjes evro-atlantike. Sigurisht, mbetet ende edhe një detyrë për NATO-n, dhe kjo ushtron një ndikim të konsiderueshëm në Evropë dhe më gjerë.

Së treti, NATO-ja shihet si më pak në qendër të vëmendjes nga disa aktorë kyç të disa vendeve të rëndësishme në të dyja anët e Atlantikut. Komente si ai i reduktimit të Aleancës në një "vegël" nga sekretari amerikan i mbrojtjes Donald Rumsfeld ose sugjerimi i kancelarit gjerman Gerhard Schröder se Aleanca nuk është më vendi ku mund të diskutohen çështjet më të rëndësishme strategjike të ditës, do të ishin absolutisht të paimagjinueshme një dekadë më parë në kohën kur sekretari

amerikan i mbrojtjes dhe kancelari gjerman kanë qenë avokatët dhe mbrojtësit më të mirë të NATO-s.

Arsyeja e këtij paradoksi në të vërtetë është shumë e thjeshtë. Mbas kolapsit të komunizmit dhe Bashkimit Sovjetik, NATO-s iu desh ta rishpikte politikisht veten e saj në mënyrë që të përballonte sfidat e reja të periudhës pas Luftës së Ftohtë. Vërtet, rishpikja e Aleancës së asaj periudhe është një nga arsyet kryesore pse Evropa, si e tërë, është më e sigurtë dhe më në paqe se në çdo kohë tjetër të periudhës së fundit të historisë. Pas 11 shtatorit 2001, gjithsesi, Aleanca është ballafaquar me nevojën për ta rishpikur veten për herë të dytë për të përballuar periudhën e pas-Luftës së Ftohtë, që është përqendruar jashtë Evropës, veçanërisht në Lindjen e Mesme. Ndërsa NATO-ja e ka rishpikur veten me sukses për të përballuar sfidat e para, por nuk ka mundur – të paktën deri tani – të bëjë hopin e nevojshëm për sukses në sfidat e llojit të dytë.

Cilat ishin sfidat e viteve '90, të cilat Aleanca arriti t'i menaxhonte me sukses? Problemi kryesor ishte pikërisht përfundimi e luftërave etnike të Ballkanit, zbatimi i demokracive të reja në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe stabilizimi i një marrëdhënieje të re bashkëpunimi me ish-kundërshtarit e Aleancës, Rusinë. Për të qenë më e sigurt në veprim, Aleanca fillimisht ishte e ngadaltë në lëvizjen kundër spastrimit etnik në Ballkan. Ndryshimi i marrëdhënieve NATO-Rusi dhe shtrirja e ndikimit të saj në rajon kërkoi përpjekje të shumta dhe çoi në probleme të ndryshme, në disa raste gati fatale. Gjithsesi, gjatë një dekade NATO-ja transformoi vetveten me sukses nga një aleancë Amerikano-Veriore – Evropiano-Perëndimore e fokusuar ekskluzivisht në mbrojtjen territoriale, në një institucion pan-evropian me anëtarë të rinj duke u shtrirë nga vendet baltike e në Detin e Zi dhe misionet gjithnjë e më shumë u përqendruan në vende që zakonisht konsideroheshin “jashtë zonës”. Kjo nuk ishte një arritje e vogël.

Sfidat e reja strategjike

Ndërsa ndryshimet që arriti të bënte në kohët e mëparshme dukeshin të stërmëdha, sot mund të kuptohet fare lehtë që ato janë të papërshtatshme për të ruajtur paqen në politikën mbarëbotërore të shek. XXI. Sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 shënuan një tërmet të dytë që e detyroi Aleancën të

rishqyrtonte edhe një herë parametrat politike që udhëhoqën rikonstruktimin e mëparshëm strategjik të NATO-s. Nga pikëpamja strategjike, Aleanca u përball me nevojën për një kërcim tjetër të rëndësishëm përpara – që do ta çonte atë përtej kufijve gjeografikë zyrtarë të pjesës evro-atlantike në territore të tilla si Lindja e Mesme. Rënia e Kullave Binjake në Manhatan shkatërroi përkufizimin tonë për fuqinë e Nenit 5. Gjithashtu, Osama bin Laden tregoi që ndarja e sigurisë mes pjesës evro-atlantike dhe Lindjes së Mesme u shemb. Amerikanët dhe evropianët filluan të kuptonin që çështjet më problematike për komunitetin evro-atlantik nuk buronin më nga Evropa, por përtej saj.

Në fund të viteve '90, NATO-ja filloi të debatonte nëse duhej t'i shtrinte synimet e saj strategjike edhe përtej kufijve të Evropës drejt Lindjes së Mesme në lidhje me diskutimet mbi Konceptin e saj të ri Strategjik, por ky proces dështoi. Përveç këndvështrimit të Uashingtonit, pjesa më e madhe e partnerëve evropianë në atë kohë preferuan ta kufizonin rolin e ardhshëm të NATO-s në menaxhimin e sigurisë së nevojshme në Evropë dhe në rrethinat e saj dhe të mos kalonte vijën për role të ardhshme potenciale në Lindjen e Mesme. Por kjo pikëpamje u bë anakronike dhe u shemb nën peshën e zhvillimeve të fundit – pikërisht si mendimi konvencional në fillin të viteve '90 që NATO-ja nuk mund dhe nuk duhet të ndërmarrë misione përtej mbrojtjes së brendshme territoriale – dhe u tregua e papërshtatshme për kohën. Senatori i Shteteve të Bashkuara, Richard G. Lugar, e përkufizoi dilemën e Aleancës me frazën që NATO-ja duhet të dalë ose “jashtë zonës ose jashtë funksionit”. Çështja ishte e thjeshtë, por e thellë: nëse NATO-ja shpresonte të mbetej aleanca qendrore e Perëndimit, duhet të rigjykonte dhe t'i adresonte çështjet dhe sfidat qendrore strategjike të ditës, pavarësisht se nga vinin ato.

Sot ndoshta harrohet lehtë se sa keqazi u nda Aleanca në kohën e luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, por mund të ketë edhe ndër ata që e mbajnë mend mirë faktin që ribashkimi Francë-SHBA në atë kohë ishte dhe çelësi i zgjidhjes së krizës, i cili më vonë u zbulua të ishte gjithashtu edhe një katalizator i përshtatshëm për qëllimet e reja strategjike që çuan NATO-n drejt një faze rindërtimi si politik ashtu edhe strategjik që u zgjerua më tej edhe gjatë pjesës së mbetur të dekadës. Ky ishte një shembull klasik i liderëve, të cilët përdorën një krizë historike për të shmangur mbetjen në vend dhe rezistencën e brendshme dhe për ta udhëhequr këtë strukturë drejt një

rindërtimi strategjik dhe reformave të nevojshme që do ta rigjallëronin atë.

Fatkeqësisht nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për 11 shtatorin. NATO-ja sigurisht apeloj te Neni 5 si kundërpërgjigje ndaj sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara. Historianët do të gjykojnë nëse Shtetet e Bashkuara – udhëheqësi i padiskutueshëm i Aleancës – bënë një gabim historik në anashkalimin dhe mospërfshirjen e Aleancës më thellësisht, që në fazat e para të zhvillimeve në Afganistan. Edhe sikur një rol i tillë të kishte qenë fillimisht i kufizuar, ai do të kishte pasojat e jashtëzakonshme dhe pozitive për të vendosur Aleancën në një trajektore tjetër dhe për të konsoliduar një përkushtim të përbashkët për adresimin e sfidave të prezantuara nga mjedisi i ri i sigurisë. Për dikë që është përpjekur shumë gjatë viteve të shkuara për ta nxitur Aleancën për t'u zgjeruar përtej Evropës, kjo pa dyshim që do të dukej si një mundësi e artë për të mposhtur kundërshtimet e së shkuarës dhe për ta shtyrë njëherë e përgjithmome NATO-n drejt epokës së re.

Administrata e Bushit sigurisht që e korrigjoi kursin e saj më vonë. Sot Afganistani përbën një ndër misionet më të rëndësishme të NATO-s, por sidoqoftë çasti historik tashmë ishte humbur dhe rrjedhimisht kriza e mëpasshme mbi domosdoshmërinë dhe drejtësinë e luftës në Irak e la Aleancën thellësisht të ndarë, duke i bërë debatet e mëparshme, si ai mbi Bosnjën dhe Hercegovinën, të dukeshin asgjë përpara kësaj. Në vend që të bëhej një lajmëtar i një riorganizimi të dytë, më i gjerë, politik i Aleancës, ndërhyrja që do t'i hapte dyert një reforme më përfshirëse, 11 shtatori e ka lënë NATO-n me paradoksin e përshkruar në fillim të këtij artikulli: NATO-ja është më e impenjuar se kurrë më parë, ende konsiderohet në disa qarqe, por gjithashtu ndihet si e lënë disi mënjanë.

Një rishpikje tjetër

Cila është rrugëzgjdhja e kësaj shtate? Në mesin e viteve '90 bëhej shpesh pyetja: nëse NATO-ja nuk do të ekzistonte a do ta kishim rishpikur atë? Dhe nëse do ta krijonim, çfarë do të bënim ndryshe? Në atë kohë ishte shumë e lehtë të përgjigjeshe. Ishte e dukshme që Evropa dhe Amerika e Veriut ende donin një aleancë strategjike, që do të përfaqonte gjithë Evropën dhe jo vetëm gjysmën e saj; që do të pasqyronte një

balancë të re mes Evropës dhe Amerikës së Veriut; që do të orientohej drejt kërcënimeve të reja në vend të atyre të vjetra dhe që do të përpiqej të ndërtonte partneritete me vendet kryesore të periferisë së Evropës, siç është Rusia. E thënë shkurt, përgjigjja përmbante të gjitha elementet thelbësore të llojit të reformave që i nevojitej NATO-s – zgjerimi, një Politikë Evropiane e Sigurisë dhe e Mbrojtjes, misione të reja dhe zgjerimi i partnerëve – dhe që u implementuan.

Shtrimi i së njëjtës pyetje sot, mund të konsiderohet si një tentativë po aq ndihmuese për planifikimin e një lloji rindërtimi ose rishpikjeje për të cilën ka nevojë Aleanca sot. Unë, për shembull, ende besoj pa mëdyshje se Shtetet e Bashkuara duan dhe kanë nevojë për një aleancë strategjike që të adresojë kërcënimet kyçe në dy anët e Atlantikut. Përveç kësaj, do të argumentoja që NATO-ja sot ballafaqohet me dy axhenda të ndryshme, por gjithnjë e më shumë të lidhura me njëra-tjetrën, të cilat duhet të jenë në qendër të rishpikjes së dytë të Aleancës.

E para, është të vazhdojë strategjinë e promovimit, përhapjes dhe zhvillimit të demokracisë dhe stabilitetit gjithnjë e më shumë në Evro-Azi dhe veçanërisht në rajonin e Detit të Zi. Në mënyrë më specifike, kjo do të thotë të ndihmojë në konsolidimin e fitores së Revolucioneve Portokalli dhe të Trëndafiltë dhe të ankorojë pranë Perëndimit një Ukrainë demokratike së bashku me Gjeorgjinë dhe Kaukazin Jugor. Një ankorim i tillë është gjithashtu një nga mënyrat më të mira dhe më efektive me anë të së cilës Evropa dhe Shtetet e Bashkuara mund të promovojnë zhvillimin e demokracisë në Rusi, që duhet të jetë objektivi ynë përfundimtar. Axhenda e dytë, e lidhur me të parën, është nevoja për të projektuar stabilitet në rajonin e Detit të Zi – jo vetëm si pjesë e përpjekjeve për të ndërtuar një Evropë të bashkuar dhe të lirë, por njëherësh edhe me një vështrim mbi Lindjen e Mesme. Së bashku, kjo që do të përbënte të tretën valë të madhe të shpërhapjes dhe integritetit evro-atlantik. Sikurse zgjerimi i NATO-s drejt Evropës Qendrore dhe Lindore ndihmoi eliminimin e burimeve historike të konflikteve dhe rivaliteteve gjeopolitike në kontinent, ankorimi i Ukrainës dhe i rajonit të Detit të Zi në Perëndim, do ta rihartojë hartën e Evropës, për më mirë.

Këto axhenda, gjithashtu, do ta pozicionojnë më mirë NATO-n për t'u bërë një aktor më i rëndësishëm në Lindjen e Mesme, pjesa e botës prej së cilës ka më shumë mundësi të lindin edhe kërcënimet më të rrezikshme ndaj shoqërive tona në

dhjetëvjeçarët e ardhshëm. Nuk duhet ta harrojmë kurrë që NATO-ja është në gjendje edhe të shpallë luftë edhe të ndërtojë paqen – dhe të dyja këto aftësi mund të jenë të nevojshme gjatë viteve që do të vijnë, ndërsa përballemi me kërcënimet e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe terrorizmi ndërkombëtar. Vërtet, nëse ka një fushë ku planifikuesit e NATO-s duhet të mendojnë në mënyrë krijuese se si Aleanca mund të ndihmojë zhvillimin e kuadrove dhe partneriteteve, roleve dhe misionëve reja, pikërisht kjo është ajo.

Rruga përpara

Ardhja për herë të dytë në pushtet e presidentit Bush dhe dedikimi i tij i ri për përmirësimin e marrëdhënieve mes dy anëve të Atlantikut mund të ofrojë një shans të dytë për të kompletuar rishpikjen e pas 11 shtatorit që i nevojitet NATO-s. Gjatë vlerësimit të nevojave për ndryshim, disa konsiderata duhet të jenë pika kyçe.

Së pari, kjo është kryesisht një sfidë politike. Parakusht për rishpikjen e dytë të NATO-s është pikërisht arritja dhe rikrijimi i një sensi të ri të qëllimeve strategjike të Evropës dhe Shteteve të Bashkuara dhe bashkimi i tyre për të përballuar çdo sfidë të shekullit të ri. NATO-ja është si për luftën ashtu edhe për paqen, dhe nuk ka çështje të tjera që janë më politike se kjo. Vendet anëtare thjesht nuk duhet t'i bëjnë vetë zgjedhjet e tyre të rëndësishme për atë se si duhen ndërtuar ose ristrukturuar forcat e armatosura dhe si duhen krijuar kapacitetet e reja për atë kohë sa ne të kemi arritur dhe të kemi rënë dakord në një sens të ri të qëllimeve të përbashkëta.

Së dyti, problemet me të cilat ne përballemi nuk janë gjithmonë ose domosdoshmërisht probleme ushtarake. Strategjitë duhet të jenë politike, ekonomike dhe ushtarake. Për këtë arsye NATO-ja do të jetë vetëm një pjesë, vetëm një instrument dhe vetëm një fushë ndryshimesh midis të tjerave. Roli i Bashkimit Evropian dhe i bashkëpunimit me SHBA-në do të rritet duke u bërë gjithnjë e më shumë i rëndësishëm, përderisa edhe çështjet që ne duhet të përballojmë janë gjithnjë në ndryshim. Por roli që NATO-ja mund dhe do të luajë do të jetë po atë statik, i pandryshueshëm sa dhe kritik – dhe asnjë institucion tjetër nuk mund ta garantojë atë. NATO-ja është një instrument për të ndërtuar paqe po atë sa për të shpallur luftë.

Ne duhet të mendojmë për mënyrën se si duhet t'i përdorim të dyja këto kapacitete dhe role të saj. Komponenti i saj paqeruajtës mund të shfaqet po aq i rëndësishëm dhe kritik sa edhe aftësia e saj për të filluar dhe vazhduar luftën në këtë pjesë të botës.

Së treti, një çështje kryesore e rishpikjes së ardhshme të NATO-s duhet të jetë edhe ribalancimi i brendshëm mes Amerikës së Veriut dhe një Evrope gjithnjë e më të integruar. Ne kemi nevojë për një funksionim të ri dhe sa më efikas të marrëdhënies BE-NATO, po ashtu si për një funksionim të ri edhe të një marrëdhënieje të re BE-SHBA, që edhe nga pikëpamja strategjike duhet të jetë gjithnjë e më cilësore. Megjithëse disa amerikanë e kanë të vështirë ta pranojnë një gjë të tillë, një nga arsytet pse disa vende evropiane sot janë kundër bashkimit me NATO-n është pikërisht bindja që ata kanë se strukturat e saj janë në mënyrë subjektive në favor të Shteteve të Bashkuara dhe nuk marrin parasysh mjaftueshëm rëndësinë gjithnjë në rritje të Bashkimit Evropian dhe progresin e arritur gjatë integritimit të gjithnjë e më shumë vendeve evropiane në të. Është për t'u marrë në konsideratë fakti që një komponent kyç në këtë reformë, që i erdhëm mjaft afër kurorëzimit në vitet '90, ishte riintegrimi i plotë i Francës në NATO. Sot, Aleanca ende paguan një çmim për këtë mundësi të humbur dhe dështim të saj. Pra, rishpikja e dytë politike e Aleancës sot duhet ta përmbushë me sukses këtë detyrë.

NATO-s sot i duhet një rishpikje e dytë politike – që të mund të ribalancojë Aleancën dhe të shtrijë angazhimin e saj më thellë në komunitetin evro-atlantik dhe përtej, drejt rajoneve të Lindjes së Mesme. Ky strukturim strategjik i saj është po aq ambicioz sa ai i ndërmarrë dhe i përmbushur në vitet '90. Shumë mund ta konsiderojnë atë si ambicioz, ndërsa skeptikët dhe kritikët do të thonë që është një mision i pamundur. Por mund të themi se të njëjtat zëra janë dëgjuar edhe në fillimet dhe mesin e viteve '90. Sot ne jemi më mirë edhe sepse liderët tanë i injorojnë ato dhe e lënë nevojën për ta modernizuar Aleancën për një periudhe të re, dhe realisht, nëse kemi ndonjë mësim që mund të marrim nga vitet '90, është pikërisht që në atë kohë ne nuk mundëm të ishim aq ambiciozë sa duhej.

Ronald D. Asmus është drejtor i Fondit të planit Marshall Gjerman pranë Qendrës Transatlantike të Shteteve të Bashkuara në Bruksel, Belgjikë dhe autor i "Hapja e dyerve të NATO-s", një histori diplomatike e zgjerimit të NATO-s (Columbia University Press, 2002).

Franko Egro

Kryeredaktor TV Koha

NATO-ja dhe sfidat e saj

Kur kanë mbetur edhe pak ditë nga Samiti i liderëve të NATO-s në Letoni, i pari pas dy vjetësh, përfaqësuesit e katër shteteve aspirante për t'u bërë pjesë integrale e Aleancës ushtarake tashmë unike në botë janë shumë të interesuara për t'i përshpejtuar ritmet e procesit që do t'ua hapte rrugën. Por, tashmë përbën sekret të hapur fakti se ato po ballafaqohen me dyshime serioze nga vetë shtetet anëtarë nëse ata e dëshirojnë vërtet një gjë të tillë. Kroacia, Maqedonia, Shqipëria dhe Gjeorgjia shpresojnë shumë se do të arrijnë të kualifikohen. Në takimin e fundit të Kryeministrave të këtyre katër vendeve, që u zhvillua në Kroaci, ishin të pranishëm përfaqësues të Shteteve të Bashkuara të Amerikës si edhe zyrtarë të lartë të NATO-s dhe Bashkimit Evropian.

Prej të katër shteteve kandidate Kroacia, vlerësohet pa dyshim si vendi me mundësitë dhe shanset më të mëdha të anëtarësimit në vitin 2008. Edhe pse nga të gjitha strukturat drejtuese të Aleancës insistohet se të gjitha vendet kanë mundësi ato sigurisht që do të gjykohen dhe do të analizohen individualisht. Më konkretisht do të shqyrtohen në imtësi përparësitë dhe mangësitë për të cilat ka opinione të ndryshme dhe kontrastuese, mbi të gjitha lidhur me shpejtësinë e anëtarësimit nga njëra anë dhe mundësitë absorbuese të saj nga ana tjetër. Insistimi amerikan për anëtarësimin e Ukrainës dhe Gjeorgjisë, dy ish-shtete anëtare të Bashkimit Sovjetik anëtarësimin e së cilës e kundërshton me këmbëngulje Rusia ka shkaktuar tension jo të vogël, por njëkohësisht edhe jo pak konfuzion. Ky gjest ka ngjallur pakënaqësi dhe dyshime në radhët e shumë anëtarëve evropiane dhe të Kanadasë, të cilët nga këndvështrimi i tyre hezitojnë shumë për shtrirjen e Aleancës në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe jo më në “stepat e Kaukazit” siç po etiketohen.

Një numër analistësh amerikanë, por edhe shumë zyrtarë të lartë të Pentagonit dhe të Departamentit të Shtetit shprehen se ky qëndrim skeptik i evropianëve influencohet dhe kushtëzohet në një masë të konsiderueshme nga frenimi i procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian, pasi një zhvillim i tillë është cilësuar si aspak popullor nga banorët e 25 vendeve anëtare. “Lodhja për zgjerimin evropian ndihet edhe në radhët e NATO-s”, është përfundimi me të cilin shkojnë amerikanët në Samitin e Rigës, mesazh ky që u përcoll edhe në takimin e Dubrovnikut.

Në janar të vitit të ardhshëm dy shtete ballkanike Rumania dhe Bullgaria do të anëtarësohen në BE dhe shumica e vendeve anëtare të këtij organizmi, 21 prej të cilave janë edhe anëtare të NATO-s mendojnë se zgjerimi i mëtejshëm i Aleancës Ushtarake do të përkthehej në më shumë angazhim. Më tej Kroacia, Maqedonia dhe Shqipëria vazhdojnë të shpresojnë se në Samitin e nëntorit do të kthjellohen tej mase për kohën se kur do të ndodhë ky hap madhor për ta. Por, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jaap de Hop Skefer, si gjithnjë i drejtpërdrejtë, konfirmoi gjatë një turneu (të fundit në rajon) se një gjë e tillë pritet të ndodhë nga viti 2008, ose më saktë në Samitin pasardhës të Uashingtonit. Nga ana tjetër, zyrtarët amerikanë janë shumë më të interesuar dhe shumë më të angazhuar për ta inkurajuar këtë zgjerim. Këtu qëndron edhe dallimi mes dy palëve, ose thënë më saktë interesat gjeopolitike dhe strategjike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga njëra anë dhe e Evropës nga ana tjetër në këtë pikë janë të ndryshme.

Qysh prej shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik dhe të Jugosllavisë në dekadën e fundit të shekullit të kaluar dhe sulmeve terroriste të 11 shtatorit kundër SHBA-së, por edhe të tjerave në Britaninë e Madhe, Spanjë, etj., NATO-ja po tenton ta transformojë misionin e saj. Në objektivin e vet po futet gjithnjë e më me shumë guxim dëshira për t’u shndërruar në një instrument shumë më efikas ndërhyrjeje në një kohë të shkurtër në vatra të nxehta. Kjo logjikë ka bërë që në një kohë kur ka shtete të dobëta dhe shumë konflikte të natyrave nga më të ndryshmet, por mbi të gjitha kryesisht etnike dhe fetare, ajo do të dislokojë trupa dhe do të angazhohet seriozisht jo vetëm në Ballkan, por edhe duke e shtuar praninë dhe aktivitetin e në Afganistan, etj.

Nëpërmjet dëshirës për anëtarësimin e Gjeorgjisë në NATO duket se SHBA synojnë një dimension shumë më strategjik

edhe në rajonin e Kaukazit që do të kontribuonte direkt në mbrojtjen e interesave të saj në kuadrin e konkurrencës globale për naftë, gaz si dhe do të sigurojë një prani dhe peshë më të madhe në Lindjen e Mesme. Por, nga ana tjetër ka disa shtete evropiane, mes të cilave spikasin Franca dhe Gjermania, që hezitojnë në shtrirjen e këtyre kufijve. Ministrat e Jashtëm të vendeve të Ballkanit janë sigurisht mjaft të ndërgjegjshëm për këtë debat dhe për këtë realitet, madje edhe për interesat e mëdha gjeostrategjike të shteteve të mëdha. Megjithatë, ata gjithnjë janë shprehur se është e padrejtë që për hir të këtyre interesave dhe politikave kryesisht afatgjatë Ballkani të jetë e të mbetet viktimë. Është fakt konkret se dëshira dhe realiteti sidomos në Ballkan shpesh nuk konvergojnë. Anëtarësimi në NATO nuk do të thotë vetëm anëtarësim ushtarak, por mbi të gjitha edhe konfirmim i sukseseve dhe i stabilizimit të plotë ekonomiko-demokratik.

Por, Ballkani Perëndimor që mund të cilësohet si një sfidë e brendshme e NATO-s, pra zgjerim brenda hapësirave të veta tradicionale, përbën megjithatë vetëm një element të saj. Më konkretisht janë të shumtë vëzhguesit që e kanë ngritur me zë të lartë shqetësimin lidhur me raportet e reja që po vendosen gradualisht midis nevojave të kohës për të dhe aftësive që disponon e vetmja Aleancë ushtarake për të përballuar misione të shumta e tepër sfiduese jashtë “orbitës” së saj të deritanishme të veprimit. Më konkretisht, prania në Afganistan, me rreth 30.000 ushtarë, në një kohë që kërkesat për angazhimet e saj janë gjithnjë në rritje, shtron domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve të reja. Janë të shumtë analistët, por po shtohet me shpejtësi edhe numri i liderëve botërorë, që e mbrojnë me insistim tezën se përgjigjja ndaj këtyre shqetësimeve nuk mund të gjendet te tërheqja nga angazhimet në kontinentin evropian për t’u dislokuar diku gjetkë, por mbi të gjitha dhe kryesisht te shumëfishimi i kapaciteteve të saj njerëzore dhe logjistike.

Kjo është edhe arsyeja themelore se përse drejtuesit e disa prej vendeve anëtare do të bëjnë thirrje në Riga për dialog intensiv me një sërë partnerësh të tjerë të rëndësishëm globalë, çka pritet që të shndërrohet edhe në drejtimin kryesor të zhvillimit të perspektivës së saj afatshkurtër. Më saktë, këtë strategji të re zhvillimi e kanë artikuluar disa prej studiuesve më autoritarë të politikës ndërkombëtare. Për të trajtuar siç duhet sfidat e kohës NATO-ja sipas tyre duhet të zgjerohet

globalisht, pra duke pranuar në radhët e veta shtete sa të fuqishme, aq edhe demokratike, por që janë të gatshme të marrin mbi vete sfida dhe sakrifica të përmasave të konsiderueshme, që nuk do të jenë aspak lokale, dhe aspak në interesin e tyre të ngushtë kombëtar. Ky është një dimension aspak imagjinar, por konkret dhe real.

Deri më tani aftësia e NATO-s për të afruar rreth vetes shtete që kanë vlera dhe interesa të përbashkëta për të përballuar sfida e fenomene globale ka konsistuar vetëm në Evropë dhe Amerikën e Veriut, pra në atë që në histori njihet edhe si boshti historik i Aleancës. Por, ka edhe një numër të konsiderueshem shtetesh të tjera që ndajnë të njëjtat vlera, por që gjeografikisht janë vendosur në pika të tjera të globit, jashtë qendrave të deritanishme tradicionale. Evidentohen mes tyre Australia, Brazili, Japonia, India, Zelanda e Re e Koreja e Jugut. Këto, por edhe vende të tjera, janë plotësisht në gjendje që të kontribuojnë ndjeshëm për “mbijetesën” e NATO-s përballë kërcënimeve dhe sfidave më të mëdha globale. Ato janë plotësisht në gjendje të ofrojnë si trupa të mirëstërvitura, ashtu edhe pajisje nga më modernet ushtarake. Në mbështetje të kësaj teze ofrohet si shembull pjesëmarrja e forcave të këtyre shteteve në një numër misionesh të rëndësishme shumëkombëshe në Ballkan, Afganistan, Timorin Lindor dhe në Irak.

Strategët, por edhe drejtuesit ushtarakë të NATO-s janë mëse të ndërgjegjshëm se kapacitetet e tyre janë “holluar” dukshëm kohët e fundit pas angazhimeve në Irak dhe Afganistan, Sudan, Kongo dhe në pjesë të tjera të kontinentit afrikan. Nuk ka dyshim se anëtarët evropianë të NATO-s nuk do të jenë në gjendje t’i shtojnë trupat e tyre, ndërkohë që kërkesat për angazhimin e saj në vende të përfshira nga krizat dhe konfliktet janë gjithnjë e më të mëdha. Pikërisht, kjo është edhe arsyeja themelore se përse po kërkohen me shumë insistim partnerë të rinj dhe të aftë. Nuk ka dyshim se në rast të shpërthimit të një tjetër konflikti një NATO e zgjeruar me efektiva të gatshëm dhe të përgatitur do të përbënte një risi mjaft të mirëpritur, aq më shumë që jetojmë në një botë dhe në një kohë me shumë andralla.

Nuk ka dyshim se në rast se do të merret në konsideratë një tezë e tillë në Samitin e nëntorit në Rigë, që është edhe i pari pas një periudhe afro dyvjeçare, do të shoqërohet me negociata dhe rrahje intensive idesh dhe pikëpamjesh. Është

fakt i padyshtueshëm se nga fillimi i procesit të ravijëzimit, konturimit dhe formëzimit të saj e deri në momentin e konkretizimit do të duhet kohë e gjatë. Debate sigurisht që do të ketë, madje janë vetë hartuesit e idesë që shprehen se presin kryesisht nga evropianët që ta kundërshtojnë faktin se do t'u duhet të ndërhyjnë për të mbrojtur vende në kontinente të tjera shumë të largëta, për të cilët është e ulët ndjeshmëria e opinionit të tyre të brendshëm. Por, edhe kjo tezë e ka një shpjegim. Ndërhyrjet në Irak, Afganistan, por mbi të gjitha ajo në Kosovë, u bënë pikërisht për të garantuar dhe mbrojtur interesat më themelore të njerëzimit.

Këtë frymë të re e përmbodhi më së miri Kryeministri i Britanisë së Madhe Toni Bler, i cili menjëherë pas ardhjes në pushtet afro dhjetë vjet më parë, duke paralajmëruar një epokë të re në politikën e jashtme e cilësoi atë si “politikë etike të bazuar dhe mbështetur fort mbi dimensionin njerëzor dhe demokratik”. Tashmë shoqëria në përmasa globale është zhvilluar dhe emancipuar në një masë të tillë, sa që nuk mund të qëndrojë më pasive përkundrejt cenimit të rëndë të të drejtave të njeriut dhe parimeve më themelore të tregut të lirë. Bota tashmë është globale dhe mjaft e ndërvarur. Distancat thuhetse nuk kanë më peshë në politikën ndërkombëtare. NATO-ja me apo pa dëshirën e saj tashmë ka dalë përfundimisht nga kuadri i misionit fillestar për të cilin u themelua. Asaj tani do t'i duhet të ballafaqohet dhe të zgjidhë sfida të reja, për të cilat vetë historia sigurisht që do t'i jetë mirënjohëse, pasi do të mbrojë dhe inkurajojë vlerat më të mira të demokracisë dhe zhvillimit.

Franko Egro, MA në Gazetari, Universiteti Westminster, Londër

Kol. Zeno Jahaj

Prirje të luftës moderne: Forca ushtarake më të pakta në numër, më të afta profesionalisht dhe më të mirëstërvitura

Një e vërtetë e përhershme historike

Evërteta tragjike e historisë është se njerëzimi nuk mund të çlirohet nga lufta. Pas çdo mbarim lufte, popujt kanë shpresuar për një paqe të përhershme. Çdo luftë ka krijuar iluzionin se do t'u jepte fund të gjitha luftërave. Traktate e marrëveshje, bisedime e deklarata, konferenca e kongrese, sado autoritare e përfshirëse, nuk kanë mundur gjithsesi t'i japin fund luftës. Ushtritë, armët, askush nuk i ka hequr, sado të ketë zgjatur paqja.

Askush nuk ka hequr dorë nga vëzhgimi apo, shprehur me termin modern, monitorimi i tjetrit. Askush nuk ka hequr dorë nga forca, natyrisht nëse sjellim në vëmendje se në botën moderne, termi “forcë” nuk nënkupton thjesht apo vetëm ushtritë dhe armët. Forca ushtarake është vetëm njëra nga armët midis të shumtave, me instrumentet diplomatike, muskujt ekonomikë, peshën politike dhe aftësitë informative, krahas dhe në udhëheqje të saj. Lufta, sado forma të tjera të marrë, në fund të fundit është dhe do të mbetet akt i përdorimit të forcës ose akt i kërcënimit për të përdorur forcën. Luftimi dhe përdorimi i forcës pa diplomaci s'është veçse vrasje. Porse diplomacia pa forcën, pa armët apo vullnetin për t'i përdorur ato, është si muzikë pa vegla.

Sot, forcave ushtarake u janë shtuar misione të reja, kurse misionëve të vjetra u kërkohet t'i kryejnë në forma të reja. Gjithsesi, detyrat themelore të forcave të armatosura të të gjitha vendeve mbeten ruajtja e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit, ose akoma më gjerë, ruajtja e qytetarëve dhe interesave të veta; pjesëmarrja në misione ndërkombëtare

paqeruajtëse apo paqembështetëse, lehtësimit i popullatës nga fatkeqësitë; kryerje detyrash në funksion të sigurisë së brendshme në ndihmë të autoriteteve përkatëse për rivendosje e përforsim rendi e ligji si dhe kontribute në të mirë të rritjes së vlerave kombëtare e sociale. Misioni tradicional i ushtrive në të gjitha vendet mbetet mbrojtja e vendit të vet ose e vendeve aleate kundër një sulmi të mundshëm ushtarak.

Popujt mund të mos jenë të interesuar për luftën, por lufta është e interesuar për ta. Sepse njerëzimi është dhe do të vijojë të mbetet i kërcënuar nga rreziqe ekonomike (varfëria, shpërndarja e skajshme e pasurive dhe e vlerave), nga rivalitetet e konfliktet ndërshtetërore, nga përdorimi i dhunës brenda vendeve, e cila, në rastin më të keq, merr trajtat e luftës civile, shthurja e shtetit, gjenocidi, armët e dëmtimit në masë, terrorizmi, krimi i organizuar ndërshtetëror, etj.

Llogaritjet tregojnë se parandalimi i këtyre rreziqeve është më pak i kushtueshëm sesa kundërveprimi ndaj tyre. Instrumentet më të frytshme për të realizuar këto misione janë shtetet e afta që ushtrojnë në mënyrë të përgjegjshme sovranitetin e tyre, që i administrojnë rreziqet përpara se këto rreziqe të kërcënojnë të tjerët.

Kombet dhe shtetet do të vijojnë të mbajnë dhe të përdorin forcat e tyre të armatosura për të kryer e për të fituar në luftëra vendimtare, për të ruajtur dhe për të përhapur paqen. Tragjikisht, por në mënyrë të paevitueshme, lufta do të vijojë të mbetet një industri në rritje. Ekonomitë e përparuara, udhëheqjet politike demokratike, vlerat demokratike dhe standardet e larta të jetesës do të vijojnë të mbeten të kërcënuara. Nga ana tjetër, koncepti i sigurisë në botën moderne perceptohet edhe si koncept i rritjes së influencës, fuqisë e pasurisë, krijim dhe mbrojtje interesash, ruajtje e përhapje vlerash kombëtare.

Lufta është shkencë, por në thelbin e saj është dhe do të mbetet art. Siç dihet, arti kërkon ndjenjë dhe emocion. Asnjë luftë, veçanërisht lufta e gjatë, nuk është fituar pa kurajën, sakrificën, shërbimin, besnikërinë dhe vendosmërinë e njeriut, luftëtarit, komandantit apo burrit të shtetit. Lufta ka qenë dhe do të vijojë të mbetet përplasje vullnetesh.

E papritura mbetet konstante e luftës. Kundërshtari, sado i dobët, madje pikërisht pse është i tillë, do të përpiqet dhe do të gjejë rrugët, mjetet, format dhe metodat që dobësinë ta kthejë në forcë, të njohurën ta bëjë të panjohur dhe të panjohurën, të njohur.

Flitet se karakteristikë e luftës së sotme është luftimi asimetrik. Por nuk mund të harrojmë që asimetria është formë e përjetshme e luftës, është rugëzgjdhja e më të dobët për të fituar ndaj më të fortit. Janë vetëm mjetet me të cilat ushtrohet sot asimetria, të cilat sigurisht që kanë ndryshuar.

Çdo luftë që fillohet, mendohet se do të jetë ndryshe, porse sapo ajo fillon, fillojnë të vihen në veprim edhe ligjet e brendshme që e drejtojnë atë. Duke vëzhguar me vëmendje, qoftë edhe luftërat apo konfliktet më të fundit, nuk mund të mos "lexojmë", p.sh. se askush nuk ka hequr dorë nga përqendrimi i forcës, porse është modifikuar si "përqendrim i përpjekjeve". Nuk duket, veçse përshtatje e natyrshme me karakteristikat e luftës moderne, përparësia e paraveprimit ndaj kundërveprimit (proaction vis-à-vis reaction), shprehje kjo, në thelb, e raportit tradicional midis veprimit mësymës dhe atij mbrojtës.

Natyra e problemit

Burimet dhe tipat e konflikteve janë bërë më të larmishëm dhe më të paparashikueshëm. Bota është përpara sfidave të jashtëzakonshme, po aq, edhe përpara ndërvartësive të jashtëzakonshme. Siguria globale sot nuk është më pronë apo fushë veprimi e 200 e ca aktorëve (shteteve sovranë), të cilët kanë të drejtën për të mbajtur e përdorur forcën ushtarake. Sot, aktorët e sigurisë (apo të pasigurisë) globale janë me mijëra. Këta nuk njohin kufij shtetërorë, priren për ta transferuar konfliktin në shtete apo hapësira të tjera ajrore e detare. Kjo, me sa duket, do të jetë matematika e sigurisë (apo e pasigurisë) që do të përshkojë shekullin XXI.

Forca do të vijojë të mbetet dimension edhe i luftës moderne, porse përdoruesit e saj, për shkak të presioneve të gjithanshme, do të duhet fillimisht të pyesin veten: A është kërcënimi aq serioz sa të justifikojë, të paktën mjaftueshmërisht, përdorimin e forcës? A janë konsumuar të gjitha opsionet e tjera jo ushtarake? A është forca përpjestimore me qëllimin e ndalimit apo të mënjanimit të rrezikut? A jemi të sigurtë se rrjedhimet e veprimit nuk do të jenë më të këqija se rrjedhimet e mosveprimit? Në konfliktet e sotme duket se është megjulluar dallimi midis përbërësve taktikë, operativë, strategjikë dhe politikë të luftës. Nganjëherë, edhe ngjarje të

parëndësishme taktike mund të sjellin grushte të rënda politike. Kjo është veçanërisht e ndjeshme në sistemet demokratike, ku p.sh. humbjet njerëzore janë të pafalshme. Duket se, nëse ndërhyrja ushtarake është e domosdoshme, përfundimi i saj pa humbje do të jetë një standard, në bazë të të cilit do të maten operacionet e ardhshme. Përhapja dhe shtytja përpara e vlerave dhe e institucioneve demokratike në botë duket se e favorizon këtë prirje. (Le të kujtojmë se në vitin 1975, vetëm një e treta e vendeve të botës bënë zgjedhje demokratike, ndërsa sot, ky tregues është dy të tretat, me prirjen për rritje të mëtejshme).

Lufta moderne është nën kontroll të rreptë politik. Në këtë kuptim do të mund të lexohej shprehja e famshme se “Lufta është tejet e rëndësishme për t’u lënë në dorë të gjeneralëve”. Ngjarjet e sotme rrjedhin nga diplomacia e përkrahur nga diskutimet për kërcënim, drejt diplomacisë së përkrahur me kërcënim, duke synuar diplomacinë e përkrahur me forcë dhe, vetëm si gurin e fundit, forcën e përkrahur me diplomaci. Është domethënës fakti që, nëpërmjet negocimit, më shumë luftërave u janë dhënë fund nga viti 1980 deri më sot, sesa në 200 vjetët përpara këtij viti.

Teknologjia e luftës ka ndryshuar në progresion gjeometrik në krahasim me taktikat, strategjitë, doktrinën dhe organizimin e forcave të armatosura. Është rritur forca dhe largësia vrasëse e armëve. Satelitët janë bërë pjesë e pandarë e zhvillimit të luftimit. Mjetet ajrore të zbulimit pa pilot janë sot aq të shumta në numër e në lloje, saqë mund të thuhet se ato përbëjnë një flotë të tërë ajrore që i ka shtrirë funksionet e saj deri në shkallë nënreparti. Të gjitha këto kanë çuar në prirjen për t’i pakësuar forcat njerëzore dhe për t’i profesionalizuar ushtritë.

Për mbi një gjysmë shekulli bota ishte ndeshur me dy dimensione të luftës, atë konvencional dhe bërthamor. Sot, në këtë ekuacion është shtuar edhe një dimension i tretë i luftës: terrorizmi. *Parimisht terrorizmi nuk është kërcënim i ri. E re është përhapja, shkalla dhe intensiteti i tij.* Ndërsa në të kaluarën, nëpërmjet terrorizmit janë zgjidhur detyra kryesisht të niveleve taktike, sot terrorizmi ndërkombëtar zgjidh detyra strategjike. Përballimi i këtij dimension i ri strategjik të luftës, kërkon një mënyrë të re të menduarit, teknologji të reja dhe organizim të ri.

Terrorizmi është asimetrik në mjete, asimetrik në motivim. Po jetojmë fazat e para të një tranzicioni të madh gjeopolitik.

Kemi një kapërcim nga trajtat lokale të luftës në trajta globale konfliktesh, ku ndarja midis luftëtarit të ligjshëm, kriminelit dhe qytetarit është megjulluar aq shumë, saqë është vështirë të dallohet. Duket se konflikti i së ardhmes do të jetë më së shumti një gërshetim apo një përzierje e njëkohshme e luftimit tradicional me operacionet në mbështetje apo ruajtje të paqes. E ardhmja, e cila tashmë ka trokitur, po tregon se për të përballuar këto sfida, në vend të një ushtrie masive, do të na duhet dhe do të jetë më e frytshme një ushtri e vogël, profesionalisht e aftë dhe e mirëstërvitur.

Tipare të reja, kërkesa të reja

Në luftën moderne forcave do t'u duhet të jenë shumë më të stërvitura sesa në kushtet e përhapjes së mëparshme. Veprimet e sotme luftarake janë më të ekspozuara ndaj pasigurive se në të kaluarën. *Natyrisht, edhe në Luftën e Ftohtë, pasiguritë dhe të papriturat ishin të pranishme, por gjithsesi ato ishin përjashtim, kurse sot janë rregull.* Në këtë botë globale, kundërshtarët do t'i përdorin forcat dhe mjetet në zona ku është e pamundur ose e vështirë të depërtohet. Në këto kushte edhe sigurimi i informacionit do të bëhet më i vështirë.

Në luftën tradicionale, por në një shkallë më të lartë në luftën moderne, kryerja e veprimeve luftarake apo përmbushja e misioneve do të jenë, si rregull, produkt shumëpalësh, duke patur në mbështetje apo në krah aleatë të natyrshëm, ku fitorja e ideve do të udhëheqë fitoret ushtarake. Ushtarakut do t'i duhet të jetë i vendosur për misionin që kryen duke qenë i bindur se ai është në interes të vendit të vet, të popullit të vet, edhe në lloje të tilla misionesh gjeografikisht të largëta. Është e qartë tashmë, porse ka vend për më shumë ndërjegjësim, se në grupin e interesave tona vitale, (sikurse është e natyrshme jo vetëm për ne, por edhe për shtete e vende shumë më të mëdha e më të fuqishme se ne), bëjnë pjesë edhe besnikëria dhe kontributet ndaj aleancave dhe koalicioneve demokratike. Le të kujtojmë se ndoshta jo të gjithë vendet kontribuese në zgjidhjen e konfliktit të Kosovës kishin interesa vitale, por ata u përgatitën, erdhën dhe kryen misione duke rrezikuar edhe me humbje njerëzore.

Kjo kërkon edukimin e qëndrueshmërisë. Operacionet e sotme luftarake mund të mbarojnë shpejt në kohë, por

vendosja, mbajtja, forcimi dhe përparimi i paqes janë e do të jenë, si rregull, procese afatgjata, e shpesh, madje edhe më të ekspozuara ndaj rreziqeve për jetën. Ushtaraku sot duhet të mësohet të jetë më i frytshëm dhe të mbijetojë, të krijojë situata ndaj kundërshtarit dhe jo të presë që vetëm të reagojë ndaj tyre. Ndaj një kundërshtari që përshtatet shpejt, që përdor taktika dhe mjete të reja, duhet të jesh paraprakisht i stërvitur dhe shumë më i përshtatshëm.

Në luftën moderne nuk mund të përcaktohen drejtime fikse, siç tradicionalisht jemi mësuar t'i ndajmë në kryesore apo ndihmuese. Ndërrimi i vlerave të drejtimeve, që në kohën e Luftës së Ftohtë ishte më së shumti përjashtim, në luftën e sotme është rregull. Në këto kushte, nënrepartit apo repartit i duhet të jetë i përgatitur për të vepruar në të gjitha situatat. Në kohën e sotme nuk ka më prapavijë dhe front, nuk ka konvoje apo garnizone të sigurta. Ushtarët janë më së shumti luftëtarë sesa specialistë, sepse kushdo është i rrezikuar në të njëjtën masë, në çfarëdolloj vendi e shërbimi.

Sot, ushtarit mund t'i takojë të hyjë në veprime luftarake brenda javësh apo muajsh nga fillimi i stërvitjes së tij dhe, ndoshta, në një terren krejt të panjohur. Për këtë arsye, stërvitja duhet të jetë realiste, të zhvillohet në kushtet e rreziqeve dhe të kufizimeve që dikton luftimi i sotëm.

Një edukatë e tërë juridike, e pakconceptuar dy-tre dhjetëvjeçarë më parë, duhet t'i jepet ushtarit të sotëm. Personeli i forcave të armatosura duhet të njohë dhe të edukohet të zbatojë me rreptësi parimet e ligjshmërisë, demokracisë, të asnjësisë, të respektit të të drejtave dhe ligjeve ndërkombëtare humanitare. Ai duhet të dijë se fakti që është i armatosur, nuk i jep absolutisht të drejtën për t'i shkelur ato. Përkundrazi, ai është përgjegjës në rast se i shkel ato. Ata duhet të edukohen me ndjenjën e detyrës në atë shkallë, sa të jenë në gjendje të bëjnë analizë dhe të mbajnë qëndrim ndaj veprimeve që janë në kundërshtim me normat dhe të drejtat ndërkombëtare humanitare.

Në këtë kontekst, ata duhet të njohin shumë mirë dhe të zbatojnë Rregullat e Angazhimit gjatë misionëve jashtë vendit, me fjalë të tjera çfarë dhe në ç'masë u lejohet dhe çfarë dhe në ç'masë nuk u lejohet. Rrethana të caktuara mund të sjellin që ushtarit do t'i duhet të vendosë vetë se në ç'masë p.sh., do të duhet të përdorë forcën apo mjetin e forcës, duke mos rrezikuar apo duke mbrojtur njëherësh jetën e vet. Zgjidhja e

një konfrontimi do të duhet të arrihet duke përdorur një forcë të balancuar me mjetet dhe format e tjera negociuese. Përdorimi i armës apo i forcës do të duhet të lidhet edhe me nevojën e vetëmbrojtjes, me nevojën e mbrojtjes së nënrepartit të vet apo të ushtarit të nënrepartit aleat si dhe të qytetarëve të pafajshëm.

Koha kërkon një kulturë të re të stërvitjes dhe të përdorimit luftarak të nënreparteve. Dimensionet e konceptit të stërvitjes kolektive burojnë nga dimensionet që ka marrë vetë lufta dhe veprimet luftarake moderne. Sot, veprimet luftarake dhe, në tërësi përdorimi i forcës ushtarake, është gërshetim armësh e shërbimesh, i bashkërenduar me faktorë të tjerë joluftarakë, si dhe i ndërveprueshëm me aleatët apo koalicionin përkrah. Pikërisht, ky përbën edhe kuadrin e stërvitjes kolektive. Nënrepartit mund t'i takojë të transportohet, të veprojë apo kryejë operacione në bashkëmbështetje me helikopterin apo anijen dhe kjo do të thotë se këto mjete duhen njohur, duhen mësuar si të mbrohesh në to apo t'i mbrosh në një rast ekstrem. Nënreparteve do t'u duhet të bashkërendojnë me organizma ndërkombëtare, rajonale, qeveritare, joqeveritare dhe të sektorit privat si dhe me misione humanitare, diplomatike, mediatike, parlamentare, etj., në funksion të zgjidhjes sa më të frytshme të situatës që krijohet. Në këto kushte, suksesi do të varet së tepërmi nga aftësia e këtyre organizmave dhe misioneve për të plotësuar njëra-tjetrën, për të bashkëvepruar dhe bashkërenduar veprimtaritë. Krahas besimit, nënrepartit do t'i duhet t'i njohë këto organizma apo misione, të njohë mundësisht gjuhën e tyre, procedurat e tyre dhe të krijojë ndërveprueshmërinë më të frytshme në të mirë të synimit apo objektivit të caktuar.

Një forcë e armatosur dhe e aftë profesionalisht

Ushtria është profesion, profesioni i armëve. Shumë vende të botës vijojnë të përdorin sistemin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Një nga arsytet është se ata e shohin këtë çështje si element të demokracisë dhe të kulturës kombëtare. Nga ana tjetër, nëpërmjet shërbimit ushtarak i riu përfiton vlera shtesë të edukimit atdhetar, kulturor, shëndetësor, sportiv, etj. Nëpërmjet këtij shërbimi, i riu ndërgjegjësohet më shumë për përgjegjësinë ndaj detyrimeve ligjore, siç janë detyrimet e

shërbimit ushtarak. Aq më të ndjeshme bëhen këto vlera kur shërbimi ushtarak të lidh me kultura të vendeve të tjera.

Gjithsesi, nevojat e luftës moderne, kanë filluar ta vënë në pikëpyetje traditën e shërbimit ushtarak aktiv. Ka vende që tashmë e kanë hequr fare. Përmendim Francën, e cila, edhe pse është vendi që në historinë moderne “e shpiku” shërbimin ushtarak aktiv, në vitin 2001 e hoqi fare atë. Duket se ka ikur koha e ushtrive masive. Gjithnjë e më shumë vende po kalojnë në heqjen e këtij detyrimi, duke i zëvendësuar ato me forca plotësisht vullnetare, më të vogla në numër, të pajisura me teknike të kohës dhe të lëvizshme.

Në këto dy-tre dhjetëvjetëshat e fundit, forcat e armatosura të shumë vendeve janë pakësuar, kështu që edhe nevojat për thithjen e ushtarëve rekrutë, janë bërë më të pakta. Forcat e armatosura po priren për nga profesionalizmi dhe varësia nga teknologjia moderne. Në këto kushte, del e nevojshme që stërvitja të jetë më e gjatë në kohë, për t'i aftësuar ushtarët profesionistë në përdorimin e armëve dhe të sistemeve komplekse të armatimeve moderne. Por afatet e shërbimit të detyrueshëm janë relativisht të shkurtra, kohë kjo e pamjaftueshme për t'u familjarizuar me këto sisteme. Ndër të tjera, edhe për këtë arsye, ushtritë priren gjithnjë e më shumë për nga ushtritë vullnetare profesioniste. Evoluimi i misioneve brenda vendit, por veçanërisht përfshirja gjithnjë e më shumë në misione paqeruajtëse, kërkon jo vetëm shprehi e njohuri thjesht ushtarake, taktike apo teknike, porse veçanërisht aftësi negociuese, më të kërkuara këto për kushtet relativisht afatgjata paskonfliktuale, siç është edhe rasti në Irak.

Kalimi në ushtritë profesioniste nuk do të thotë përjashtimisht edhe profesionalizëm në çështje ushtarake. Profesionalizmi është shkolla dhe përvoja, shkenca dhe arti, madje më shumë arti sesa shkenca. Drejtimi dhe veprimi luftarak, veçanërisht në kushtet tepër komplekse të luftimit të sotëm, lypin intuitë, krijimtari, aftësi perceptuese dhe analizuese. Në luftimin e sotëm paqartësia është më akute se në luftimet tradicionale. Asimetria e rrit atë. Pikërisht në kushte të tilla, drejtuesit apo ushtarit do t'i duhet të përcaktojë zgjidhje e të marrë shpejt vendimin më të frytshëm.

Forcat tona të armatosura, sot, dhe për një të ardhme ndoshta afatmesme, janë dhe do të jenë një forcë relativisht e vogël ku pjesën dërrmuese të tyre do ta përbëjnë forcat tokësore, kryesisht trupa këmbësorie, të ndërhyrjes së shpejtë,

komando, etj. Për kushtet tona, kjo është zgjidhja jonë më e mirë dhe ndërkohë edhe avantazhi ynë më i madh. Sado e sofistikuar të bëhet lufta nga pikëpamja teknologjike, në fund të fundit, ajo bëhet për të kontrolluar njerëzit, popullin. Municionet precize, fuqia ajrore dhe ajo e hapësirës, teknologjia e informacionit, etj., janë elemente të zgjidhjes, por jo e tërë zgjidhja. Për të kontrolluar njerëzit, popullin në terren, duhet këmbësoria.

Sapo është arritur mbizotërimi ushtarak dhe sapo fitorja është përforcuar me këmbësori, ajo duhet të ruhet përmes aftësive integrale të forcave, të shërbimeve ushtarake, civile, gjyqësore, diplomatike, të zbulimit, të policisë, etj. Kur vjen puna që të na kërkohet të kontribuojmë në menaxhimin e situatave të larmishme që krijojnë konfliktet e botës moderne, përdorimi i frytshëm i njerëzve dhe i aftësive njerëzore janë një shumëfishator më i fuqishëm se teknologjia.

Në bashkëveprim dhe bashkërendim funksional me të gjithë instrumentet e tjerë të fuqisë kombëtare dhe me llojet e tjera të forcave e të shërbimeve, nëpërmjet këmbësisë dhe, veçanërisht të trupave të specializuara të saj, kemi mundësitë jo vetëm të kryejmë me përgjegjësi funksionet në misionet e rëndësishme tradicionale, por edhe ato që lidhen me detyrimet ndaj aleancave apo koalicioneve demokratike. Janë pikërisht forcat e gjalla njerëzore, ushtarët profesionistë dhe aktivë, nënoficerët dhe oficerët, të cilët i kemi mundësitë t'i profesionalizojmë në ato standarde dhe t'u japim ato kualitete, për të cilat mund të bëhemi mbështetje dhe jo barrë e të tjerëve. Kështu do të duhet ta parashikojmë të ardhmen dhe rruga më e mirë për ta parashikuar është ndërtimi qysh sot i saj.

Alban Bala

Drejtor ekzekutiv i Institutit Shqiptar të Marrëdhënieve Publike

Menaxhimi i informacionit shtetëror si rrugë e përafrimit me NATO-n

Deklarata e fundit e kryeministrit Sali Berisha për të përgatitur trupa të reja speciale ushtarake, që do të përfshihen përkrah trupave italiane në operacionet ndërkombëtare paqeruajtëse në Liban, dëshmon pa asnjë lloj dileme se qeveria shqiptare është e vendosur të paguajë çdo çmim për të arritur të bindë partnerët ndërkombëtarë, të cilët duket qartazi se ende hezitojnë për ta ftuar ish-vendin më të izoluar komunist të marrë ulësen e anëtarit në Aleancën Evro-Atlantike, NATO-n.

Nga ana e saj, qeveria beson se kjo anëtarësi do të prodhojë efektet e pritshme politike të besueshmërisë dhe stabilitetit, efekte që përkthehen në volume investimesh të huaja direkte dhe në një nivel të ri marrëdhëniesh ndërkombëtare për vendin e vogël me probleme të mëdha në jug të Ballkanit. Qeveria më së paku beson se ky hap do të ishte një shtysë e rëndësishme për përshpejtimin e procesit të integritit të vendit në BE, edhe pse ky proces vuan një seri premisash të tjera frenuese, që gjenerohen shumë larg handikapeve politike lokale apo vendimmarrjes optimiste shqiptare.

Në këtë drejtim ka synuar edhe përfshirja në stafin e këshilltarëve të kryeministrit Berisha të ish-sekretarit amerikan për sigurinë kombëtare, Tom Ridge, prezenca e të cilit shpresohet se do të forconte lidhjet direkte të administratës shqiptare me Shtëpinë e Bardhë dhe sidomos me Pentagonin, për të garantuar një mbështetje të rëndësishme në dilemën ndërkombëtare nëse Shqipëria meriton të ftohet për anëtarësi të plotë në NATO.

Çdo sukses, sado minimal në këtë drejtim është politikisht i rëndësishëm për qeverinë, e cila mishëron në këtë lëvizje një prirje publike, e cila e mbështet anëtarësinë e plotë në NATO në masën mbi 99% dhe e sheh këtë ngjarje si një hop shumë

të madh cilësor të vendit drejt riintegritit të plotë në strukturat evro-perëndimore dhe atlantike. Në shprehje të kësaj, Shqipëria gëzon prej vitesh një konsensus të gjerë politik në lidhje me integrimin e plotë në strukturat evro-atlantike.

Investimi i deritashëm i administratave shqiptare ka qenë për të përafuar anëtarësinë e vendit në NATO, kryesisht ushtarak, duke anashkaluar parametra të tjera të rëndësishme, ku ndër pikat kyçe mbetet qarkullimi i informacionit dhe besueshmëria në prodhimin dhe përpunimin e tij.

Edhe pse në komunikimin me vendet anëtare NATO-ja mbështetet mbi struktura të specializuara dhe informacione të karakterit “të klasifikuar”, është e domosdoshme që infrastrukturën, që garantojnë si produkt të fundit konsensusin publik dhe politik, përfshirjen publike në qeverisje, ndarjen më të mirë të vendimmarrjes politike nga ajo teknike, efektivizimin e administratave, etj., të gëzojnë një zhvillim të qenësishëm, si edhe të ofrojnë garanci për sigurinë e informacionit të klasifikuar që do t’i dedikohet më pas partnerëve strategjikë të Aleancës.

Thuajse të gjitha palët politike e kanë pranuar tashmë domosdoshmërinë që shteti shqiptar të ketë një seri databazash të ndërlidhura teknologjiksht (lehtësisht të konfigurueshme sot), ku përmes një serie RDBM-sh (relational database systems) të arrihet që për çdo qytetar të regjistruar në Regjistrin Civil të Popullsisë, ku figurojnë gjeneralitetet, fotoja e tij dhe të dhënat zyrtare të identitetit (numri i ID-së dhe numri i Sigurimit Shoqëror) të ndërlidhet harta e pronësive të tij të paluajtshme, të ndërlidhet dosja e tij civile që ekziston për të në Ministrinë e Drejtësisë apo në arkivin e gjykatave, dosje hetimore nga arkivi i prokurorisë, pavarësisht nivelit të përpunimit, dosja penale, nëse ai ka të tillë, pjesë e arkivit të Ministrisë së Brendshme, të ndërlidhet çdo e dhënë tjetër, që përmes një sistemi të klasifikuar të shfletimit të bazës së të dhënave (classified access), çka realizohet lehtë me shkallëzimin e fjalës-hyrëse në sistem, u jep mundësinë organeve kompetente dhe organizatave ndërkombëtare të sigurisë, siç është NATO-ja, të kenë akses në kohë reale mbi çdo qytetar shqiptar, sipërmarrje apo veprimtari që përbën subjekt të punës së tyre.

Ky sistem, për segmente informative që përbëjnë *domain* publik, mund të vihet plotësisht në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe mediave, karshi një pagese. Ky shërbim publik

sot në SHBA dhe shumë vende të tjera të përparuara është i arritshëm në njësitë e pushtetit vendor.

Në Shqipëri, interesi për këtë *upgrade* të sistemeve të menaxhimit të informacionit shtetëror ka kohë që është shprehur. Por shpejtësia e lëvizjes mbetet ende zhgënjyese.

Disa vjet më herët, nga pozitat e kryeministrit, Pandeli Majko - aktualisht sekretar i përgjithshëm i socialistëve në opozitë, - nismoi një projekt të mbiquajtur "E-Government", me synim ndërtimin e një sistemi tërësor të qarkullimit të informacionit, në përputhje me standardet e larta të informatizimit shtetëror, gjë që në vendet evropiane ka kohë që ka hyrë në procesin e shfrytëzimit.

Në këtë kuadër qeveritë socialiste prej vitit 2001 e në vijim gjeneruan fonde të bollshme për të mbështetur procesin e pajisjes me kompjutera të administratës shqiptare, sidomos në qendër, e cila në fund të vitit 2004 figuronte më e kompletuara me sisteme të IT-së nga vendet ish-komuniste të Evropës Qendrore. Në vitin 2005, administrata qendrore shqiptare kishte një penetrueshmëri të internetit në masën 95%, duke kryesuar listat rajonale të vendeve ish-komuniste. Ky përparim, në fakt, shënohej kur në Shqipëri popullata në masë të gjerë gëzonte jo më shumë se 1% penetrim të internetit dhe kryesisht për motive komunikimi "djaloshar".

Ajo që në fakt ndodhi në mjedisin tejet të korruptuar zyrtar shqiptar mund të quhej me pak fjalë "abuzim me fondet e pamjaftueshme". Kështu, përpara se entet dhe njësitë shtetërore shqiptare të identifikonin nevojat e tyre, përpara se të bënin një studim tërësor mbi atë që duhej të realizohej nga procesi, në emër të pastrimit të administratës nga praktika e përdorimit të makinave të shkrimit, shumica e parave shkuan për blerje hardware-i, duke ndërtuar një sistem tashmë shumë të vështirë për t'u riintegruar në një nivel të ri dhe të menduar komunikimi teknologjik. Procesi më shumë i shërbeu realizimit të tenderave të rëndësishëm për blerje kompjuterash dhe tek-tuk ndonjë serveri, që duhej të mbështeste ngushtësisht teknologjinë e përhapjes së internetit nga një zyrë te tjetra.

Në shumë ministri dhe agjenci shtetërore u ndërmorën procese të ndërtimit të rrjeteve, në disa raste me mënyrat dhe mjetet më primitive. Në të paktën një ministri, ku autori ka pasur rastin të përpunojë një strategji për ristrukturimin e sistemeve të qarkullimit të informacionit, ka gjetur nëpër mure kablo bakri apo teknika të tjera ndërlidhjeje jo profesionale në

vend të fibrave optike, duke rritur shumë kostot e rindërtimit të rrjeteve të reja me opsionalitete bashkëkohore të komunikimit.

Shqipëria ka sot një administratë, e cila për shkak të dizintegrimit të të dhënave që prodhon apo përpunon mund të quhet e prapambetur. Shumica e treguesve që analizohen edhe nga institucione të specializuara të përpunimit të të dhënave merren me shumë rezervë dhe jo rrallë institucione të ndryshme kanë deklaruar gjetje thelbësisht kontradiktore.

Ashtu siç është informal në formatin e organizimit të tij ekonomik, po ashtu vendi ende sot është në një situatë të mjerueshme përballë sistemeve me të cilat menaxhon proceset kryesore të politikëbërjes dhe planifikimit. Partnerët ndërkombëtare shpesh mjaftohen me përrshkrime ironike, si p.sh. “Shqipëria është një vend ku dihet saktësisht numri i lopëve dhe viçave, por nuk dihet aspak numri real i popullsisë, aq më pak vendndodhja e tyre”. Në fakt, vetëm me procesin e fundit të legalizimeve për zonat informale përreth qyteteve kryesore, qeveria ka nisur një proces të regjistrimit të këtyre banorëve dhe të pronave të zaptuara prej tyre.

Një projekt i nisur qysh në vitin 1994 për dixhitalizimin e hartave të tokës bujqësore pritet të marrë një shtysë të besueshme dhe të kompletohet në rrafsh nacional nga një kredi e Bankës Botërore prej 40 milion dollarësh. Një projekt suedez është në proces të realizimit të fazës pilot të regjistrimit të popullsisë së vendit në disa qytete kryesore sipas një baze të dhënash të Regjistrimit Civil të Popullsisë. Ndërkaq, paralel me këtë proces, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka nisur prej një viti regjistrimin e “klientëve” të vet, duke hedhur në sistem deri tani vetëm 10% të një popullate që fillon në moshën 16-vjeçare dhe mbaron me moshat e treta përfituese.

Gjatë viteve 2000 - 2004 disa herë bashkësia ndërkombëtare ka dashur të realizojë së paku regjistrin e votuesve, duke dështuar një herë për shkak të grykësisë së Ministrisë së Pushtetit Vendor, një herë për shkak të politizimit të skajshëm të debatit politik dhe mosmarrëveshjeve të thella mes pushteteve vendore e qendrore në Shqipëri, por gjithnjë për shkak të mungesës së një vullneti pozitiv politik në realizimin e një procesi të besueshëm regjistrimi. Projekti i financuar nga SIDA shpreson që ky hap do të përmbushet me sukses vetëm për zgjedhjet e vitit 2009.

Megjithatë, projekti qeveritar i informatizimit të sistemit shtetëror të komunikimit ka bërë ndërkohë disa hapa

përpara. Një kompani e specializuar evropiane është në fazën përmbyllëse të studimit të plotë dhe realizimit të serverit qeveritar, i cili do të ndërlihet përmes ndërfaqesh specifike me serverat ministrore apo të agjencive të tjera shtetërore.

Në një hap më të vonuar është aktualisht procesi i ndërtimit të arkivave institucionale që përbëjnë edhe bazën dokumentare. Aktualisht Instituti i Sigurimeve Shoqërore në Tiranë disponon një sistem pajisjesh të posaçme për arkivim të ftohtë dixhital (cold archive) me vlerë rreth 1.6 milion dollarë, prokuruar nga administrata e mëparshme drejtuese e këtij institucioni. Sigurisht, fillimi masiv i procesit të arkivimit kërkon ndërtimin e bazës së të dhënave nëpër ministri dhe agjencitë shtetërore në përputhje me strukturën e re dokumentare, sistemet e reja të integruara (internet - intranet - extranet) për qarkullimin e informacionit.

Këto sisteme, sipas praktikave të mëparshme të zbatuara nga Instituti Shqiptar i Marrëdhënieve Publike, duhet të garantojnë një nivel të ri transparence për publikun, krijimin e pikave të reja të aksesit për informacion nga të gjitha palët e interesuara shtetërore ose private, siguri mbi dokumentet e prodhuara (digital signature) dhe arkivim në kohë reale të të gjithë dokumentacionit që prodhohet në nivel sipëror nga drejtoritë e këtyre institucioneve. Këto sisteme garantojnë një rritje të jashtëzakonshme të efektivitetit të punës nga administrata, një ndarje online të detyrave dhe një mbikëqyrje po kaq efikase të realizimit të tyre, një përgjigje shumë më të shpejtë dhe larg burokracisë për problemet e hasura dhe të trajtuara nga administrata, por pikësëpari këto sisteme garantojnë një nivel të ri të ndarjes së përgjegjësive dhe kompetencave, duke qartësuar rolin e çdo hallke dhe duke mirëadministruar funksionin, kapacitetet dhe detyrimet e secilit zyrtar në pozicionin e tij institucional.

Network-u i brendshëm teknik është sot për institucionet shqiptare një domosdoshmëri për modernizimin në sistem të krejt punës së tyre, të perceptimit publik të këtyre institucioneve, por edhe të vetëperceptimit që prodhojnë dhe vuajnë shpesh punonjësit e tyre. Ndërtimi i këtij *network-u* teknik jep mundësinë që të materializohet më së fundi edhe vullneti i shprehur politik i qeverisë për të deleguar çështjet dhe për të ndërtuar një ndarje të qartë mes asaj që është vendimarrje politike nga vendimarrja teknike. Përmes sistemeve të

integruara të shkëmbimit të informacionit dhe implementimit në praktikë të *network*-ut teknik në institucione merr fund njëherë e përgjithmonë monopoli që ekziston ende sot për vendime të caktuara teknike. Heqja e këtij monopoli me orientim të theksuar politik është rruga e vetme për të zhvendosur rrafshin e vendimmarrjes politike drejt hapësirave që duhet të gëzojnë në administratë nivelet teknike dhe ato konsultative profesionale.

Vetëm një qasje e tillë e mendjes së hapur drejt një menaxhimi të ri të burimeve të informacionit dhe produkteve të tij, mund të fillojë të krijojë në Shqipëri shanset e nevojshme për ndërtimin e kulturës së punës në gjirin e administratës së plasaritur shqiptare, e cila është e gjymtë në pikëpamjen e përgatitjes dhe formimit profesional. Në rrafshin politik ajo është nën një trysni të lexueshme dhe shpesh në ngërç, ndërsa vuan qartazi mungesa në hapësirat vendimmarrëse për çështje teknike që i përkasin vetëm asaj.

Edhe pse nën një mantel të theksuar teknik, riformatimi i ciklit të menaxhimit të informacionit dhe skemës së qarkullimit të tij do të mundësojë që politikisht në Shqipëri administrata të qartësojë turbullirën që rëndon sot mbi ndarjen e peshës së vendimmarrjes teknike dhe asaj politike. Ky kufi sot në Shqipëri është shumë i paqartë. Në fund të fundit këto kosto dhe pasoja nuk i vuan vetëm ajo armatë anonime që popullon zyrat e shtetit. Këto kosto bien direkt mbi taksapaguesit shqiptarë dhe në tërësi mbi proceset e zhvillimit dhe integritimit të vendit në struktura gjithnjë e më të largëta me realitetet e vonuara shqiptare.

Është e nevojshme që sistemet e raportimit dhe marrjes së informacionit të bëhen më të shpejta, të gatshme për të pritur dhe shpërndarë automatikisht të dhëna dhe detyra, që shpesh vendit i vijnë edhe nga strukturat ndërkombëtare.

Nga një takim në Bruksel, në zyrat e Bashkimit Evropian apo NATO-s, një zyrtar maqedonas, letonez apo estonez është sot në gjendje që shënimet e takimit t'ia përcjellë në kohë reale të gjitha zyrrave të ndërlidhura në ministritë e linjës në kryeqytetet përkatëse, përmes një sistemi që është në linjë me zhvillimet e sotme të teknologjisë.

Nëse një punëtor i diplomacisë shqiptare ka sot nevojë për të dhëna që i referohen një sektori të caktuar dhe zhvillimeve në të, duhet të kalojë pa dyshim përmes një kalvari faktmbledhës, që nis nga kërkesa në zyrën e ministrit dhe në

delegimin e avashtë të detyrave prej aty. Sigurisht, koha e punës së një titullari nuk është e mjaftë për të gjurmuar cilësinë e punës së këtij rrethi – edhe pse të zgjedhur – punonjësish.

Shumë probleme, që ende mund t'i vishen diplomacisë shqiptare apo mefshtësisë së saj për të prodhuar rezultate, janë pjesë e dështimit të qeverisë për të gjeneruar të dhëna, materiale komunikimi apo sinergjinë e nevojshme për të ballafaquar interesin e bashkëpunëtorëve të huaj me vullnetin politik drejt integritit.

Shpesh ne flasim për cilësitë e demokracive tona si kusht për proceset integruese, por harrojmë se ende shumica e votuesve shqiptarë, për arsye të sistemeve të vjetëruara të informacionit dhe për shkak prirjesh të ushqyera politike, ende votojnë kryesisht Kundër dikujt, sesa Pro dikujt tjetër.

Një tipar shumë i rëndësishëm që do të pasurohej nga aplikimi i këtyre teknologjive të përparuara të menaxhimit të informacionit do të ishte Përfshirja e Publikut në vendimmarrjen politike dhe qeverisëse.

Sot, në vendet baltike qytetarët kanë akses dhe mund të shprehin mendimet e tyre në çdo nivel të vendimmarrjes politike, qeverisëse qendrore apo vendore. Në këto shtete sistemet aktuale të komunikimit lejojnë që mbledhjet e qeverive vendore apo qendrore, seancat parlamentare, etj., të gjurmohen online nga publiku, të ndiqen në fazën e debateve, të mbështeten nga votime publike, etj., duke i dhënë një përmasë të shtuar të gjithë aplikimit të demokracisë në terren, një dimension të ri realizimit të politikave publike dhe duke gjeneruar një konsensus publik për fazat zbatimore të këtyre politikave apo vendimeve, çka në rezultanten e madhe politike lexohet si stabilitet, proces i cili më pas shkëmbehet me kohezion social, me pajtueshmëri interesash, me përparim.

Ende sot Shqipëria nuk ka një sistem të Info-Line, ndërsa po deshe të përdorësh celularin për mesazhe, maksimumi mund të mësosh nga kompani fantazmë përqindjen tënde erotike, ditët më të mira për seks dhe ato më të rrezikshme të fertilitetit, horoskopin e përçudshëm zodiakal apo atë atipik kinez me emra kafshësh, etj. Çdo gjë është jashtë vizionit dhe nevojave të qytetarit normal, i cili nuk pret t'ia shkruajnë fatin yjet, por e kërkon atë me punë dhe mundim.

Nuk duhet harruar se përsheptimi i procesit të integritit në NATO është në favor të drejtpërdrejtë të segmenteve më aktivë të vendit. Mjafton të përmendet fakti që Shqipëria nuk përfiton

dot nga qindra kontrata, ku ajo mund të përfshihej shumë mirë si furnitore për produkte apo shërbime të ndryshme. Kostot e punës në Shqipëri e bëjnë këtë qasje jashtëzakonisht atraktive. Edhe nëse arrijmë të pranohermi në NATO, mungesa e sistemeve informatike që zbulojnë resurset e vendit në rrafsh ndërkombëtar, i bën këto shanse të papërfillshme dhe jo të arritshme. NATO-ja në komunikimin e informacionit me shtetet përdor një sistem të *Procurement* për blerje pajisjesh dhe mallrash. Njësia që e realizon këtë quhet NATO Logistics Stock Exchange, që është një entitet ligjor në kuadrin e NATO Maintenance and Supply Organization (NAMSO).

Nëse Shqipëria do të ishte një vend anëtar, shumë biznese shqiptare mund të ishin furnitore të organizatës për produkte apo shërbime. Por sistemet e prapambetura të komunikimit ndërinstitucional në gjendjen aktuale e përjashtojnë këtë shans, qoftë për nga siguria që ofrojnë si shërbime informatike, ashtu edhe për nga shkalla e ulët e penetrimit. Ky është një shans i humbur në nivel kombëtar, nëse vendi bëhet anëtar i organizatës.

Në tërësi, dëshiroj të vlerësoj se procesi i përafrimit të vendit me strukturat ndërkombëtare, sidomos ato evro-atlantike, është një proces i rritjes së vendit në shkallën e realizimit të vlerave të demokracisë, që mbështesin progresin e brendshëm politik e social, përparimin ekonomik dhe rritjen psikologjike dhe mendore të krejt popullatës. Hapat përpara në këto procese janë një siguri e shtuar se standardet e arritura nuk do të njohin më kthim mbrapsht, se situatat e riskut do të minimizohen maksimalisht dhe se në tërësi panorama për të thithur investime dhe për të gjeneruar punë e zhvillim do të jetë gjithnjë e më e favorshme.

Mbi të gjitha anëtarësia e vendit në strukturat më aktive që gjenerojnë paqe dhe demokraci në nivel global, i rikthen Shqipërisë sharmin e humbur gjatë një izolimi të egër ideologjik pesëdhjetëvjeçar dhe vendin e merituar në familjen e kombeve të përparuara.

English summary

Greetings

The deputy minister of defense, Mr. Petrit Karabina, wishes success to *Security Issues* and informs its readers about the regional SEDM process, which is currently chaired by Albania. He makes a presentation of the history of SEDM, its projects, emphasizing SEEBRIG and highlights the role played by Albania in this regional initiative.

Also the Commander of Military Presence of NATO in Albania, Brig. Gen. Georgios Mouroutsos, greets the foundation of the journal and wishes that it will fill the perceived void of specialized information of the Albanian public on NATO integration process of Albania.

Jaap de Hoop Scheffer, ***“Global NATO: Overdue or Overstretch?”***

In his speech the Secretary General of NATO argues that the organization does not need to be overstretched in involvements on a global level, but instead needs to adopt a global approach to threats that challenge the security of its members. For the NATO to be able to deliver security in contemporary world, he suggested that the member states' efforts be concentrated in six areas: (1) continue to build up joint capacities; (2) sharing of risks and burdens more equitably among the members; (3) better coordination with other actors, such as UN, EU, NGOs; (4) develop further partnerships in East Europe, Mediterranean area, Middle East and Asia-Pacific region; (5) enhance political dialogue about vital global issues, such as energy use; (6) break the deadlock in the NATO-EU

relationship.

Gabriele Cascone and Joaquin Molina,
“Deeping Relations”

In their analysis, Gabriele Cascone and Joaquin Molina examine prospects for the Western Balkans from a NATO perspective. The current stability of the entire region, where a return to major hostilities is unthinkable and all countries and entities have a genuine prospect of eventual, may directly be attributed to the secure environment that NATO has provided. The authors go on to analyze the situations and make predictions about the developments in Kosovo, Serbia and Montenegro, Bosnia-Hercegovina and the trio of Adriatic Charter: Albania, Croatia and Macedonia. For the later trio they say that their future is clear and lies in full European and Euro-Atlantic integration, but the timelines for both processes are not fixed and depend on how well each country continues to implement a wide range of reforms. Their progress to NATO will also be blazing a trail for the rest of the region.

Rexhep Meidani,
“Peace-Keeping, Intervention, Security and NATO”

The former president of Albania examines the role of international peace-keeping operations as initiatives for global peace and security. Contemporary threats by international terrorism demonstrate the interdependency of the states. The principles of sovereignty of states and the right to self-determination sanctioned by the documents of UN must be made compatible to interdependency. In this framework, the author argues that the role of NATO is not only limited to collective security, but it is also an important booster of democratic reforms in military and civil spheres. In the Western Balkans Albania now is producer of security and the Albanians in the region are strong supporters of integrations to NATO and EU. Any attempt to undermine the Euro-Atlantic movement will not be supported by the Albanians and will fail.

Bengt Sundelius,
“A Brief on Embedded Societal Security”

The traditional dichotomy of security threats and responses cannot serve as a basis for developing national and international security arrangements and institutions in the Twenty First century. This article presents the concept of *societal security* and the notion of *intermestic* domain allowing to bridge state security and human safety challenges and to build trans-boundary linkages across domestic and international levels of response. Such holistic approach, that places societal security at the core, is manifested in the Solidarity Clause of the Constitution of the European Union. The implementation of the concept would provide for efficient development of security arrangements within the European Union, between European countries and the United States. Enhanced societal security across the Atlantic could become a core mission for the future work of NATO and the wider Partnership for Peace community.

Gen. Pëllumb Qazimi,
*“Understanding NATO Military Transformation
from the Perspective of a Partner Country”*

The former Chief of General Staff of Armed Forces of Albania presents in his paper how are the transformations in the nature of NATO reflected in the military reforms of Albania, as a prospective member of the Alliance. In the last 15 year Albania underwent a significant change from the concept of total war to the collective security and cooperation that is outward-oriented. The military reform in the country is aiming at smaller but more professional military structures. The efficiency of new Albanian forces has been tried with success in involvement of elite forces in various NATO-led trainings and missions, or in other peace-keeping mission, such as the commando company in Iraq.

Ronald D. Asmus,
“Reinventing NATO (yet again) politically”

Ronald D. Asmus examines the remake that NATO requires to meet the challenges of the post-post Cold war era that are centered beyond Europe. He suggests two different but increasingly connected agendas that must be at the heart of NATO's second reinvention. The first is to continue the strategy of promoting and extending democracy and stability deeper into Eurasia and especially into the broader Black Sea region. The second, related to the first, is the need to project stability into the broader Black Sea region – not only as part of the effort to build a Europe whole and free but also with an eye towards the broader Middle East. Together, this will constitute the third great wave of Euro-Atlantic outreach and integration. Just like NATO enlargement to Central and Eastern Europe helped eliminate the age-old sources of geopolitical conflict and rivalry on the continent, anchoring Ukraine and the wider Black Sea region to the West would again redraw the map of Europe for the better.

Franko Egro,
“NATO and Its Challenges”

Franko Egro examines the geopolitical significance of the new phase of NATO enlargement in East Europe and the apprehensions by some member states about the new face of the Alliance. He argues for a global reach of the future NATO through members and partners from other continents that share same values and interests with the Alliance and will be able to contribute to missions that enhance global security. Examples given for potential partners of NATO are Australia, New Zealand, Brazil, Japan, India.

Col. Zeno Jahaj,
“Tendencies of Modern Warfare: Smaller but More Professional and Better Trained Forces”

The author argues that war is an inescapable evil from which mankind may not be escape in the near future. The duty of the armed forces is to be prepared for modern warfare in order to better serve the security of citizens. The new forms of contemporary terrorism are an example of the nature of contemporary threats that must be met by the armed forces. Uncertainty is a more distinguished feature of the new confrontations than it used to be in the past. The new military forces must be better trained and equipped to be able to enter into operations in a short time, to coordinate actions between different sections, to collaborate with forces of other states and always to be aware and respect the human rights, values of democracy, and national and international legality

Alban Bala,
“Management of State Information as a Way to Come Closer to NATO Standards”

Alban Bala, Director of Albanian Institute for Public Relations, argues for the use of new IT by the state institutions to better manage public information and in this way to come closer to the standards with which operate NATO member states. He suggests the creation of various digitalized data bases of information and establishments of networks for the tranfer and exploitation of the public information by the state structures and citizens themselves. They can even be shared with and be used by other member states of NATO in case that security concerns demand it. The present state of public data storage and use is in poor shape and the author calls for a strategic large-scale and integrated planning for the creation of new data bases and networks.